



## KUVENDI

### REPUBLIKA E SHQIPËRISË

#### *Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.11.2021, ora 09:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Albana Vokshi – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore për projektligjin "Për buxhetin e vitit 2022" me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit.

#### **Marrin pjesë:**

Albana Vokshi, Klodiana Spahiu, Ilirian Pendavinji, Dasantila Tahiraj, Florenc Spaho, Niko Kuri, Shpresa Marnoj, Mirela Pitushi, Tatjana Piro, Lindita Buxheli, Ilir Metaj, Anila Denaj, Gertjan Deda, Petrit Vasili, Grida Duma, Mesila Doda, Orjola Pampuri, Tritan Shehu, Zheni Gjergji, Ilda Dhori, Seladin Jakupllari.

#### **Të ftuar:**

Elira Demiraj- Drejtore e Përgjithshme AKPA-së

Gertian Bajraktari- Drejtor i Planifikimit dhe Performancës në AKPA

Mirela Balla- Drejtor i Financave dhe Buxhetit

Enkel Joti - Drejtor i QSUT-së

Birkena Qiriazhi – Nëndrejtoreshë e QSUT-së

Mihal Tase – Shef i Shërbimit të Mjekësinë Interne në QSUT

Artan Goda – Shef i Shërbimit Kirurgjisë Kardiake në QSUT

Anila Godo – Shefe e Shërbimit Onkohematologjik në QSUT

Eqerem Hasani – shef i Shërbimit të Sëmundjeve të Brendshme në QSUT

Silvana Çeliku – Shefe i Shërbimit të Onkologjisë në QSUT

Gjeorgjina Kuli (Lito) – Shef i Shërbimit Pediatrik në QSUT

Iilir Ohri – Shef i Shërbimit të Anestezi – Reanimacion në QSUT  
Arjana Starkosha – Shef i Shërbimit të Mikrobiologjisë në QSUT  
Edlira Bode - Drejtoreshë e Spitalit të Traumës  
Silva Bala - Drejtoreshë e spitalit “Shefqet Ndroqi”  
Arben Gjata - Rektor i Universiteti të Mjekësisë  
Ndreke Ismailaj - President i Shoqatës së Para dhe Tetraplegjikëve  
Emanuela Zaimi - Down Syndrome Albania Foundation  
Ermonela Xhafa - Komisionere për shëndetësinë tek Avokati i Popullit  
Vilma Shurdha -Komisionere për çështjet sociale tek Avokati i Popullit  
Etleva Sheshi – Përfaqësuese e Avokatit të Popullit  
Mimoza Morina – përfaqësuese e Avokatit të Popullit  
Bedri Omuri - Përfaqësues nga Shoqata Invalidëve të Punës së Shqipërisë  
Lulzim Resuli – President i Shoqatës Kombëtare të Jetimëve të Shqipërisë  
Sinan Tafaj - Ekspert i të drejtave të njeriut në “Bashkimi i Organizatave Kombëtare Lokale të Aftësisë së Kufizuar”  
Ermela Zenelaj - Kryetare Shoqatës për Mbrojtjen e Talasemikëve Shqiptarë  
Etem Fezollari - kryetar  
Eglantina Ajdini - Shoqata Antikomuniste e ish-të Përndjekurve Politike të Shqipërisë  
Elsa Zhulali - Drejtuese e Fondacionit “Grow Albania” Gluten Albania  
Aferdita Saiti - Përfaqësuese nga shoqata “Ndihmoni jeten”  
Genti Stroni- Përfaqësues nga Qendra për të Drejtat në Punë  
Asim Toro - Përfaqësues nga Shoqata e Diabetikëve.  
Altin Hazizaj - Drejtues i CRCA-së  
Mirgjit Vataj - Drejtor i “Alo 116-111” Shqipëri  
Samantha Woolfe - Përfaqësuese e INHOPE, Qendrës Europiane për Internet të Sigurt  
Ilda Pisha - Përfaqësuese nga qendra "Për arsim cilësor"  
Afshan Khan - Zëvendësambasadore e UNICEF-it  
Mirela Arqimandriti - Përfaqësuese nga qendra “Aleanca gjinore për zhvillim”  
Eglantina Bardhi - Përfaqësuese nga shoqatat “Together for Life” dhe “Save the children”  
Denisa Canameti - Përfaqësuese nga shoqatat “Together for Life” dhe “Save the children”  
Mariana Bukli – Përfaqësuese për çështjet e shëndetësisë dhe çështjet sociale

Iva Zajmi - Përfaqësuese për çështjet e shëndetësisë dhe çështjet sociale  
Alketa Zazo - Përfaqësuese për çështjet e shëndetësisë dhe çështjet sociale  
Edina Kozma - Përfaqësuese për çështjet e shëndetësisë dhe çështjet sociale  
Enkelejda Kallçiu- Drejtore Kombëtare “Terre des hommes” Shqipëri  
Mira Rakacolli- Zëvendësministre e Shëndetësisë  
Saimir Kadiu- Drejtor Buxheti në Ministrinë e Shëndetësisë  
Antoneta Njehrrëna- Drejtore Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë  
Denada Seferi- Zëvendësministre e Shëndetësisë  
Arda Lazareni – Specisliste në Agjencinë e Mbrojtjes së Fëmijëve  
Eneida Capo- Përgjegjëse sektori Drejtoria Mbrojtjes Sociale  
Brunilda Dervishaj - Përgjegjëse sektori Drejtoria Përfshirjes Sociale  
Bilal Kola – Përfaqësues nga Instituti i të Përndjekurve Politikë  
Arlinda Topçiu- Përfaqësuese nga Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve

## HAPET MBLEDHJA

**Albana Vokshi** – Mirdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Edhe sot kemi një ditë të ngarkuar, meqenëse kemi shumë seanca dëgjimore. Këtë dëgjesë e filluam në orën 9:00 që të mos na zërë pjesën e dëgjesave të tjera. Pra, të mundohemi që të jemi sa më koncizë.

Atëherë, dëgjesën e parë do ta zhvillojmë me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit. Për të zhvilluar këtë seancë dëgjimore kemi të pranishëm zonjën Elira Demiraj, drejtoreshë e Përgjithshme e AKPA-së, zotin Gertian Bajraktari, drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Performancës, zonjën Mirela Balla, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.

Pa humbur kohë, po ia kaloj fjalën drejtoreshës.

**Elira Demiraj** – Faleminderit!

Unë do të bëj një përmbledhje të përgjithshme se çfarë pune bën agjencia. Pastaj do t'u përgjigjem pyetjeve.

**Albana Vokshi** – Pra, mund të na thoni nëse keni gjë për buxhetin, se për këtë jemi, për të diskutuar për buxhetin e vitit 2022. Sigurisht ju mund të bëni edhe një panoramë të asaj çfarë duhet të bëni, çfarë keni bërë, sepse edhe deputetët e maxhorancës ishin të interesuar për punën tuaj dhe se si ju mund të ndihmoni në objektivat e caktuara nga ana e qeverisë për rritjen e punësimit.

**Elira Demiraj** – Faleminderit!

Unë po e filloj me një pasqyrë të agjencisë, quhet Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë që nga viti 2019. Më parë ky institucion ka trashëguar Shërbimin Kombëtar të Punësimit, që mbulonte zyrat e punës dhe qendrat e formimit profesional dhe nga viti 2019, me ndryshimin e ligjit të nxitjes së punësimit, si dhe duke u bazuar në ligjin e arsimit dhe formimit profesional, u krijua Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisimit për të mbuluar dhe shkollat e formimit profesional. Shërbimi Kombëtar i Punësimit është krijuar që nga viti 1998, pra është një institucion relativisht i ri krahasuar me të tjerët, i cili ka mbuluar zyrat e punës në territorin e Shqipërisë, i organizuar në nivel qendror rajonal me 12 drejtori rajonale punësimi dhe rreth 40 zyra punësimi dhe 10 qendra formimi profesional të shtrira në territorin e Shqipërisë. Kryesisht si fillim ka qenë pjesë e tranzicionit nga një sistem i centralizuar në një sistem të një ekonomie të hapur dhe pak a

shumë rrjedha institucionale ka qenë duke mbuluar me programet aktive dhe pasive të tregut të punës, fillimisht me programin pasiv, siç është pagesa e papunësisë, dhe pastaj me gjenerimin e programeve të tjera për të trajtuar kategoritë vunerabël, për të trajtuar me shërbime punësimi të gjithë ata që ishin të interesuar, sidomos ata që dolën nga shkurtimet e ndërmarrjeve të organizuara në atë kohë.

Kuptohet që me kalimin e viteve Shërbimi Kombëtar i Punësimit ka pësuar ndryshimet e veta. Objektivi kryesor apo misioni i agjencisë është të përmirësojë cilësinë e shërbimit në territorin e Shqipërisë. Ne e kemi adresuar punën tonë duke e ndarë në të gjithë komponentët kryesorë të përmirësimit të cilësisë, siç është infrastruktura.

Në lidhje me infrastrukturën, ne kemi pasur gjatë vitit 2019 – 2021 një rikonstruksion të rreth 35 zyrave të mbështetur edhe me indikatorë të buxhetit suport ku i kemi marrë të gjitha paratë, i kemi plotësuar indikatorët e buxhetit suport nga ana e BE-së, na mbeten 2 apo 3 zyra shumë të vogla, të cilat do të mbyllen brenda vitit 2022. Në këtë mënyrë ne plotësojmë standardin e infrastrukturës me adresimin e aksesit për aftësinë e kufizuar edhe shumë elemente të tjera, që kanë të bëjnë me standardin e ofrimit të shërbimeve. Jemi duke punuar me brandimin, mobilimin dhe çdo element tjetër për ta moderuar zyrën. Kjo mbështetet këtë vit nga IPA, që është suport teknik për të rritur kuadrin e promovimit, por edhe për të unifikuar brandimin e të gjithë zyrave, pasi duhet të ketë një brandim të posaçëm.

Për pjesën e pajisjeve të zyrave dhe pajisjeve të IT-së, edhe gjatë buxhetit kemi implementuar dhe sistemin e ri të IT dhe kompletimi me pajisje elektronike kishim të planifikuara vjet një fond, gjithashtu sivjet shfrytëzojmë edhe burimet e donatorëve dhe projekteve të ndryshme për t'i adresuar sipas nevojave që kemi dhe pretendojmë që në 2022-shin t'i kemi të gjitha zyrat të plotësuara me pajisje dhe me mjetet e duhura të IT-së.

Në drejtim të sistemit të punësimit, para 2 vjetësh ne filluam punën për dizenjimin e (torsave) për një sistem modern të punësimit që vetëm mat ose vlerëson aftësitë e individëve që regjistrohen. Kemi mundur të bëjmë edhe shumë procese të tjera. Kemi pasur një database shumë të thjeshtë prej së cilës nuk filtronim dot elemente të ndryshme statistikore apo matnim nivelin e shërbimit apo të nxjerrim raporte menaxheriale për informacionin e tregut të punës. Në vitin 2019 kemi përgatitur (torsan), në vitin 2020 filluam zhvillimin e sistemit, por dhe për arsye pandemie jemi ende tek termat e referencës dhe specifikimet duke parashikuar çdo kërkesë që vjen edhe nga BE-ja, duke pasur parasysh kapitujt tonë 2 dhe 19 ku jemi të përfshirë është një numër shumë i

lartë indikatorësh që pritet të gjenerohet nga momenti që ne kemi sistemet e implementuara dhe hapen negociatat.

Në vitin 2020 filluam zhvillim e sistemit, kemi pasur ato vonesa për shkak të pandemisë, mosmbledhjes së kompanisë fizikisht me stafin në salla për të diskutuar, sepse është sistem i vështirë, por kemi arritur që në prill të këtij viti ta hedhim *live* sistemin dhe jemi në procesin e popullimit të të dhënave. Aktualisht, kemi pasur rreth 90 mijë punë kërkuar gjatë fillimit të vitit, të regjistruar, të cilët po trajtohen të gjithë nëpërmjet një pakete trajtimi që unë do ta shpjegoj pak më tej se si ne i trajtojmë punëkërkuar tashmë nëpërmjet reformave që kemi bërë, sepse ka një veçanti mënyra se si trajtohen punë kërkuar. Ne i kemi sjellë në konceptet e reja bashkëkohore nuk mjafton vetëm të profilizohet dhe të marrim informacion paraprak për punë kërkuar po duhet të jenë të shoqëruar me një plan trajtimi. Plani i trajtimit u miratua me VKM-në e shërbimit të punësimit të AKPA-së në vitin 2020. Dua të saktësoj dhe një herë mënyrën se si hyn një punëkërkuar dhe cili është juridikisht i lejuar që të hyjë, mënyrën se si duhet trajtuar dhe shërbimet që i ofrohen, duke bërë atë shportën e shërbimeve, e cila nuk ekzistonte më parë dhe duke ndërtuar shërbime apo paketa të reja shërbimesh, që e ndihmojnë një individ jo vetëm të gjejë punë. Një nga misionet kryesore që ne i kemi vendosur vetes është ta zhvillojmë atë individ drejt tregut të punës, që të bëhet i qëndrueshëm, sepse u vu re, sidomos nga momenti kur dolën shumë persona nga ndihma ekonomike apo shumë kategori të vështira, që e kanë jashtë mase të vështirë të qëndrojnë në tregun e punës për shkak të mungesës së ca kompetencave dhe aftësive qoftë të buta, teknike apo dhe në nivelin e edukimit etj.

E lidhur me sistemin kjo do të na jepte mundësinë që jo vetëm të marrim shumë informacion, kemi futur në bazë të sistemit ESCON, që është sistemi kombëtar i kompetencave dhe përdoret gjerësisht në vendet e BE-së dhe madje kemi pasur dhe një postim në Departamentin e Punësimit në KE për modelin e mirë që kemi pasur, si një nga 6 vendet e rajonit perëndimor për ta përfaqëuar si nismë dhe për të qenë avangardë në mënyrën se si ne i vlerësojmë. Kjo do të na bëjë të mundur që ne të vjelim diferencat apo problemet që ka tregu i punës apo punëkërkuar që ne kemi në database, sa më i mirë të jetë vlerësimi, aq më të mira do të jenë dhe gjetjet, relacionet apo informacioni që do të vilet prej tyre.

Për sa u përket shërbimeve të punësimit, një element tjetër që do të doja të theksoja ka qenë rishikimi i të gjithë paketave të programeve të nxitjes. Këto programe konsiderohen si programe aktive të tregut të punës dhe përpqemi që të shfrytëzojmë jo vetëm burimet tona të brendshme,

me buxhetin e shtetit, por edhe me partnerët që mbështesin fushën e punësimit dhe arsimit profesional, për të na ndihmuar në ecjen më shpejt në reformimin e shërbimeve. Kjo është pak a shumë.

**Albana Vokshi – Faleminderit!**

Po e nis me një pyetje, pastaj do t'ua kaloj fjalën edhe kolegëve. Sa të përfshirë jeni ju si agjenci në hartimin e objektit dhe objektivave të buxhetit për vitin 2022? Ju vërtetë na bëtë një panoramë të asaj çfarë ju si agjenci duhet të bëni, pra shtyllat kryesore, por nuk dëgjova asnjë statistikë se sa janë të punësuar nga ju, sa janë të ndërmjetësuar dhe sa janë të punësuar nga COVID-i? Pra, janë shumë objektiva në buxhetin e vitit 2022, që i referohen punës dhe ndërmjetësimit që ju agjenci bëni.

Kam edhe disa pyetje. Qeveria thotë, por besoj se duhet të jetë konsultuar edhe me ju, që vazhdon me nxitjen e punëkërkuësve të dalë të papunë nga pandemia COVID-19, 2000 persona në vitin 2022 dhe shërbimet e punësimit do të ndërmjetësojnë rreth 20 000 punëkërkuës të papunë në vit. A mund të ma shpjegoni, se nuk arrij ta kuptoj, se si do të bëhet nxitja e punëkërkuësve të dalë papunë nga COVID-i i vitit 2019 për vitin 2022? A keni ju një statistikë të tyre? A është kategori e veçantë te ju dhe si regjistrohen? Përse copëtohen objektivat e programeve të qeverisë për vitin 2022 në gra, vajza dhe të rinj nga mosha 15 vjeç deri në 29 vjeç veçmas? Unë ia bëra edhe dje zëvendësministres së Financave të njëjtën pyetje, por nuk mora asnjë përgjigje.

Po për ato që kanë humbur vendin e punës nga tërmeti a keni një listë apo statistikë dhe si operohet me to? A ka një program të veçantë për ta? Sa është numri i atyre që e kanë humbur punën nga tërmeti, COVID-i apo paaftësia e qeverisë për të hapur vende të reja pune? Cili është rezultati deri më tani i zyrave të punësimit në ndërmjetësim për punësim, që të mendojmë se ju do të keni sukses në vitin 2022?

Qeveria në raport thotë: “Nxsisim punësimin e punëkërkuësve të të rinjve, grave e vajzave nëpërmjet shërbimeve të punësimit dhe programeve aktive të tregut të punës”. Prioritetet e punësimit, pra një nga çështjet më kryesore në jetën e një shoqërie dhe një emergjencë për shqiptarët, kufizohen vetëm në objektivat 2-vjeçare, ndërkohë që dëgjojmë objektivat e qeverisë si “Shqipëria 2030” e të tjera.

Në mes të tjerash qeveria thotë: “Nisim punësimin e punëkërkuësve përmes shërbimeve të punësimit dhe programeve aktive”. Zyrat e shërbimeve të punësimit, që janë hapur me aq bujë, duket sikur kanë dështuar tashmë. I shohim që janë raportuar edhe në medie dhe e dimë se cilat

profesione të kualifikuara ofrojnë, si sanitare, roje private, hidraulik për në Gjermani. Në këtë rast kisha disa pyetje. Prej hapjes së zyrave të punësimit 2013-2014-2015 dhe deri më sot sa qytetarë janë punësuar deri më tani? Sa është raporti mes meshkujve dhe femrave? Sa prioritet ka pasur punësimi i grave? Sa prej të punësuarve kanë qenë në zonat rurale, shtresat në nevojë, nëna apo gra të dhunuara, që kanë përfituar më parë asistencë sociale? Mbaj mend që ju keni futur edhe një program, që nuk do të jepni më ndihmë ekonomike, por do të tentoni t'i punësoni, nuk ka asgjë të keqe, por sa është bërë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka qenë në programin e qeverisë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mirela, ka qenë në programin e qeverisë në vitin 2013, në vitin 2017 dhe vazhdon akoma.

Në projektbuxhet flitet për programet aktive të tregut të punës, a mund ta dimë se cilat janë këto programe aktive, që janë përfshirë dhe vijojnë të përfshihen në programet e punësimit? Keni dhe dy objektiva që i referohen agjencisë suaj.

A ka agjencia programe ritrajnimi për punonjësit e mbetur pa punë nga biznese, që janë mbyllur dhe nuk hapen më, po them gjatë tërmetit apo COVID-it? Pra të ritrajnohen në përputhje me kërkesat e tregut me qëllim lehtësimin e punësimit të tyre. Si do të arrihet që 50% e të punësuarve, që është objekti, të jenë nga radhët e të rinjve, vajzave dhe grave?

Faleminderit!

**Anila Denaj** – Faleminderit, kryetare!

Mirëmëngjesi, kolegë,

Në fakt, unë e kam ndjekur nga afër vitet e fundit punën e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Arsimit Profesional dhe dua t'i falënderoj për të gjithë punën e tyre, të cilën e kanë kryer në shumë vështirësi për shkak të situatës së pandemisë.

Në prezantimin tuaj folët për sistemin dhe besoj se të dhënat nga sistemi nuk janë ende gati. Megjithatë për mënyrën se si e keni organizuar informacionin, dua të kem një përgjigje: sa biznese janë pjesë e procesit në lidhje me zyrat e punës?

Ne e kemi diskutuar që kjo nuk është vetëm një platformë administrative, as një platformë qeverisje, e kujt do qeverie, por është një platformë që ndihmon biznesin, dhe në afatmesëm ata do të ishin të interesuarit e parë, përtej punëkërkuesve, për të parë shërbimin e ndërmjetësimit si benefitin e parë. Megjithatë, besoj se edhe këtu ka një periudhë kohe, që i duhet çdo biznesi për të



rritur marrëdhënien. A ka një qasje proaktive nga AKPA-ja në këtë drejtim? Kjo është pyetja ime e parë. Si janë rezultatet në vitet e fundit drejtë rritjes dhe afrimit të më shumë bizneseve ndaj zyrave të punës?

Së dyti, në vitin 2019 në parlament ne kemi aprovuar ligjin e punësimit, i cili bëri edhe mërxhin e dy strukturave, të Agjencisë Kombëtare të Punësimit me shkollat profesionale dhe kualifikimet afatshkurtra. Kjo me një objektiv që të jetë brenda një ombrelle. A keni sot një rezultat të pritshëm, që ky objektiv ka qenë i duhuri dhe ka mundur një eficiencë në qasjen ndaj të gjithë aktorëve?

Së fundi, në të njëjtin ligj ka qenë objektiv i punësuar personat me aftësi të kufizuara, për t'i qasur ata drejtë tregut të punës, në këtë mënyrë për të mos mbetur, më falni për shprehjen, peng e një kuote ndihmëse, por të asaj që është puna e ndershme.

Shumë Persona me aftësi të kufizuara ndihen të kufizuara kur shkojnë te punëdhënësi, sepse ka njëfarë diskriminimi. Prandaj, ky ligj pati në fokus eliminimin e këtij diskriminimi, duke i forcuar me detyrim punëdhënësit që të marrin një numër të caktuar punonjësish, sipas kriterëve të tyre të punës, që kanë aftësi të kufizuara. Pra, për punëdhënësit që kanë në borderotë e tyre 1 deri në 25 punonjës të marrin një person me aftësi të kufizuara, e kështu me radhë.

Sigurisht, që çdo punëdhënësi është i lirë të mos i marrë, por ka detyrim ligjor që pagën minimale të një personi me aftësi të kufizuara ta derdhë në një fond, i cili ka në thelb objektivin për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara. Çfarë statistikash kemi në këtë drejtim? A ka filluar fondi? Si ka qenë qasja e personave me aftësi të kufizuara dhe bizneseve në këtë drejtim?

Jam e ndërgjegjshme që ky nuk është një proces që bëhet vetëm me ligj, nëse nuk ka ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve, ligji nuk vjen domosdoshmërisht në ndihmë të vetëm, por duhet të perceptohet si një mbështetje dhe jo si detyrim. Çfarë perspektive do të ketë aplikimi i ligjit dhe mbi të gjitha aftësimi në punë të personave me aftësi të kufizuara?

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Po, Klodi.

**Klodiana Spahiu** – Ju falënderoj për paraqitjen e materialit dhe mbi të gjitha ju inkurajoj për punën që keni bërë deri tani!

Në fakt, historia fillon që në vitin 2017, kur ne kemi miratuar ligjin “Për arsimin dhe formimin profesional” dhe ka pasur edhe rrugëtimin e tij, siç e përmendi edhe Anila, me ligjin “Për nxitjen e punësimit”.

Në buxhetin e vitit 2022 përmendet “Plani kombëtar i garancisë rinore”, për të cilin ju keni fazën e të parë, që është ajo e pilotimit. Ju lutem, a mund të kemi një informacion më të zgjeruar se si do të realizohet faza e pilotimit dhe si do të zhvillohet më tej?

Faleminderit!

**Lindita Buxheli** – Unë kam një pyetje. Ne kemi shkollën mekanike në Lushnjë, a është e mundur të hapet qendra e formimit profesional, sepse ka një kërkesë nga komuniteti, meqenëse, infrastruktura dhe stafi janë? Ka shumë kërkesa, por njerëzit e kanë të pamundur të shkojnë të gjithë në qendrën e formimit profesional në Fier, për shkak edhe të kostos së transportit. Dihet që këta janë njerëz, pjesa më e madhe, janë të papunë që kërkojnë të formohen nga ana profesionale. Është një kosto, me aq sa më kanë thënë, rreth 500 apo 600 lekë, tani në kushtet e pandemisë dhe nuk e përballojnë dot. Pra, bëhet fjalë për rrethin e Lushnjës, Bashkinë e Lushnjës dhe Divjakës, ku janë rreth 210 mijë banorë, po ta marrim me numër popullsie ka shumë më tepër se disa qendra qarqesh. Pra, a është e mundur, sepse nuk kërkon kosto, infrastruktura është dhe ambientet janë shumë të mëdha? Ju duhet të keni dijeni të shkollës mekanike, pra mund të realizohet pa kosto. Ne kemi edhe një relacion që mund t’ua nisim.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Fjala për ju drejtoreshë.

**Elira Demiraj** – Faleminderit, për pyetjet! Unë nuk doja të flija gjatë me idenë që do të bëheshin pyetjet.

Në radhë të parë, dua të jap një shpjegimi në lidhje me shërbimet e punësimit. Punësimi është rezultat. Punësimi në thelb nuk është një objektivi ynë në vetvete, ne kemi nevojë të ndërtojmë kapacitete...

**Albana Vokshi** – Më fal, por thashë objektivi i qeverisë...

**Elira Demiraj** – Jo, po mundohem të shpjegoj rolin e shërbimit...

**Albana Vokshi** – Dhe ju i shërbeni objektivit të qeverisë.

**Elira Demiraj** – Do t’i jap edhe statistikat.

**Albana Vokshi** – Do të thotë që ka objektiva.

**Elira Demiraj** – Patjetër.

**Albana Vokshi** – Nëse nuk ka objektiva si e orientoni punën tuaj?

**Elira Demiraj** – Do t’jua tregoj. Unë kam nisur një material dje, por ne përgatisim një kartë performance. Ky është një nga modelet më të mira që ka sot BE-ja, për mënyrën se si shpërndahen objektivat deri në nivel individit në zyrat e punës.

**Albana Vokshi** – Më fal, por kujt ia keni dërguar materialin, sepse ne nuk e kemi marrë.

**Elira Demiraj** – E kam nisur dje me *email*, nuk e di, por mund ta nis edhe sot

**Albana Vokshi** – Dakord, se nuk ka ardhur.

**Elira Demiraj** – Vendosija e objektivave bëhet çdo vit...

**Albana Vokshi** – Ju lutem, dërgojeni te sekretaria!

**Elira Demiraj** – Po, zyrtarisht.

**Albana Vokshi** – Nuk ka gjë jozyrtare kur thërritesh për dëgjuesë.

**Elira Demiraj** – Dakord.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

**Elira Demiraj** – Vendosija e objektivave bëhet çdo vit, ka një parashikim për tregun e punës, ka një parashikim të agjencisë, dërgohet çdo fillim viti për miratim në Ministrinë e Financave dhe pasqyrohet në formë të detajuar nëpërmjet kësaj karte performance.

Karta e performancës përmban punësimin, shërbimet ndaj punëkërkuesve, ndaj punëdhënësve, programet e nxitjes; përmban indikator cilësor, marketingun apo marrëdhëniet me të tretët dhe të gjitha pikat që përmenda të cilësia. Karta është e ndërtuar me të gjitha nënkategoritë.

Një nga pyetjet ishte përdorimi i nënkategorive, nënkategoritë janë indikatorë cilësorë, që shërbejnë për t’i vënë në vëmendje zyrave të punës, që ndërkohë që e trajtojnë me shërbime punësimi, të mos humbasin fokusin nga kategoritë vulnerabël, siç janë ata me aftësi të kufizuara, romët, egjiptianët, ndihma ekonomike, të rinjtë e shumë të tjerë. Gjithashtu, janë pjesë edhe e strategjive të tjera që përmenda, pra ne jemi pjesë e strategjive të përmbushjes së indikatorëve të strategjive të tjera dhe karta e performancës është e vlerësuar dhe është e dakordësuar dhe e miratuar në fillim të vitit.

Treguesit janë të përcaktuar me objektiva që në fillim të vitit nga ministria, të cilat ne raportojmë në mënyrë periodike mujore për t’i përmbushur ato. Prandaj të gjitha statistikat në lidhje me punësimin janë të dakordësuar, të miratuara dhe ne i ndjekim. Pra, është një nga prioritetet tona të monitorimit.

Për sa u përket shifrave që kemi deklaruar, janë shifrat tona. Për këtë vit ne kemi parashikuar rreth 2000 persona të trajtuar nga nxitja e punësimit. Kemi rreth 2800 të tjerë që kanë

marrë përfitim nga fundi i vitit 2020. Në total janë mbi 4 000 e ca persona të trajtuar me programet e nxitjes që nga momenti që filluan programet e reja.

Ne kemi rreth 23 200 punëkërkues të planifikuar për vitin 2021 për t'u realizuar. Këto janë të ndarë. Punësimi bëhet nga zyrat e punës, por ka edhe persona që janë trajtuar me shërbime dhe kanë gjetur punë vetë, duke u deklaruar në tatime.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ata për ne janë persona që kanë gjetur punë vetë në momentin që deklarohen në tatime. Ato trajtohen me programe nxitje dhe me shërbime të formimit profesional. Siç e thashë, kemi në plan edhe 2000 persona. Pra, të gjithë janë shifra të parashikuara dhe unë do t'i sjell zyrtarisht me *email*, meqenëse u kërkuan.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, i kemi shifrat, i kemi objektivat dhe i ndjekim, me kartat e performancës çdo javë dhe çdo muaj dhe i raportojmë, ne jemi përgjegjës për të raportuar.

Por dua të them që në thelb, pavarësisht se ky është objektivi, pra të gjithë ato që përmenda më parë, reforma është që ne t'i shërbejmë individit sipas nevojave që ai ka. Është ndryshe një person që është me ndihmë ekonomike, është ndryshe një person me aftësi të kufizuar për t'u trajtuar për punësim, sepse ka nevojë për shumë më tepër trajtim, prandaj ne e copëzojmë në nënkategori për t'i mbajtur në fokus, pra nuk duam t'i përjashtojmë nga fokusi. Këto janë objektiva dhe përmbushen të gjitha.

Për pjesën e tërmetit, ne kemi pasur prurje në momentin e tërmetit, por nuk mund të them që kemi pasur një program të veçantë për ato zona ku janë regjistruar si të papunë nga tërmeti, por ka pasur një ndryshim buxheti për zonën e Durrësit dhe për zonat e prekura. Pra, ka pasur ndryshim në shpërndarjen e fondeve për programet e nxitjes, por paketë specifike për t'i trajtuar në mënyrë specifike këta persona nuk ka pasur. Pra, kanë qenë pjesë e paketave të tjera, por jo të dedikuara për tërmetin, ndërkohë që për COVID-in e kishim paketën dhe janë tre programe brenda paketës së COVID-it.

**Albana Vokshi** – Drejtoreshë fondet që u shtuan për zonën e Durrësit apo për zonat e prekura nga tërmeti, për çfarë u alokuan, a u alokuan për nxitjen e punësimit, pra për ata që ishin të papunë?

**Elira Demiraj** – Për nxitjen e punësimit dhe sidomos për trajtimin e këtyre bizneseve që u prekën nga tërmeti. Ne na jepet një fond në total për nxitjen dhe bëjmë parashikimin dhe

rialokimin sipas nevojave që kanë zyrat e punës, ku kemi bërë një rishikim të buxhetit për të mbështetur më shumë rajonin që kishte më shumë nevojë. Pra, paketë të dedikuar për ata që dolën të papunë nga tërmeti nuk patëm si në rastin e COVID-it, të cilat i kishim të dedikuar për ata.

Për pjesën e regjistrimit të punësimit të grave dhe vajzave, edhe kjo është brenda kartës së performancës, është 50 me 50 minimalisht. Edhe këtë e kemi objektiv për ta realizuar dhe kryesisht është ashtu.

Edhe për hedhjen e të dhënave ne kemi një databazë, që i përkon kësaj shifre 49 me 51 ose 50 me 50. Pra, gjithmonë luhatet në favor të grave dhe vajzave, pra gjithmonë kemi pasur 51% më shumë gra dhe vajza për të punësuar.

Për sa i përket pjesës a kemi dështuar me punësimin e publikuar dhe për pjesën e trajtimit, unë them që ne kemi pasur një trend shumë pozitiv para se të ndodhte pandemia, ku arrinte deri në 30 000 numri i punësimeve në vit. Trajtimi ka qenë i dedikuar, por me ardhjen e pandemisë nuk patëm postime për vendet e lira të punës, bizneset ishin duke i lënë punonjësit e vet duke i regjistruar te ne, për të marrë pagesë papunësie apo benefite të tjera. Pra, ishte e pamundur që t'i shkoje biznesit për t'i thënë a keni nevojë për të punësuar në vende të lira pune, sepse ashtu ishte situata.

Në tremujorin e parë të vitit 2021 kemi një rritje gradualisht të lehtë dhe tani ka një rritje pothuajse normale. Pra, duket sikur ka një zhvillim normal, ashtu siç ishim përpara gjendjes së pandemisë, këto shikohen edhe nga shifrat e pagesës së papunësisë që po bie edhe nga pjesa e të regjistruarve, kemi një ndryshim tej mase të mirë. E theksoj përsëri, që shërbimet tona janë shërbime të dedikuara individësh. Ne thjesht sjellim më afër punëkërkuarit me bizneset dhe u shërbejmë atyre që ta gjejnë veten më lehtë edhe me shërbime të tjera, që ata nuk do të kishin mundësi t'i ofronin. Për shembull, shërbimi i rekrutimit për një biznes është shumë i vështirë, sidomos biznesi i vogël dhe i mesëm nuk ka burime njerëzore ekstra, ai vetë e bën punën, vetë bën edhe planifikimin financiar, edhe shërbimin, e kanë pothuajse të pamundur jo vetëm të selektojnë, por edhe ta rekrutojnë, edhe ta trajnojnë. Prandaj ne jemi aty për t'u shërbyer, që ta kenë më të lehtë këtë gjë.

Për vendet e lira të punës që shpallen, që ju me të drejtë i citoni dhe unë e bëra pak përshkrimin, si fillim zyrat e punës janë stigmatizuar për kategoritë e veçanta, të vështira, jo për të gjithë tregun e punës dhe për këtë arsye ne kemi vënë në fokus bashkëpunimin me bizneset, sepse vetëm duke bashkëpunuar me ta mund të marrim vende pune më cilësore dhe mund të kemi

mundësinë e ofrimit të një game shumë më të gjerë të vendeve të lira të punës pranë shërbimeve të punësimit.

Edhe sistemi bën të mundur që të kemi një paraqitje më dinjitoze. Me sistemin e vjetër nuk e kishim mundësinë të ishim aq dinjitozë në shpalljen e vendit të lirë të punës.

Ndërkohë, për pjesën e publikimit të infermierëve dhe të punësimeve që bëhen në Gjermani, ne vetë nuk kemi asnjë iniciativë shtetërore për këtë gjë. Ne kemi pasur kërkesa, ka pasur iniciativa edhe për punësime sezonale, ne i kemi trajtuar me shumë kujdes. Ne jemi shumë të interesuar që të gjithë individët, që ne trajtojmë, të marrin shërbimin dhe kualifikimin e duhur. Tregu i punës është i hapur. Në vendet e BE-së platforma e EURES-it, është një platformë që ofron mundësinë për çdo individ, që jeton brenda vendeve të BE-së, të punojë dhe të jetojë kudo që dëshiron. Për ne më e rëndësishme është që individët tanë të kualifikohen dhe të jenë të aftë të përballojnë ndryshimet e shpejta që ka tregu i punës, por ne vetë nuk kemi pasur publikime për migracion dhe as një paketë shërbimesh, që ne punësojmë jashtë.

Për sa i përket asistencës sociale, sfidën e parë ne e patëm me regjistrimin e të gjithë personave që dolën nga sistemi i pikëzimit kur u bë reforma dhe në vitin 2018-2019 patëm një prurje nga ata, që dolën menjëherë në tregun e punës dhe u regjistruan pranë zyrave të punës. Kemi pasur një fluks mbi 10 mijë veta në atë vit. Siç e kam shprehur, situata është e tillë që ka probleme sociale, përveç problemeve të kompetencave dhe zhvillimit të tyre personal për të gjetur vendin e punës, apo aftësitë e buta, apo informacion për punësimin e denjë, sepse shpeshherë pretendojnë ta vazhdojnë marrjen e ndihmës dhe ndërkohë punësime informale, me sa kemi informacion edhe nga pyetësorët që ndërtojmë. Ndërkohë kur ju paraqesim vende pune, paraqesin pengesa nga më të ndryshmet, por kryesisht të lidhura me shërbimet sociale. Mund të kenë nevoja për transport në bashki, mund të kenë nevoja për çerdhe e kopshte, mund të kenë nevoja për qendra të aftësisë së kufizuar, ku kanë familjarët e tyre, partnerë, bashkëshortë apo prindër të tyre, të cilët i pengojnë që të regjistrohen. Unë do t'ju jap shifrat, do t'jua dërgoj edhe zyrtarisht me *e-mail* edhe shifrat për të gjitha këto që folëm.

Për programet aktive të tregut të punës ka një informacion te raporti që kam paraqitur dhe janë rreth 7 programe. Aty janë të detajuara të gjitha llojet e programeve. Mund të vazhdoj apo...

**Albana Vokshi** - Jo, s'ka problem. Ju lutem, programet na i dërgoni me *e-mail*, dërgojani Joanës në sekretari.

**Elira Demiraj** - Patjetër, i keni me *e-mail* të gjitha.

**Albana Vokshi** - Anila nuk është këtu, u largua, ju bëri dy pyetje, nëse s'gaboj. Meqë Anila nuk është, të lutem anashkalojini pyetjet e saj dhe na i dërgo përgjigjet me shkrim. Ka një pyetje, një sugjerim...

**Mirela Pitushi** - Përshëndetje! Ju falënderoj për punën e mirë që keni bërë!

Unë kam qenë Drejtoreshë Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror dhe kam qenë në kontakte të vazhdueshme me Zyrën Kombëtare të Punësimit. Kam një shqetësim lidhur me nxitjen e punësimit, që normalisht është shqetësim edhe i bashkive dhe dua ta ngre tani në këto momente. Është bërë një ndarje midis sektorit shtetëror dhe sektorit privat dhe është vënë një kusht nga ana juaj, që duhet të bëhet pagesa e individëve dhe e sigurimeve shoqërore, ndërkohë që fondet e pagave në sektorët shtetërorë janë alokuar dhe janë vendosur qysh në fillim të vitit. Sektorët shtetërorë, sidomos bashkitë, nuk mund ta alokojnë këtë pagesë dhe pastaj të marrin subvencionin. Ju lutem, mundet që kjo pagesë të kalojë direkt nga zyrat e punës, pra që të mos krijohet ky ngërç? Unë kam qenë vetë pjesëmarrëse në këtë program, pra në programin e nxitjes së punësimit, kur kam qenë drejtoreshë rajonale kam marrë vazhdimisht individë nga ndihma dhe i kemi punësuar pranë drejtorisë sonë, por që ky ka qenë një ngërç, që ne na ka kufizuar.

Faleminderit!

**Elira Demiraj** - Kam përshtypjen se bëhet fjalë për praktikën profesionale, pra programin e nxitjes...

**Tatiana Piro** - Përshëndetje! Kam disa kohë, ndoshta mund të jetë edhe konflikt interesi, por nuk e kam më atë lloj biznesi, por në momentin që kam qenë pa u futur në politikë, e ndiqja unë atë pjesë.

Kam pas formimin profesional, që erdhi e u aplikua në Shqipëri me projektin Swiss Contact të zviceranëve. Ai ishte një projekt, që realisht dha goxha rezultat në sistemin e bonusit dhe pjesën tjetër e jepte vetë i interesuari që bënte kursin. Në momentin që ata ikën, secili u konsolidua në atë lloj fushe dhe vazhdoi vetë, gjë të cilën sot e ka motra ime. Dua të them vetëm që nuk ka formim profesional pa praktika në punë dhe nuk ka turizëm, pa formim profesional.

Mendimi im, nuk e di si e mendoni ju, vetëm më dëgjo, të lutem, është që nuk ka formim profesional duke shkruar, për shembull, sot do bëjmë supë, tasqebap e të tjera, vetëm duke e bërë njëherë dhe pa bërë praktika të tjera në punë.

Po marr profesionin e kuzhinierit, duhet të rrish natë e ditë në punë që të kesh këmbët e përgatitura, syrin e hapur, që të mos të zërë gjumi e të digjesh te kapaku i tenxheres e të tjera me

radhë. Unë mendoj që, përveç shkollave shtetërore profesionale, t'u lihej vend edhe njerëzve që kanë dëshirë dhe dinë ta bëjnë shumë mirë këtë gjë dhe të jenë biznes privat do ishte shumë mirë, jo për të dhënë një copë letër, por për të mësuar një profesion.

Faleminderit!

**Elira Demiraj** - Po e filloj nga kjo. Është bërë një plan në vitet 2019-2020 për optimizimin e ofruesve të arsimit dhe formimit profesional. Kjo në vetvete do të thotë që aty ku kemi shkolla dhe nuk kemi qendra të shërbimit profesional, ato të shërbejnë edhe si qendra formimi. 10 qendra janë shumë pak, të shtrira në gjithë territorin e Shqipërisë. Për këtë arsye edhe shkolla në Lushnje, edhe shumë shkolla të tjera janë të parashikuara për të dhënë edhe kurset e formimit profesional, sidomos në degët ku ato janë. Nëse është shkollë e specializuar për hoteleri-turizëm, siç është rasti i Sarandës...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Tatiana Piro** - Nuk mund të themi, që një shkollë bujqësore është qendër profesionale, është bërë një gjimnaz edhe kaq...

**Elira Demiraj** - Atë po shpjegoj, që do të kthehen edhe në qendra formimi. Do të bëhen qendra formimi, edhe në Lushnje dhe në vitin 2022 është i parashikuar...

**Tatiana Piro** - Lushnja ka qendra të formimit profesional dhe i ka shumë të mira.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elira Demiraj** - Publike nuk ka, private mund të ketë dhe është planifikuar e tillë...

**Tatiana Piro** - Janë 1, 2, 3 kemi 4 qendra të formimit profesional që janë private, janë shumë rezultative. Dikush që del nga këto qendra nuk shkon të qërojë qepët, por shkon të bëjë gjellën.

**Albana Vokshi** - Ka ndonjë deputet, që nuk mori përgjigjet e pyetjeve? Do t'ua dërgojmë edhe zyrtarisht. Pyetjet do të dërgohen edhe nga komisioni, sepse një pjesë nuk patëm mundësi t'i shpjegonim në detaje. Meri, more përgjigje apo jo? Sepse më duhet ta mbyll.

**Mirela Pitushi** - Është çështja e pagesave dhe subvencionit të nxitjes së punësimit në sektorin shtetëror.

**Elira Demiraj** - Programi që ju flisni është praktikë në punë në sektorin shtetëror. Koncepti nëse është privat ose shtetëror u ndryshua, e ndryshuam me paketën e fundit. Për sa i përket fondit, koncepti është që i punësojnë ata që i marrin në punë, jo ne. Pra, zyrat e punës, nëse do të merrnin përsipër që të paguanin siguracionet, do të dukej sikur i kanë punësuar ato. Në fakt, nuk është kjo



formula e programit. Duhet t'i punësojë biznesi apo partneri, që merr përsipër t'i trajtojë këta persona në formim profesional.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë po e shikoj edhe njëherë, që t'ju kthej përgjigje më të detajuar. Do të shoh edhe njëherë VKM-në dhe udhëzuesin, por koncepti është që ai merret nga biznesi për të bërë praktikën, apo nga kompania që e punëson, në shtet ose në privat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** - Më fal, ose fol me mikrofon, ose ta mbyllim mbledhjen dhe sqarojeni.

**Mirela Pitushi** - Po, më fal! Ideja është që individi kërkon, që qasjen më të madhe ta ketë në sektorin shtetëror, pasi aty e ndjen veten më të sigurt, që të bëjë praktikën profesionale ose nxitjen e punësimit. Ndërkohë që këtu është vënë kjo barrierë, pasi kërkohet pagesa fillestare dhe pastaj subvencionimi. Pse të mos bëhet direkt pagesë nga programi i nxitjes së punësimit? Të mos bëhet njëherë pagesa nga shteti dhe pastaj subvencioni, por të bëhet direkt pagesa nga programi i nxitjes së punësimit te individi. Më përpara është bërë, tani është vënë barrierë. Faleminderit!

**Albana Vokshi** - Atëherë, ju lutem materialet në formë zyrtare, do t'ju dërgojmë dhe pyetjet. E konsideroj të mbyllur këtë dëgjesë. Faleminderit për prezencën tuaj! Më duhet ta mbyll, sepse do të kalojmë në një sallë tjetër, në sallën e grupit në kat të katërt. Kanë ardhur drejtori dhe nëndrejtori i QSUT-së dhe shefat e shërbimeve. Meqenëse jemi shumë, kërkuam një sallë më të madhe.

Ndaj, ju lutem, kalojmë të gjithë lart dhe rifillojmë dëgjesën me doktorët!



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.11.2021, ora 10:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Albana Vokshi – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022” me QSUT-ën dhe shërbimet, spitalin e traumës, spitalin “Shefqet Ndroqi” dhe Universitetin e Mjekësisë.

#### **Marrin pjesë:**

Albana Vokshi, Klodiana Spahiu, Ilirian Pendavinji, Dasantila Tahiraj, Florenc Spaho, Niko Kuri, Shpresa Marnoj, Mirela Pitushi, Tatjana Piro, Lindita Buxheli, Ilir Metaj, Anila Denaj, Gertjan Deda, Petrit Vasili, Grida Duma, Mesila Doda, Orjola Pampuri, Tritan Shehu, Zheni Gjergji, Ilda Dhori, Seladin Jakupllari.

#### **Të ftuar:**

Enkel Joti - Drejtor i QSUT-ës

Birkena Qiriazhi – Nëndrejtoreshë e QSUT-ës

Mihal Tase – Shef shërbimi në mjekësinë interne

Artan Goda – Shef i kirurgjisë kardiake

Anila Godo – Shefe e shërbimit onkohematologjik

Eqerem Hasani – Shef i shërbimit të sëmundjeve të brendshme

Silvana Çeliku – Shefe e shërbimit të onkologjisë

Gjeorgjina Kuli (Lito) – Shefe e shërbimit pediatrik

Ilir Ohri – Shef i shërbimit anestezi-reanimacion

Arjana Starkosha – Shefe e shërbimit të mikrobiologjisë

Edlira Bode - Drejtoreshë e spitalit të traumës

Silva Bala - Drejtoreshë e spitalit “Shefqet Ndroqi”

Prof. dr. Arben Gjata - Rektor i Universitetit të Mjekësisë

## HAPET MBLEDHJA

**Albana Vokshi** – Mirëmëngjesi!

Ju kërkoj shumë ndjesë, që ju detyruam të vinit nga kati i dytë, këtu, në dy salla, por edhe për ju është shumë i rëndësishëm distancimi! Ju kërkoj ndjesë dhe për kohën, sepse po fillojmë me vonesë dhe koha juaj pranë spitaleve, pranë pacientëve është shumë më e rëndësishme, por konsideruam që edhe dëgjesa në këtë komision është po aq e rëndësishme!

Po bëjmë një diskutim për buxhetin e vitit 2022. Komisioni ynë ka shqyrtuar këto ditë buxhetin për shëndetësinë dhe mirëqenien. Gjithsesi, të gjithë deputetët e komisionit kanë vendosur të bëjnë një dëgjese me ju. Kjo dëgjese është për të qenë në krahun tuaj. Nëse keni nevoja që nuk i shihni të plotësuara në buxhetin e vitit 2022, ju lutem, na thoni, sepse ne mund të ngremë zërin dhe shpresojmë shumë që edhe Komisioni i Ekonomisë mund të akomodojë nevojat që ju i shihni të domosdoshme dhe që nuk janë parashikuar në buxhetin e vitit 2022! Pra, na shihni si aleatë, na shihni në krahun tuaj dhe si mbështetësit tuaj.

Për kancerin e gjirit ne kemi bërë një takim në sallën e mbledhjeve, por me drejtues të spitalit onkologjik. Doktorët e spitalit na parashtruan disa kërkesa, ndaj menduam që edhe secili prej jush, në këto kushte, mund të kishte një nevojë të caktuar për t'u parashikuar në buxhet.

Pa humbur kohë, po ia kaloj fjalën rektorit të universitetit. Ne kemi marrë sot një material, të cilin nuk kemi arritur ta lexojmë me detaje, vetëm i kemi hedhur një sy.

Kështu që, ju lutem, rektor, na shpjegoni dhe na thoni se çfarë mund të bëjmë më shumë në këtë vit për ju!

**Arben Gjata** – Faleminderit!

Është një risi shumë e mirë kjo, që të jemi të gjithë bashkë dhe të diskutojmë të gjithë bashkë.

Do të ndalem kryesisht te problemet që ka Universiteti i Mjekësisë, që nuk janë vetëm probleme buxhetimi, por, në radhë të parë, mendoj se sidomos për universitetet ka disa probleme, të cilat kanë të bëjnë me ligjin, jo me ligjin e arsimit të lartë, por me ligjin e buxhetit. Universitetet trajtohen njësoj si institucionet e tjera, pra janë të detyruara të bëjnë në tetor buxhetin, në janar duhet të fillojnë prokurimet publike dhe t'i mbyllim në tetor të vitit tjetër.

Çfarë ndodh me universitetet? Universitetet kanë një problem specifik. Në tetor në bëjmë buxhetin, granti i qeverisë na vjen në janar. Ndërkohë, përveç grantit që kemi në janar, kemi edhe

paratë e trashëguara, sepse ne jemi një institucion që i trashëgojmë paratë, por nuk e dimë sa do të jetë sasia e parave të trashëguara, sepse, për arsye të ndryshme, qeveria mund t'i marrë, t'i rialokojë ato fonde dhe, si përfundim, në janar bëhet një tjetër rishikim i buxhetit. Pasi bëhet rishikimi i buxhetit, duhet të kalojnë në senat akademik, në bordin e administrimit, si dhe periudha që aprovohet. Realisht, buxheti bëhet efektiv, në rastin më të mirë, në fund të shkurtit dhe ngelin muajt mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator dhe në tetor mbyllet e nuk bëhen dot blerje. Ky nuk është problem vetëm për Universitetin e Mjekësisë, por besoj se është një problem për të gjitha universitetet. Për shkak se dihet se si shkojnë proceset e prokurimit në Shqipëri, ankimimet në APP, që kthehen e bëhen prapë, ne realizojmë një sasi të ulët të blerjeve që duhet të bëjmë dhe vazhdojmë të trashëgojmë para për vitin tjetër. Ndoshta duhet ndërhyrë, unë e ka thënë dhe vjet, kur e kam ngritur këtë çështje edhe në Komisionin e Ekonomisë, por nuk ka gjetur zgjidhje. Duhet të ketë një zgjidhje ligjore, se ne i shkruajmë vetë ligjet, por nganjëherë nuk ka përse të bëhen ligjet pengesë për zhvillimin.

Kemi dhe një moment të dytë të rëndësishëm. Faktikisht, dua t'i falënderoj të gjithë kolegët që janë këtu dhe, gjithashtu, drejtorinë e spitalit, Ministrinë e Shëndetësisë e të tjerë, për bashkëpunimin shumë të mirë që kemi pasur, pasi që nga viti i kaluar, me vendimin e ri të Këshillit të Ministrave, pedagogët klinikistë paguhen gjithashtu dhe nga spitali, ku marrin një rrogë të dytë, gjë që ka bërë të mundur një rritje të ndjeshme të të ardhurave që marrin mjekët klinikistë, pedagogë në të ardhurat e tyre, pasi ishim akoma me disa pagesa që nga viti 2004, kur ishte një VKM për *appurtenance*-ën dhe kishin paga që shkonin 80-120 mijë lekë të vjetër, që ishte pjesa më e madhe. Sot mjekët e klinikistë, pra pedagogët klinikistë, përveç rrogës që marrin nga universiteti, marrin dhe një rrogë tjetër të dytë nga QSUT-ja, gjë që është shumë mirë qoftë për rritjen e bashkëpunimit, qoftë për rritjen e përgjegjësisë, qoftë dhe për pagesën që marrin për gjithë atë punë shumë të madhe që bëjnë në QSUT ose në spitalet e tjera universitare.

Faktikisht, një nga gjërat që kemi vendosur ta theksojmë fort në të ardhmen është forcimi i programeve të edukimit në vazhdim. Kemi pasur disa projekte me UNICEF-in, Organizatën Botërore të Shëndetësisë, HAP-in e të tjera, të cilat kanë pasur të bëjnë me programet e edukimit në vazhdim. Ne do ta forcojmë këtë dhe, gjithashtu, në kuadër të Paktit për Universitetin, sipas kritereve që kemi përcaktuar ne, është përgatitur nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë një projekt, i cili parashikon ndërtimin e një qendre simulimi klinik dhe edukimi në vazhdim, aty ku sot është 6-katëshi. Është një projekt supermodern, i cili do t'i jepte shumë frymëmarrje universitetit dhe

formimit qoftë të specializantëve, qoftë dhe të studentëve, pasi sot ne nuk kemi trupa dhe anatomia bëhet vetëm me libra. Ndërmjet të tjerave, aty parashikohet krijimi i një kabineti 3D, ku do të jenë të gjitha mundësitë që anatomia të bëhet në mënyrë virtuale. Do të ketë kabinete, ku njerëzit të mësojnë të operojnë para se të hyjnë në operacion, po prapë në mënyrë virtuale e të tjerë dhe është çuar për t'u financuar ky projekt me fondet IPA nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Nëse do të kishit mundësi, të lobonit pranë strukturave përkatëse të Bashkimit European, në mënyrë që ky projekt të aprovohej, sepse është me gjithë mend një projekt që e ndryshon komplet fytyrën dhe mënyrën e organizimit të universitetit dhe të formimit të mjekëve e specialistëve të ardhshëm, gjithashtu, edhe të mjekëve në vendin tonë.

Problemi i tretë i rëndësishëm ka të bëjë me rritjen e kërkesës për mjekë. Në Shqipëri, të paktën që nga momentet kur janë hequr pjesa më e madhe e kërkesave për njohjen e diplomës, në qoftë se flasim për 6-7 vjet më parë, që të punoje mjek jashtë, duhet të shkojë të bëjë provime universitare, duhet të jepje diplomën, pra ishte një kalvar i gjatë dhe pjesa më e madhe e mjekëve preferonin të rrinin në Shqipëri sesa t'i hynin një kalvari, që mund të shkonte 2-3 vjet dhe në fund nuk dihej rezultati. Qëkur gjermanët kanë hapur mundësitë që të kesh një nivel C1 të gjermanishtes mjekësore dhe B2-shin, formimin e gjuhës, do të japësh vetëm provimin e licencës. Kjo është një portë, e cila ka bërë të rritet numri i mjekëve që largohen nga Shqipëria. Ky është një problem, i cili është diskutuar gjerësisht dhe me Ministrinë e Shëndetësisë, dhe me Ministrinë e Arsimit, sepse janë kërkesa reale dhe ne kemi nevojë të rrisim numrin e mjekëve. Është kërkuar që të paktën ta çojmë në 500 numrin e mjekëve që prodhojmë. Ne shpresojmë që, që nga viti që vjen, në bashkëpunim me Universitetin e Elbasanit dhe me Universitetin e Durrësit, të alokojmë të paktën 50 kuota në Elbasan dhe 50 kuota në Durrës, duke bërë programe studimi të përbashkëta dhe në drejtimin e Universitetit të Mjekësisë, se qëllimi është të prodhojnë mjekë jo më të dobët se ata që prodhojmë ne, pra të ruajmë standardin, edhe në qoftë se kjo do të jetë në Elbasan dhe në Durrës, duke bërë qoftë lëvizje të stafit, që mund të shkojë e të vijë në Elbasan e në Durrës, në një qytet afër, qoftë të studentëve, duke siguruar të paktën rritjen me 100 kuota të pranimit të mjekëve në këto dy universitete dhe me 50 kuota të Universitetit të Mjekësisë, që ta arrijmë 150 kuota. Në qoftë se do të kemi ambientet e reja, ne shpresojmë që të paktën në krye të 2-3 vjetëve të arrijmë të hapim më shumë se 500 kuota mjekësh në vit, në mënyrë që të kemi masa për të ardhmen, që të mos ndodhemi para situatave, të cilat nuk i do askush, që të kemi mungesa të rëndësishme të mjekëve në rang vendi.

Një pjesë tjetër jua kam thënë aty, por këto ishin gjërat kryesore.

Kemi dhe dy godina, por ato janë të dëmtuara nga tërmeti dhe nuk janë futur akoma. Ka qenë faji ynë, faktikisht, sepse ana administrative nuk është mbyllur akoma; janë problemet me ligjet. Është mbyllur vlerësimi dhe do të dërgohen në Ministrinë e Rindërtimit, në mënyrë që të financohet jo vetëm rikonstruksioni, sepse ato nuk janë ndërtesa që duhen shembur, por meqenëse kanë qenë të vjetra, mendojmë se nuk duhet të kthehen në situatën ku kanë qenë, por duhet të rikonstruktohen, që të kthehen në ndërtesa me kushte bashkëkohore për studentët.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit shumë, doktor!

Po ia kaloj fjalën drejtorit të QSUT-ës.

Sot nuk jemi këtu për performancën e QSUT-ës, këtë do të bëjmë një herë tjetër, si dëgjuesë më vete. Sot po flasim për buxhetin e vitit 2022. Në dy vitet e fundit ju keni pasur një ngarkesë shumë të madhe. Keni pritur shumë pacientë dhe në kushte shumë të vështira, për të cilët ju falënderojmë të gjithëve për mundin e bërë, sidomos doktorët me punën e tyre, me shumë përkushtim! Pra, buxheti i vitit 2022, duke pasur parasysh që situata e Covid-it vijon ende, a i mbulon nevojat tuaja?

A keni kërkesa të tjera apo keni qenë pjesë e negociatave me Ministrinë dhe mendoni se është në rregull?

**Enkel Joti** – Për sa i përket buxhetit, aktualisht i kemi parashtruar nevojat tona, kemi bërë parashikimin, duke marrë në referencë kërkesat e të gjitha shërbimeve që kemi. Në qoftë se vjet kemi pasur prioritet situatën me Covid-in, tani nuk është vetëm Covid-i, por janë dhe të gjitha sëmundjet e tjera. Natyrisht, edhe njerëzit e nuk kanë më frikën e mëparshme dhe për çdo problem që kanë, që e adresojnë, vijnë në shërbime, trajtohen dhe kurohen. Kështu që nevojat janë rritur, por, fatmirësisht, deri më sot nuk kemi pasur mungesa në furnizimin me barna, sidomos me ato më të nevojshmet.

Kemi pasur disa problematika për disa barna specifike, për të cilat ne kemi diskutuar dhe i kemi rihedhur disa herë për shkak të ligjit për prokurimin publik, i cili të kufizon. Ligjet janë të nevojshme, por deri diku kjo kushtëzon pjesëmarrjen e disa operatorëve. Kemi pasur raste ku disa barna na kanë munguar dhe, fatmirësisht, ne i kemi hedhur disa herë dhe tani jemi në proces finalizimi dhe kemi pasur dhe pjesëmarrës të operatorëve në këto prokurime. Deri më sot ne i kemi mbuluar nevojat qoftë me veshjet, qoftë me barnat që kanë qenë të domosdoshme për Covid-in.

Madje, jo më larg se para dy javësh, në mos gaboj, kemi pasur dhe një kërkesë nga ministria për futjen e një bari të ri, Monapinavir, nuk më kujtohet ekzaktësisht, e cila ka pasur një marrëveshje me Bashkimin Europian për blerjen e këtij bari, që është një risi e futur nga firma farmaceutike Pfizer. Kemi bërë kërkesën tonë, duke iu referuar shërbimeve infektive që mbulojnë Covid-in qoftë adult, qoftë pediatrik. Kemi nisur nevojat tona dhe presim të furnizohemi me këtë bar. Kështu që deri më sot, për hir të së vërtetës, nuk është se kemi pasur problematika.

Ndërkohë, kemi pasur një furnizim të vazhdueshëm edhe me materiale, siç e thashë më parë, por edhe me pajisje. Aktualisht, po mbulohen edhe një pjesë e nevojave që kemi pasur dhe më parë, kur i kemi bërë kërkesa ministrisë.

Për sa u përket nevojave të vitit 2022, e thashë, ne i kemi prezantuar ato, por, që të jemi të qartë, ende nuk e dimë se sa prej tyre do të plotësohen, sepse, në dijeninë time, jo të gjitha nevojat plotësohen nga buxheti, por një pjesë e tyre janë dhe nga fondet IPA, siç tha dhe profesor Gjata, apo dhe nga marrëveshjet që ka pasur ministria, në dijeninë tonë, me Bashkimin Europian apo me Bankën Botërore.

Ndërkohë, jemi duke bërë dhe investime në godina, qoftë në spitalin e sëmundjeve të brendshme, qoftë në spitalin pediatrik, qoftë dhe rikonstruksionin e spitalit infektiv, që do ta fillojmë së shpejti. Të gjitha këto janë investime madhore dhe, në fakt, QSUT-ja është kthyer në një kantier ndërtimi.

Këto ishin në vija të përgjithshme. Isha përgatitur, sepse mundova se mund të kishit ndonjë pyetje që mund t'i përgjigjeshim.

**Albana Vokshi** – Dakord.

Gjithsesi, kemi ende disa ditë kohë, deri sa të kalojmë në diskutimin nen për nen, ku do të diskutohen të gjithë komponentët e buxhetit për shëndetësinë.

Nëse doni më shumë kohë, mund ta merrni dhe të dërgoni një relacion me shkrim, nëse keni nevoja konkrete, që i shihni të paakomoduara në buxhetin e vitit 2022.

Faleminderit!

Po ia kaloj fjalën Edlira Bodes. Kam përshtypjen se sapo është emëruar në Spitalin e Traumës. Suksese!

**Edlira Bode** – Faleminderit!



Në fakt, ashtu është, jam më e reja në detyrë krahasuar me kolegët. Megjithatë, kam pasur kohë të mjaftueshme të njihem me institucionin dhe me problematikat qoftë në planin e shërbimeve, qoftë në planin buxhetor.

Mund të them që, për sa i përket buxhetit, spitali i traumës ka pasur një mbulim të mirë, edhe për faktin se ka fatin të jetë i mbuluar nga buxhetet e dy ministrive. Pra, Spitali i Traumës e ka këtë veçanti, që buxhetohet qoftë nga Ministria e Shëndetësisë, qoftë dhe nga Ministria e Mbrojtjes.

Programet që kanë marrë vëmendje gjatë viteve të fundit, pra jo vetëm në vitin e fundit, kanë qenë ato të mbulimit të shërbimeve të ortopedisë dhe të neurokirurgjisë. Ka qenë një situatë e vështirë, ndërkohë që të paktën është mundur të sigurohet mbulimi i shërbimeve urgjente, pra rastet urgjente kanë marrë shërbim në spitalin e traumës dhe jemi duke punuar, që të mbulojmë sa më shumë edhe ato të planifikuarat, nevoja të cilat, në fakt, janë gjithnjë e në rritje dhe do të kërkojnë buxhete gjithnjë e më të mëdha.

Prandaj, meqenëse jam këtu, dua t'i tërheq pak vëmendjen e Ministrisë së Shëndetësisë, që, nëse mundet, të ketë vëmendje më të shtuar dhe ta shtojë buxhetin për këto dy programe. Është një program informatizimi spitali, diçka shumë e mirë, sepse arrihet të zgjidhen problemet dhe të jepet informacion në kohë reale qoftë për disponibilitetin e shtretërve spitalorë, harxhimet dhe kostot spitalore, sepse kartela elektronike hapet sapo pacienti hyn në spital, prandaj do të dëshironim që vitin që vjen ta çonim më tej këtë në mënyrë që edhe përgjigjet e ekzaminimeve laboratorike apo imazherike të shkojnë në mënyrë elektronike menjëherë te shërbimi përkatës. Unë mendoj se edhe kjo gjë do të kërkojë një buxhet, prandaj kërkon vëmendje.

Nuk mund të mos ju them fjalë të mira për mënyrën se si më janë përgjigjur sapo unë mora detyrën, në veçanti Ministria e Mbrojtjes, patjetër edhe Ministria e Shëndetësisë, kjo për shkak të konsumit më të shtuar gjatë vitit që jemi në Spitalin e Traumës dhe në Shërbimin e Kirurgjisë, sepse për shkak të pandemisë QSUT-ja nuk mundej t'i përballonte urgjencat kirurgjikale kështu që ato i mbuloi Spitali i Traumës, të medikamenteve dhe të materialeve mjekësore përveç gjërave të tjera.

Unë e kam gjetur spitalin në vështirë financiare, për të cilat m'u përgjigj menjëherë Ministria e Mbrojtjes, qoftë kjo për shkak të rritjes së pagave, që nuk ishin parashikuar që në fillim të vitit, qoftë edhe për medikamentet dhe materialet mjekësore që ishin konsumuar më shumë gjatë vitit, duke shpresuar se këtë mbështetje do ta kem edhe në vazhdim.

Nëse mundem, meqenëse jam përpara ligjvënësve, kam konstatuar një problematikë, gjë që ma kanë sjellë në vëmendje punonjësit shëndetësorë ushtarakë të Spitalit të Traumës, ku këta punonjës për shkak të gradave që ata kanë nuk përfitojnë pagesat shtesa qoftë për turnet e dyta apo të treta, pra infermierët apo mjekët, qoftë edhe rritjen e pagës së personelit shëndetësor, gjë, të cilën e ka marrë i gjithë personeli mjekësor civil i Spitalit të Traumës, ndërsa ai ushtarak jo. Unë nuk e di ku qëndron problemi, mendoj se duhet të jetë ligjor, por nëse mundeni të na ndihmoni ju si ligjvënës do ta vlerësoja shumë.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, drejtoresha!

Ju lutem, nëse ka mundësi të na përgatisni një raport me shkrim edhe sa u përket vlerësimeve buxhetore që ju keni bërë dhe sa ju duhet për secilin komponent, por edhe për kërkesën që sapo parashtruat për punonjësit ushtarak!

Faleminderit!

Fjalën e ka doktoreshë Silva.

**Silvana Çeliku** – Si parafolësja, edhe unë jam drejtoreshë e re, por jam mjeke e vjetër në atë vend, madje jam rritur aty. Spitali në të cilin unë punoj ka dalë nga një punë shumë e madhe, nga një spital Covid prej 1 viti e gjysmë dhe tani mund t'ju them se është gjysmë Covid, sepse trajton post-Covidin. Pra, të gjithë duhet të kuptojnë që volumi i punës së atij spitali është shumë i madh, por kjo nuk ka kufizuar pjesën e shërbimit të kardiokirurgjisë, i cili ka përfunduar dhe javën tjetër do të finalizohet me fillimin e interveneteve të para në kardiokirurgji.

Ndërkohë, ka nisur puna për sistemin e kondicionimit për të gjithë spitalin, i cili është vënë në funksion këto ditë. Për hir të Covid-it, më duhet t'ju them këtë, buxheti i kaluar ka sjellë që të mos kem pengesa sa i takon pjesës së antibiotikëve, duke trashëguar nga paraardhësi antibiotikë dhe mendoj se nuk do të kem pengesa sa i takon trajtimit të post-Covid-it, por edhe të materialeve mbrojtëse, pasi e gjithë situata është që t'i kemi veshët lart për t'i paraprirë ndoshta një vale të re të Covid-it dhe në bazë të strategjive të përpiluara nga Ministria e Shëndetësisë ne jemi në gatishmëri të plotë nëse do të kthemi plotësisht apo pjesërisht në një spital Covid-i. Kur them se jemi një spital post-Covid e kam fjalën për faktin se aty trajtohen shumë pacientë, të cilët jo më pak se Covid-i kanë koston e tyre të trajtimit.

Sa i takon buxhetit të vitit 2022 janë planifikuar të përtërihen shumë zëra për faktin se për 1 vit e gjysmë vetë Covidi na e pengoi këtë gjë. Pra, që me ndërhyrjen për bërjen e sallave të reja

të kirurgjisë, pajisjen me sistemin Vats që u duhet kirurgëve të Toraksit deri te pajisja e kabineteve të provave funksionale të mushkërive, të bronkoskopisë dhe e pjesës së sëmundjeve të gjumit. Kjo është pjesa e buxhetit e planifikuar për vitin 2022 për këtë spital, i cili është planifikuar që të jetë një spital multidimensional dhe jo më vetëm për sëmundjet respiratore, por edhe për kardiologjinë, kardiokirurgjinë, kirurgji të përgjithshme, kirurgji torakale, interne, si dhe pjesa e pneumologjisë që është shërbim universitar dhe që ka pjesën më të madhe të shtretërve.

Nuk mund t'ju them se ka pasur pengesa për antibiotikë, gjë, të cilën e kemi të parën, por nuk na ka munguar as oksigjeni, sepse në kohën e Covid-it kemi qenë të pajisur me dy linja oksigjeni në mënyrë që pacientët të mos kishin probleme, me *hi flow*, respiratorë, *CPAP*, *BiPAP*. Pra, tashmë është ngritur një bazë për të pritur qoftë post-Covid-in apo Covid-in dhe e gjithë vëmendja jonë është në këtë drejtim, pavarësisht se ne normalisht si risi tonën javën tjetër kemi pjesën e hapjes së kardiokirurgjisë.

Pra, duke e pasur vëmendjen në këtë pjesë, mendoj se 50% e buxhetit tonë shkon për medikamente, materiale e gjëra të tjera, si dhe kemi ende shumë rezerva të veshjeve izoluese të personelit, pasi edhe personeli i post-Covid-it duhet të jetë i mbrojtur.

Ndërkohë unë kam edhe pjesën paraspitalore të urgjencës, e cila normalisht ka mangësi të personelit, gjë, të cilën ia kam bërë të ditur edhe ministrisë, sepse duhen mjekë, infermierë dhe shoferë. Kjo ka ardhur si rezultat i largimit të njerëzve, të cilët kanë dalë në pension, por që duhen zëvendësuar sa më shpejt për vetë faktin se Urgjenca e Tiranës mbulon një zonë shumë të madhe të Tiranës sa u takon urgjencave.

Këto ishin ato që unë kisha për t'ju parashtruar si drejtoreshë e re që jam. Nëse keni ndonjë gjë për të më pyetur jam gati.

**Albana Vokshi** – Në fillim do t'ju dëgjojmë dhe më pas nëse kolegët kanë pyetje do t'ju adresojnë.

Profesor Mihal Tase, a keni ndonjë problematikë që doni ta parashtroni në mënyrë që t'ju ndihmojmë, qoftë buxhetore, qoftë jobuxhetore?

**Mihal Tase** – Faleminderit!

Shërbimi ku unë jam pjesë është shërbim transversal i mjekësisë interne, i cili ka sëmundje të të gjitha llojeve, kryesisht të sëmurë të moshuar me shumë patologji. Te ne nuk është problem teknologjia, sepse i kemi ato që duhen për një shërbim, ndërsa të tjerat janë shërbime në radiologji e laboratorë për të gjitha spitalet.

Në shërbimin ku bëj pjesë janë kryesisht të sëmurë të moshuar, gjë, e cila shpeshherë në një realitet social të ri për ne mjekët e vjetër, është fakti se ata jetojnë të vetmuar dhe nuk kanë vetëm kërkesa për një ndihmë mjekësore, kryesisht medikamente dhe ekzaminime, por kanë nevojë edhe për asistencë. Ne e kemi kërkuar këtë gjë edhe më parë, por nuk e di sesa do të reflektohet, që të ketë një personel më të shtuar te ne, kryesisht infermierë dhe ndihmës.

Sa u takon mjekimeve nuk kemi pasur mungesa. Siç jua thashë, shërbimi ku unë jam nuk kërkon ndonjë teknologji, por kërkon më shumë dashurinë për njerëzit dhe më shumë dije, për faktin se të sëmurët kanë shumë patologji, pra nuk është thjesht një sëmundje dhe do të merresh vetëm me të.

Sa i takon buxhetit, buxhetet ne i kemi bërë në mënyrë historike, duke parë sa i kemi pasur vitet e mëparshme, por natyrisht kemi një tendencë për të kërkuar më shumë.

Meqenëse jemi në një komision ku shumica e anëtarëve janë mjekë, do t'ju sugjeroja, duke u nisur nga eksperiencat e mëparshme, por edhe nga diskutimet me kolegët, që në shëndetësi të bëhen disa ndryshime. Për shembull, sa i takon ligjit të prokurimeve ai nuk mund të funksionojë, pasi kam qenë edhe vetë drejtor para disa vitesh dhe për këtë po ju them, sidomos sa u takon spitaleve dhe mjekësisë, sepse ky ligj është edhe për rrugët apo edhe për gjëra të tjera.

E para, ne shpeshherë kemi urgjenca që nuk të japin kohë.

E dyta, mjekësia në vetvete është një gjë e paparashikueshme, nuk është ekzakte vetë shkenca mjekësore dhe jo pastaj të bësh parashikime për vitin që je apo për vitet që do të vijnë. Kjo gjë bën që ne shpeshherë të kemi kërkesa që na rezultojnë të tepruara dhe kjo gjë bën që të kemi humbje të medikamenteve që janë jashtë skadence e tjera, ose kemi kërkuar pak nga frika se mos kërkojmë shumë dhe kemi ngelur pa gjë. Unë mendoj që prokurimet në shëndetësi duhen parë në mënyrë të veçantë, megjithatë kjo është një çështje e ligjvënësve, e juaja, në mënyrë që ta diskutoni dhe ta mendoni mirë këtë fakt. Drejtoria e spitaleve duhet të ketë drejtë të bëj shuma më të mëdha, sepse me 3 milionë lekë të vjetra (e keni bërë 10, kjo zgjidh diçka, pot jo të gjitha gjërat) nuk mund të bëhet gjë, sepse mjafton të digjet llamba e skanerit dhe për të duhen 50 mijë euro, të cilën duhet ta bësh me tender, ndërkohë që dihet se kë do të blesh, por edhe shumë gjëra të tjera.

Unë mendoj se kjo gjë është shumë e rëndësishme për ta bërë këtë sa më funksionale në mënyrë që t'u përgjigjemi në mënyrë adedukate nevojave që mund të kemi, të cilat mund të jenë të paparashikueshme.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, profesor!

Problematikën që ju parashtruat e kemi ngritur edhe mes nesh jo më larg se dje. Ne do t'i drejtojmë një kërkesë Komisionit të Ekonomisë, sepse janë ata që e diskutojnë ligjin e prokurimeve. Nëse drejtori është dakord ne e marrim edhe si kërkesë zyrtare dhe e parashtrajmë, duke shpresuar që mund të ketë ndonjë hapësirë, sepse për mua është jetike që të operohet në mënyrë të menjëhershme, sepse sëmundja nuk pret dhe këtë ju e dini më mirë.

Fjalën e ka profesor Artan Goda.

**Artan Goda** – Përshëndetje!

Unë jam përfaqësues i kardiologjisë, e cila është një nga fushat më të rëndësishme në të gjithë mjekësinë, kjo për shkak edhe të numrit të lartë të të sëmurëve dhe të risqeve për mortalitet, ku përfshihen rreth 40-50% e mortaliteteve në tërësi në raport me të gjitha sëmundjet e tjera.

Të flasësh për suksese kjo është diçka e zakonshme për ne, pasi këtë e bëjmë në çdo mbledhje dhe nuk po qëndroj këtu, por dua t'ju përmend 2-3 gjëra. Kardiologjia ka bërë një hap të rëndësishëm gjatë këtyre viteve të fundit në shtrirjen e shërbimit intervecionues në të gjithë vendin. Dihet që sot qytetari shqiptar përfiton në shumë pika, jo vetëm në Tiranë, për urgjencën aty ku ka nevojë të infarktut akut, miokardit, aktualisht edhe në Fier dhe në Shkodër, edhe pse kjo nuk është gjithçka, por kjo tregon se jemi një hap përpara duke u shtrirë edhe më shumë, sepse urgjenca nuk pret.

Pesha kryesore, në mbi 95% të rasteve, bëhet në qendrën tonë spitalore, e cila është sot për sot qendra më e madhe europiane për ndërhyrjet e infarktut akut, miokardit, kjo jo për meritën tonë për të qenë të qartë, jo se jemi më të zotët se europianët e tjerë, por nga halli, sepse duke qenë pak qendra të tilla gjithçka përqendrohet në spitalin tonë dhe ne jemi të detyruar t'u përgjigjemi. Për fat të mirë, deri më sot, pra nëse flasim me shifra, 11 nëntor 2021, kanë qenë rreth 1650 urgjenca të infarktut akut, miokardit, që janë bërë në spitalin tonë dhe imagjinohet që ky numër deri në fund të vitit të jetë afro 2000. Qendrat europiane e kanë mesatarisht 300 infarkte në vit, ndërsa qendrat më të mëdha e kanë mesatarisht 800 deri në 900.

Edhe pse kjo duket si sukses nuk është sukses, pasi kjo është diçka që kërkon një shtrirje më të gjerë të këtij shërbimi për të sëmurët, hapat janë bërë, ka projekte për shtrirje të mëtejshme dhe jam me shpresën se do të realizohet shpejt.

Sa i takon faktit për të cilin po bëhet ky takim, pra me çfarë mund të na ndihmojnë më shumë ligjvënësit në aktivitetin tonë, e mbështes atë që tha profesor Mihali, madje administrata e

mbështet më shumë sesa ne, sepse ata janë më në siklet sa u takon emergjencave të ndryshme dhe duhet të ketë një hapësirë më të madhe për operim të drejtpërdrejtë në rastet e përcaktuara kur janë emergjenca. Nga ana tjetër sa i takon ligjit të prokurimeve duhet kuptuar që mjekësia ka një specifikë të veçantë, pra praktikisht ne i qëndrojmë parimit të blejmë sa më lirë dhe ku çmimi më i ulët fiton, sepse praktikisht në këtë mënyrë na duket sikur kursejmë.

Sigurisht, kjo ka ardhur si rezultat i shqisave patologjike që kemi ne si administratë, si shoqëri ku kultura na bën të devijojmë herë pas here në mënyrë të padrejtë dhe ndoshta kjo e ka imponuar këtë gjë për të shkuar në kursim. Në fakt, kjo të bën të shpenzosh më shumë, sepse praktikisht në shumicën e vendeve që janë model për ne dhe ku ne trumbetojmë gjithë ditën të shkojmë drejt tyre, nuk është më i liri, por më i miri përkundrejt një fondi limit që i përshtatet një numri të detyruar procedurash që ti do të bësh.

Në këtë mënyrë neve na duket sikur do të shpenzojmë më shumë, por në fakt kemi një numër më të vogël komplikacionesh sepse kemi materiale më të mira përkundrejt fondit limit që është përcaktuar ndaj procedurave që ti ke për detyrë t'i bësh dhe në këtë mënyrë do të kesh më pak komplikacione më pak, sigurisht do të kesh më pak humbje jete, humbja e jetës ndoshta kthehet në kursim, por jam duke folur për komplikacione që janë shpenzime dhe këto shpenzime bëjnë që ti të blesh më shtrenjtë.

Pra, ligji i prokurimeve në shëndetësi nuk mund të jetë i njëjtë sikur blen domate apo patate kur blihen stenda apo unaza, katetier, të cilat nëse i blen siç duhet, të bëjnë të kursesh më shumë dhe të kesh mundësi të bësh më shumë procedura, përveç suksesit që ka të bëjë me shëndetin e njerëzve dhe për të cilën ne jemi këtu.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Shumë faleminderit, profesor!

Profesoreshë Anila.

**Anila Godo** – Në fakt, unë nuk dua t'ju ha shumë kohë dhe të bëhem e bezdisur duke përsëritur njëri-tjetrin. Rektori dhe drejtori në mënyrë të përgjithshme i paraqitën dëshirat apo shqetësimet tona, të cilat i kemi ezauruar në mbledhjet e rektoratit dhe të drejtorisë për një standard më të mirë të mësimdhënies dhe të procesit klinik, diagnostik dhe terapeutik që janë shumë të lidhura me njëra-tjetrën.

Ndoshta do të bëhem pak e bezdisur duke përsëritur dhe kërkuar edhe një herë vëmendjen tuaj për një problem që e ngriti si drejtori dhe unë në sektorin tim, për kë nuk më njeh, jam shefja e Onkoematologjisë Pediatrike, hasem shumë me këtë problem, që nuk po gjen zgjidhje.

Kjo ka të bëjë me ligjin e prokurimeve dhe tenderimeve, e tha edhe Mihali, që kështu e kemi gjetur dhe kështu po e vazhdojmë, por puna është SE duhet gjetur një zgjidhje.

Mund të jem dakord me buxhetin që më është caktuar. Më vjen një listë nga drejtorja, që më kënaq. Problemi është se kur vjen puna e realizimit të medikamenteve të citostatikëve, gjendem shpesh para kësaj situatë, pasi mungon ky medikament, që mund të jetë i shtrenjtë dhe i lirë, siç e di edhe drejtori, dhe nuk kemi shpresë të vijë, sepse nuk është realizuar tenderi për arsye që nuk varen nga ne dhe nga strukturat e institucionit. Më falni që hyj në detaje, por ky medikament është shumë i rëndësishëm për ne!

Tumoret e veshkave te fëmijët, që janë rreth 8 raste në vit, 8 fëmijë që kërkojnë jetë, në qoftë se këto tumore mjekohen mirë, në Shqipëri, në sektorin tim, kanë 90% shërim. Këta fëmijë rriten, bëhen burra e gra e trashëgohen.

Është një medikament që nuk ka alternativë tjetër. Më thotë edhe drejtori në bashkëpunimin që kemi – “Anila, nuk ka ndonjë alternativë tjetër për këtë medikament?”. Ky citostatik nuk ka alternativë tjetër, është i caktuar në skemat europiane dhe unë nuk gjej të drejtën as shkencore, as humane ta ndryshoj këtë skemë dhe do të ishte një gabim i madh ta bëja këtë, pasi mund të penalizohem.

Del përgjigja që tenderi nuk është bërë, kompanitë nuk vijnë se nuk kanë interes, pasi është sasi e vogël dhe nuk u intereson të marrin pjesë në tender. Pra, për arsye që nuk varen nga ne, dështon. Për këtë duhet të gjendet një zgjidhje, sepse në çastin që mua më dështon tenderi në spital, këto ilaçe hyjnë në rrugë joligjore, pa kaluar te kontrolli i barnave. E keqja më e madhe (unë e kam thënë në një intervistë në vitin që kam qenë ministre) është se unë e para e lejoj që prindi t’i gjejë nëpër farmaci, edhe pse unë kam një rezervë për sigurinë e tyre, sepse kanë hyrë jashtë kontrollit të barnave. Duke dashur të plotësoj skedën e mjekimit, them mirë që e gjeti, edhe me një rezervë timen, gjithashtu, nuk kam të drejtën që t’i them një prindi që është kjo skemë mjekimi, që unë nuk e kam dhe as ti mos e bli, ndaj e lejoj të bëhet në spitalin tim dhe do të vazhdoj ta lejoj, se nuk e marr dot përsipër.

Dolëm pak nga tema, sepse jemi mbledhur për buxhetin sot, por ju jeni ligjvënësit, ndryshuesit, ka VKM, ka amendime, modifikime. Pra, duhet të gjendet një rrugëzgjidhje në çastin

që tenderi dështon për arsye që nuk varen nga strukturat tona. Çfarë duhet të bëjmë dhe si duhet ta zgjidhim? Duhet të ketë një VKM.

Në qoftë se pacienti e gjen në një farmaci private, atëherë le të shkojmë ne si institucion ta blejmë në Turqi, në Itali apo kudo qoftë. Duhet të ketë disa klauzola dhe rrugëzgjdhje, sepse ky problem na është bërë i mprehtë. Duket sikur ne shfajësojmë veten dhe u themi pacientëve që dështoi tenderi jo për fajin tonë, ndërkohë që atij nuk i duhet kjo.

Mendoj se çdo cenim i atij protokolli do të thotë rritje mortaliteti për atë grup fëmijësh që bota sot nga dita në ditë po e rrit aq shumë mbijetesën cilësore dhe jetën, saqë nuk kemi të drejtë t'u cenojmë jetën atyre fëmijëve.

Problemi tjetër që e ngriti edhe Mihali është se unë kam citostatikët, që janë shumë të shtrenjtë dhe kur bëj porositë mendohem shumë, dhe jo vetëm ne, por edhe Italia, Amerika nuk kënaqen ndonjëherë me buxhetin e tyre, pasi për shëndetin duan gjithmonë më shumë dhe përpiqem të jem ekonomiqare, të mos vë më shumë seç duhet, sepse rri me tmerrin që në fund të vitit disa ilaçe mund të më skadojnë dhe për medikamentet tona do të thotë shumë e madhe që skadon. Mos duhet parë njëloj prokurimi tjetër, 2-3-vjeçar? Ne tenderat për imazh i bëjmë, por kur vjen fundi i vitit na thuhet shiko se në janar të skadojnë kaç flakonë asparaginazë, që të dhemb në shpirt, se do të thotë shumë para të hedhura dëm dhe nuk e kam këtë luks të hedh para. Mos duhet gjetur një mënyrë tjetër për shëndetësinë, që unë të kem një akses, hapësirë dhe kohëzgjatje më të madhe të prokurimit, në mënyrë që të mund të lëviz brenda dhe të përdor ato medikamente që po më skadojnë, pastaj di unë si lëviz dhe farmacia apo drejtoria por duhet të ketë disa modifikime, sepse të vjen keq kur ti e ke në listë medikamentin, e ke në buxhet dhe faktikisht medikamenti nuk shkon tek i sëmuri, për më keq akoma hyn nga rrugë të dyshimta, i sëmuri e bën dhe unë e pranoj.

**Albana Vokshi** – Faleminderit, doktoresha!

Profesor Eqerem Hasani, fjala për ju.

**Eqerem Hasani** – Përshëndetje ligjvënës!

Përshëndetje kolegë!

Është e disata herë që unë paraqitem në këtë komision për probleme të ndryshme, por sot më duket vetja sikur kam dalë në pushim të madh në fillore dhe jam krejt i çliruar dhe i relaksuar për të folur në mënyrë të qartë.



Urgjenca është pasqyra e QSUT-së. Të gjithë kolegët e dinë mirë se çfarë përgjegjësie kam unë aty. I gjithë populli e sheh mirë se sa njerëz vijnë aty. As nuk dua ta përmend suportin që kam nga kryetitullarja e shëndetësisë, apo drejtori i shërbimit, a drejtoreshat mjekësore, të cilët e dinë se sa i brishtë është ai shërbim. Unë nuk kam asnjë pretendim për ilaçe apo për aparatura, por për hapësirë. Nëse njëri nga ju mund të më marrë në telefon për t'i shërbyer me diçka, do të më vinte turp kur ai më thotë që është në këmbë duke pritur, sepse nuk ka vende për t'u ulur. Hapësira është shumë e munguar. Ka 3 vjet që më është bërë suport i paparë ndonjëherë nga 2 shefat e kardiologjisë. E fillova me këto dy probleme, sepse në fund do të dal aty ku duhet.

Të sëmurët kanë qëndruar 2 javë për të bërë koronarografinë të dergjur në shtrat. Por tani ka marrë fund ajo kohë.

Tani do të dal te thelbi, thembra e Akilit. Ju lutem, ligjvënës, askush nuk do t'ju thotë gjë të bëni edhe dy spitale të tjerë rajonale. Tirana është e tejmbushur. Të gjitha lagjet vijnë në urgjencën e QSUT-së, qoftë edhe për të matur tensionin.

Kam vetëm një apel ndaj jush, hidhini ato para për të bërë dy spitalet e tjera rajonale, sepse populli qoftë nga Gjirokastra apo Erseka, duan të vijnë në Tiranë. Kjo është dëshira e tyre. A është mundësia t'u shërbehet sa më mirë në qytetin ku jetojnë, do të ishte shumë mirë, por këtë s'mund t'jua kërkojmë pacientëve.

Ju lutem, ta keni në qendër të vëmendjes, hidhini këto para për këto spitale, pasi askush nuk do t'ju penalizojë apo nuk do t'ju bëjë gjqin nëse ndërtoni dy spitale. Ndërkohë që zihen fusha të mëdha për të bërë aerodrome, le t'i bëjnë dy fusha të mëdha për spitalet rajonale, vetëm këtë apel kam, që urgjenca të shërbejë si një urgjencë moderne. Ne jemi gati të sakrifikojmë çdo gjë aty. Nuk kemi pasur asnjë pretendim për rrogat apo gjërat e tjera, por ky popull nuk e meriton që të dyndet i gjithë në urgjencë.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Shpresoj që kërkesat e mia të jenë në vëmendjen tuaj!

**Albana Vokshi** – Shpresojmë edhe ne që të na dëgjojnë!

Faleminderit, profesor!

Nëse keni gjëra për të shtuar, po ua kaloj fjalën të gjithëve që jeni prezent për të ngritur shqetësimet që keni.

Fjala për doktoreshë Silvanën.

**Silvana Çeliku** – Faleminderit shumë që na keni ftuar!

Jam shumë mirënjohëse pas bisedës që bëmë bashkërisht dhe faleminderit që na dëgjoni! Kjo është shumë e rëndësishme, edhe nëse nuk do të plotësohen të gjitha kërkesat, sigurisht që një pjesë do të merret në konsideratë.

Ne e dimë që mjekësia është shumë e shtrenjtë kudo në botë, sidomos onkologjia, pas sëmundjeve kardiovaskulare, sëmundjet tumorale kanë vdekshmëri më të lartë dhe ju e dini mirë. Çdo ditë e më tepër ne trajtojmë raste që nuk janë trajtuar më parë, numri i tyre sa vjen dhe rritet, kështu që edhe buxheti që ne kërkojmë është tepër i madh dhe unë kënaqem kur në spitalin tim ekzistojnë sot medikamente që më parë ne nuk i kemi ëndërruar. Tashmë jo vetëm që ekziston baza, ne kemi medikamente jo vetëm të kimioterapisë, por të target-terapisë, hormon-terapisë, medikamente të cilat më parë as që nuk mendoheshin të vinin. Sigurisht, kjo ka rritur edhe mbijetesën e këtyre pacientëve.

Por ne nuk kënaqemi kurrë. Sot do të flas për nevojat në medikamente, sepse fatmirësisht qeveria e ka pasur shumë në vëmendje onkologjinë dhe na ka mbështetur fuqimisht duke rritur buxhetin edhe për 2-3 vjet gati me 50% të atyre që ne kemi pasur nevojë, kështu që shpresoj shumë të vazhdojmë të mbulojmë të gjitha nevojat për shumicën e patologjive.

Mendoj se ka ardhur koha që Shërbimi i Onkologjisë, si një shërbim i vetëm në të gjithë Shqipërinë, të kthehet sërish në një qendër referimi, që të mos përdor fjalën “institut”, që në fakt është fjalë shumë e madhe, se të quhet institut do të duhej edhe baza kërkimore-shkencore, të cilën do të mendojmë ta bëjmë në të ardhmen.

Kemi qenë institut në fakt për 4 vjet, nga viti 1988 deri në vitin 1992, dhe fatkeqësisht u rikthyem sërish si shërbim shumë kompleks. E meritojmë të jemi institut, në fakt, sepse duke u bërë i tillë, do të kemi mundësinë ta lehtësojmë shumë edhe buxhetin e shtetit nëpërmjet shumë marrëveshjeve që mund të kemi, të bëjmë binjakëzime me spitale të tjera, të cilat do ta ndihmonin jashtëzakonisht qendrën tonë për të vazhduar.

U ngrit edhe problemi i specializimeve dhe ka ardhur koha të mos mendojmë thjesht që të marrim medikamente, por të mendojmë edhe për këtë brez, i cili duhet të specializohet, të kualifikohet dhe të rrisë njohuritë shkencore. Sigurisht, kjo gjë bëhet jo vetëm duke lexuar, por edhe duke u krijuar atyre një bazë sa më të madhe me libra e revista, të cilën po mundohemi ta bëjmë në mënyrë që Onkologjia të ketë një bibliotekë të vetën. Sot ekzistojnë të gjitha format e mundshme për ta bërë këtë gjë, njëkohësisht edhe telemedicinën, që ta kemi brenda qendrës sonë

dhe të bëjmë edhe konsulta me shumë mjekë e specialistë të tjerë, të cilët kanë bërë binjakëzimin me ne.

Kjo është një nga kërkesat, pastaj zgjidhen edhe gjërat e tjera. Ne kemi dëshira sa të duash dhe ëndërrujmë. Duke qenë se Onkologjia është një multidisiplinaritet, pra ne kemi brenda anatomisë patologjike, kemi imazherinë, kemi klinikën, pra aty bëhet diagnozë, stadifikim dhe trajtim. Kështu që, ndoshta në një të ardhme do të ishte mirë ta fuqizonim sidomos imazherinë për të dhënë një diagnozë sa më të saktë dhe të shpejtë për t'u ardhur në ndihmë pacientëve tanë. Shumë gjëra i kemi rregulluar, por shpresoj të rregullojmë edhe shumë të tjera.

Për specifikime mendoj që do të flasim. Unë do të doja të ngrija si çështje faktin pse ne nuk kemi një ligj për sigurimet shëndetësore. Duke menduar që në të gjithë botën njerëzit paguajnë, fatkeqësisht në Shqipëri mbi 70% e popullatës nuk paguajnë për shëndetin. Mendoj se ka ardhur koha që ta rishikoni këtë gjë.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, doktoresha!

Fjala për profesoreshë Gjeorgjinën.

**Gjeorgjina Kuli** – Faleminderit që na jepni mundësinë të diskutojmë problematikat tona këtu!

Unë jam shefja e Pediatriisë Infektive dhe do të doja të jepja një informacion të shkurtër, se jo gjithnjë mediat janë adekuate lidhur me informacionin për fëmijët me COVID. Që nga fillimi i pandemisë janë hospitalizuar dhe trajtuar në shërbimin tonë 500 fëmijë me COVID, prej të cilëve 80 me komplikacione kërcënuese për jetën me një mortalitet pothuajse zero.

Kemi pasur një furnizim dhe mbështetje të gjithanshme gjithë kohës, me thënë të drejtën, edhe për medikamente që nuk kanë qenë të aprovuara, se siç e dimë të gjithë në skemat e mjekimit ka pasur edhe medikamente, të cilat nuk kanë qenë të aprovuara dhe janë bërë të gjitha në kohë rekord.

Buxhetin e kemi diskutuar bashkërisht me të gjitha nevojat dhe për këtë pjesë të mjekësisë nuk kam asnjë problem.

Ne trajtojmë edhe patologji të tilla si HIV-AIDS-i, leshmanjoza dhe sëmundje të tjera infektive, domethënë jemi qendra e vetme për të gjithë Shqipërinë. Për problemin e medikamenteve të HIV-AIDS-it kemi futur skemat e reja të mjekimit, të cilat janë adekuate me të gjitha vendet europiane. Na është përgjigjur me sasinë e buxhetit, por kemi probleme me

prokurimet dhe dorëzimet, sepse për preparatet e HIV-AIDS-it prokurimi bëhet nëpërmjet UNICEF-it. Kjo është një traditë e bartur dhe ka njëfarë sigurie, por kemi një vonesë në realizimin e tenderit. Domethënë, ne bëjmë buxhetin dhe kërkesat e vitit 2021 vijnë në fund të vitit 2022, jo për fajin tonë. Kështu që, ndoshta duhet parë një klauzolë ligjore që të mund të realizohet një procedurë jo me kaq hallka burokratike në mënyrë që të jemi adekuat me furnizimin, sepse kemi fëmijë me HIV-AIDS dhe fatmirësisht janë të gjithë në gjendje të mirë shëndetësore dhe nuk kemi asnjë vdekje.

Problemi tjetër që mendoj se është i rëndësishëm dhe duhet të jetë imediat, që ka reflektim edhe nga ana e ministrisë, është problemi i logjistikës së Pediatriisë Infektive, sepse ne kemi qenë shërbimi që jemi dëmtuar më shumë nga tërmeti. Kemi funksionuar me 500 të shtruar, me gjysmën e kapacitetit. Momentalisht jemi shpërngulur në një godinë tjetër në kushte jo të lehta, por fatmirësisht nuk është pasqyruar në shërbimin e fëmijëve, por mendoj se duhet të konsiderohet. Unë e di që buxheti është alokuar dhe janë bërë të gjitha demarshet, por pikërisht këto hallkat burokratike ndoshta na i zgjasin kohën dhe ne nuk e dimë çfarë na pret. Momentalisht kemi 11 fëmijë të shtruar në një pavijon infektiv ku janë edhe pacientët e tjerë, gjithsej me 18 fëmijë. Domethënë jemi në kushtet e një emergjence të logjistikës.

Po bëhet përpjekje, në fakt punimet te spitali i ri janë bërë shumë shpejt, por mendoj se duhet të realizohen të gjitha hallkat. Ndoshta ka probleme burokratike në lidhje me kolaudimet apo problemet e godinave, sepse ne nuk e dimë çfarë na pret. Buxheti është konsultuar, medikamentet janë, kemi furnizim shumë të mirë me imunoglobulinat, të cilat fëmijët me imunodeficiencë të lindur ku kanë terapi mujore minimalisht 5-6 milionë lekë të vjetër dhe fatmirësisht i kemi pasur këto barna. Në qoftë se këta fëmijë nuk marrin këtë terapi, janë të destinuar të përfundojnë keq. Është një shërbim kompleks që ka shumë problematika, por për momentin them që emergjenca është problemi i logjistikës.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, doktoresha!

Po ia kaloj fjalën profesor Ilirit.

**Ilir Ohri** – Faleminderit!

Unë jam shefi i Shërbimit të Anestezisë dhe Reanimacionit në QSUT. Probleme ka sigurisht, por ato që na takojnë t'i zgjidhim ne brenda për brenda, nuk kanë të bëjnë për çështjen për të cilën jemi mbledhur.

Unë kam vetëm dy gjëra. Reanimacioni varet nga dy gjëra, nga aparaturat dhe nga personeli mjekësor, kryesisht infermieror. Kështu që, duhet të bëhet një ndryshim lidhur me këto të dyja.

Në lidhje me pajisjet mjekësore, në QSUT duhet të forcohet Shërbimi Biomedikal, të jepen më shumë fonde, sepse ne blejmë aparatura që kanë një servis të caktuar saç e ka firma brenda garancisë 1 vit e gjysmë apo dy vjet, dhe pas dy vjetësh këto aparatura të hidhen në koshin e plehrave, sepse nuk merret më njeri me to. Është gjynah që një pajisje të dalë jashtë përdorimit.

Njerëzit në mënyrë private ua bëjnë servisin makinave të veta dhe e mbajnë makinën, kurse pajisjet mjekësore ngelen aty dhe hidhen poshtë. Pra, kjo duhet që të forcohet si kërkesë. Nga ana tjetër, pajisjet porositen me tenderë. Nëse ne kemi një numër të caktuar pajisjesh në spital, siç kemi tani aktualisht, që pjesa më e madhe kanë ardhur të reja, kemi rreth 30 respiratorë, atëherë unë duhet të porosis ose të bëj një tender që të marr një tjetër që është më i lirë, por që nuk është si këto, me të cilët ne jemi të kënaqur, por ligjet e prokurimit thonë nëse bën kërkesë porosit po të njëjtën pajisje. Për ne ka shumë rëndësi të bëhet unifikimi i pajisjeve në të gjithë spitalin, sepse edhe mirëmbajtja është më e mirë edhe ana profesionale.

Ndërsa në lidhje me infermierët, kam vetëm diçka edhe me mjekët mbase, duhet të ndryshojë pak raporti, kjo duhet bërë me vendim nga ministria mendoj, të ndryshojnë raportet e vjetra mes infermierit dhe të sëmurit, se kanë ngelur raportet që kanë qenë të vjetra. Nuk mundet të jenë ato raporte që kanë qenë dhe të kesh infermier mangët. Njerëzit pretendojnë për shërbimin, kjo eviton edhe ato hyrjet e njerëzve që lëvizin nëpër spitale lart e poshtë, se kur e shohin që i bëhet shërbim nuk kanë nevojë që të hyjnë njerëzit, kur shohin që nuk arrihet t'ju bëhet shërbimi kërkohen të hyjnë vetë dhe prishet sistemi në të gjithë spitalin. Prandaj mendoj se duhet bërë si ligj që të ndryshojnë numri i infermierëve me të sëmurë për shtrat, mbase edhe mjekët për numër pacientësh.

Duhet të ndryshohet numri i marrjes se mjekëve të rinj, sepse ka ngelur ajo që duhet të dalë dikush në pension që të vijë një mjek i ri, duhet menduar për perspektivën një mjek i ri, që të fillojë të drejtojë dhe të punojë i pavarur, i duhet të paktën 4 apo 5 vite eksperiencë, apo mbasi ka mbaruar specializimin që ai të marrë eksperiencën nga më i vjetri dhe pastaj ai të largohet dhe ta zëvendësojë ky që është më i ri, sepse ashtu krijohen gjithmonë boshllëqe.

Faleminderit.

**Albana Vokshi** – Faleminderit shumë profesor!

Nëndrejtoresha a keni diçka për të shtuar?

Po, drejtor, kishit diçka?

**Enkel Joti** – Po, thjesht për të informuar, ne kemi ngritur një grup pune me përfaqësues qoftë shefa shërbimesh, qoftë infermierë apo edhe kryeinfermierë, si dhe nga drejtoria e performancës dhe nëndrejtorët mjekësorë natyrisht edhe burimet njerëzore, për të vlerësuar nevojat që ka aktualisht spitali dhe për të bërë ndryshim që, nëse deri dje ka qenë raporti 4 pacientë dhe 1 infermier, tani të jetë aq sa mendohet se është e nevojshme, kjo referuar edhe një mbledhjeje që ka bërë komiteti i infeksioneve spitalore në QSUT, ku një nga hallkat kryesore është shmangia e të gjithë familjarëve brenda ambienteve të spitalit.

E ka kaluar fazën e parë ky grup pune, tani kemi një grup tjetër, më të reduktuar, për të bërë pastaj prezantimin në ministri, ku paraprakisht ne kemi diskutuar, kemi marrë një aprovim edhe nga ministria lidhur me këtë ndryshim. Siç e thashë, qëllimi kryesor është dhënia e një shërbimi akoma edhe më të mirë ndaj pacientit.

Në kemi një mbledhje të brendshme të komisionit mjekësor dhe spitalor, ku do të diskutohet edhe kategorizimi i infermierëve, se mund të kemi dy kategori infermierësh: infermier kategoria e parë, që manipulon apo një kategori tjetër që ndihmon pacientin për të mbajtur higjienën e tij apo dhe ushqimit, për ata që kanë nevojë. Kemi diskutuar edhe me profesor Gjatën, që është rektor i universitetit, që nëse mund të quhen ndihmës infermier apo infermier të kategorizuar, ku bie kjo pjesa e ndihmës së infermierit. Pra, jemi duke punuar me këtë, jemi në një proces, pjesën më të madhe e kemi kaluar, kështu që jemi në pjesën përfundimtare. Përfitoj edhe nga rasti që përmendi profesoreshë Anila lidhur me barnat, fatmirësisht vinkristina dhe vinplastina që kanë qenë problem, vinplastina është zgjidhur ndërsa vinkristina është duke u zgjidhur. Këto janë barna që nuk kushtojnë shumë, por që krijojnë probleme të mëdha.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

**Arben Gjata** – Është edhe diçka tjetër në lidhje me punësimin e infermierëve, që është zgjidhur nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë”. Ne kemi diskutuar dhe biseduar me Ministrinë e Shëndetësisë që punësimet dhe pikavarazhi i infermierëve që futen të jetë edhe sipas specialiteteve. Pra, ne jemi duke hapur master për kujdes intensiv, ose master për të sëmurët onkologjikë, ose master për infermier familjeje. Këto nuk mund të futen të gjithë në një thes, pra të vlerësohet sipas pikëve, sepse duhet të shkojmë drejt specializimeve dhe, nga ana tjetër, këto që janë me *bachelor* duhet të punësohen si ndihmës infermierë, sepse ndryshon komplet mënyra si funksionon spitali dhe personeli i mesëm në spital.

**Albana Vokshi** - Jam e sigurt që ju si grup pune e dini më mirë si funksionojnë raportet, si të ndihmohet për t'i ardhur më shumë në ndihmë pacientit. Drejtori tha që do të përpiqeni të shmangni familjarët nëpër ambientet spitalore, por kjo duhet të shkojë paralelisht me informimin e familjarëve. Sidomos gjatë pandemisë kemi dëgjuar shumë denoncime nga familjarët, që nuk merrnin asnjë informacion. Pra, vërtet shmanget apo duhet shmangur, këtë e gjykoni ju më mirë, por duhet rritur ende më shumë pjesa e informimit të çdo familjari, sepse është e drejtë e tyre kushtetuese jo vetëm njerëzore dhe humane, sepse të gjithë e dimë kur kemi një familjar të sëmurë sa e rëndësishme është pjesa e informacionit. E kuptojmë edhe stresin që ju keni, pro kishte familjarë gjatë asaj periudhë që nuk merrnin asnjë informacion.

**Enkel Joti** – Doja të falënderoja punën e mjekëve, që kanë qenë pjesë e trajtimit të sëmundjes COVID. Pra, ata kanë qenë në një presion të jashtëzakonshëm, përveç presionit të vetë të sëmurit, por edhe të familjarëve. Ne kemi një rregullore, të cilën e kemi përmirësuar gjatë rrugës, sepse u bë gati 1 vit e gjysmë në luftën ndaj këtij virusi, kemi marrë edhe rregulloret nga spitalet, ku ne kërkojmë të marrim më të mirat e tyre. Çdo ditë familjarët telefonohen nga mjeku kurues, por shpeshherë ka pasur nevojë që të informohen disa familjarë dhe të jemi të sigurtë mjekët nuk e kanë mundësinë që t'u përgjigjen të gjithë familjarëve ose të marrin familjarët me radhë dhe kjo ka ndodhur se në disa raste ka pasur ankesa, për të cilat ne kemi komunikuar me mjekët, natyrisht pa u ushtruar presion atyre, sepse të gjithë mjekët regjistrojnë telefonatat e tyre, kanë një orar të përcaktuar mbasi mbarojnë vizitat për të njoftuar një herë në ditë.

Kjo është një realitet që ndodh, thjesht për informacion.

**Albana Vokshi** – Faleminderit.

Unë thashë, ishte dhe situata e COVID, por ka pasur çdo ditë familjarë që ankoreshin për mungesën e informacionit, por mbase ju e dini më mirë, ju do të dilni në një konkluzion si duhet të jetë raporti apo rritja e stafit për informimin. Na thoni se çfarë mund të ndihmojmë ne në këtë drejtim, sepse ne do jemi në krahun tuaj, mjafton që të respektohen dhe të drejtat e tyre për informim, të gjithë e dimë se sa në stres jemi dhe ne, por ju stresojmë dhe juve, si mjekë, që duhet të jeni në detyrë pranë pacientëve gjithmonë.

**Ilir Ohri** – Mund të them vetëm diçka, siç thatë ju mund të na ndihmoni në lidhje me këtë punën e familjarëve dhe ankesave, vetëm një gjë, mos i merrni shumë për bazë ato që flasin apo ankohen, sepse mjekët nuk mund të jenë në dispozicion të familjarit, duke ndenjmur në telefon dhe

te dera kur do familjari, ka një orar, që mund të marrësh informacionin që do, mjekët nuk mund të përgjigjen në çdo moment që duan familjarët përgjigje, siç e thashë, ka një orar për këtë punë.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Nëndrejtoresha kishit diçka për të shtuar, do t'ju marrim dhe pak kohë nga koha juaj, sepse jam e sigurt që do ketë edhe pyetje nga kolegët.

**Ariana Strakosha** – Faleminderit!

Doja të shtoja diçka për pjesën e infermierëve apo të numrit të infermierëve për shtrat, por ndërhyri drejtori dhe e sqaroi që është ngritur grup pune. COVID-i na vendosi ndoshta përballë vështirësive, sepse ishte një sëmundje që donte një dedikim më të fortë nga personeli i mesëm, jo vetëm nga personeli i lartë.

Për sa i përket urgjencës që ngriti profesor Eqeremi, është e drejtë, ka një fluks të madh, sidomos situata e COVID-it ishte një mbingarkesë shumë e madhe për ne, për vetë faktin që Sanatoriumi, ju e dini u bë spital COVID, dhe të gjithë të sëmurët që shkonin dikur tek sanatoriumi vinin tek ne dhe për shumë arsye të tjera post COVID.

Në spitalin e ri që do të bëhet, thjesht për t'ju sqaruar, urgjenca do të jetë një urgjencë më moderne, do të jetë gjithëpërfshirëse me multi-ekipe, si dhe me numër më të madh shtretërisht dhe mendojmë që do të evitohet pikërisht ky lloj ngërçi i mbingarkesës së urgjencës, do jetë me multi-ekipe siç thashë, me reanimatorë, me kirurg, me urgjentistë, që në mënyrë paralele t'u jepet ndihma pacientëve.

Nga ana tjetër, doktorësh Silva tha dhe për telemedicinën, kjo është një gjë që është e ardhmja e mjekësisë sot, komunikimi në distancë, pra ti shfrytëzon burimet njerëzore me një pikë të caktuar dhe mund të japësh ndihmën dhe në distancë. Ne e kemi aplikuar në kohën e COVID-it me sukses me mjekët e rretheve, sepse ne jemi më shumë se sa mjekët e rretheve dhe kanë nevojë për një mendim tjetër dhe ka rezultuar pozitive. Kështu që mendoj që kjo praktikë duhet të hyjë dhe në strategjitë e të ardhmes, të shtrihen mjetet e telemedicinës që pacienti vërtet mund ta bëjë skanerin në një spital rajonal bashkiak, por konsulta mund të bëhet online shumë mirë dhe jepet ndihma në kohën e duhur.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Pyetje ka?

Oriola, pastaj zoti Vasili.



**Oriola Pampuri** – Ju përshëndes me shumë respekt! Unë nuk kam pyetje, thjesht doja në njëfarë mënyre të mbështesja atë që referuan profesor Gjata dhe të gjithë profesorët e tjerë të nderuar që janë këtu, në fakt doja të mbështesja atë që tha profesor Eqremi. Secili nga ne ka pasur problematika të vetat dhe personale dhe është përballur me të gjitha vështirësitë që përballen sot mjekët apo profesorët, shefat e shërbimeve, që janë sidomos në QSUT dhe na janë gjendur pranë, ashtu sikurse u gjenden pranë me gjithë mundësitë e tyre të gjithë qytetarëve që shkojnë dhe referohen në QSUT.

Atë që ne kemi denoncuar, si përfaqësues të politikës, ka qenë për t'ju mbështetur juve. Unë jam e bindur që të gjithë ju doni kushte më të mira, ju jeni me sinqeritet më të mirët, jeni shefa shërbimesh, profesor, si dhe jeni dhe në auditor për të mësuar brezat e ardhshëm, kështu që ajo që juve sot ju nevojitet janë kushtet më të mira për të pasur një performancë të shkëlqyer. Kemi dëgjuar shpesh dhe nuk na ka ardhur mirë fare që ka pasur përplasje mes familjarëve dhe mjekëve dhe kjo nuk është normale, ajo çka e sjellë këtë anormalitet është pikërisht mungesa e kushteve të cilat kanë qenë pranë spitaleve, pranë qendrave të shërbimit spitalorë dhe këtë kemi dashur të bëjmë dhe do ta bëjmë deri në fund deri sa mjekëve t'ju kthehet dinjiteti që kanë në të gjithë botën, dinjiteti që juve meritoni. Ju jeni ato që duhet të ngrini zërin pa pasur asnjë lloj kompleksiteti përball askujt, nga Kryeministri e të gjithë me radhë, jeni elita e shoqërisë, jeni ata nga të cilët varet shëndeti jonë, jeni ata nga të cilët varet shëndeti i qytetarëve.

Jam dakord me ndërtimin e një spitali rajonal, QSUT-ja është e mbingarkuar, e kemi kërkuar dhe e kemi ngritur si problematikë këtu sa herë që Ministria ka qenë dhe sigurisht e kanë ngritur si problematikë dhe mjekë të tjerë të QSUT sepse duke ndërtuar një spital rajonal për Tiranën sigurisht do t'i jepnim frymëmarrje QSUT.

Kisha diçka dhe për drejtoreshën e Spitalit të Traumës, është e re tashmë, është një spital ashtu sikurse e gjithë QSUT ka mjekë shumë të mirë, ka mjekë, të cilët ofrojnë shërbim, por duan kushte, i kam parë vetë, kam qenë një muaj rresht në atë spital çdo ditë dhe kam parë që mjekët shërbenin jashtëzakonisht shumë mirë, ishin aty non stop duke dhënë maksimumin e tyre por kushtet, e them këtë për drejtorin, kishte një zë në buxhet për buxhetin e 2022 për rikonstruksionin e disa prej godinave të spitaleve, por do të doja dhe do ta kërkoj deri në fund që të ishte prioritet Spitali i Traumës, sepse vërtet gjendja brenda ndonjëherë të bënte përshtypje aq sa ishte traumatike, sepse mungonin gjërat nga më minimalet, kushtet minimale.

Unë ju falënderoj dhe sinqerisht përulëm përpara punës tuaj dhe ndjehem mirë që ju sot ngritët disa çështje e disa probleme dhe ju inkurajoj, se po nuk folët ju kush do të flasë ? Gjithçka që ju keni ta thoni, sepse jeni mbi këdo.

Ju faleminderit.

**Albana Vokshi** – Faleminderit, Oriola!

Zoti Vasili.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ja vetëm të mbledhim disa pyetje dhe do t'ju a kaloj që të marrim më pak kohë.

**Petrit Vasili** – Faleminderit, unë mendoj që të qëndrojmë në 3 ose 4 çështje që përbënin edhe problematikat që u ngritën këtu, se besoj edhe interesi, në radhë të parë, është të shkëmbejmë ndonjë mendim si i zgjidhin këto çështje.

Një problem që është një sëmundje e vjetër administrative e QSUT-së dhe jo vetëm e QSU, me thënë të drejtën është problemi i tërë administrimit të barnave në Shqipëri, është boshllëqet që krijohen nga pamundësia për të prokuruar në kohë, jo sot por në mënyrë të vazhdueshme është kërkuar me insistim qeverisë që të zbatojë një regjim tenderimi të ndryshëm për mjekësinë për specifikën që mjekësia ka, që ndryshon nga një rrugë, që ndryshon nga një rikonstruksion shkolle apo që dhe vetë shëndetësia mund të ketë dy regjime, një regjim për barnat dhe një regjim për rikonstruksionet që ajo bën. Modeli ka qenë i thjeshtë, koha e prokurimit apo e tenderimit zgjatej dhe të ishte minimalisht 2 vite me detyrimin që 6- mujorin e fundit të kohës së mbarimit të këtij 2-vjeçari të fillonte tenderimi dhe negociimi dhe mbyllja e çdo kontrate në kohë për të arritur që të mos ketë kurrë boshllëk në hapësirën e sigurimit të barnave.

Cili ka qenë avantazhi ?

Avantazhi ka qenë që prokurimet për një afat më të gjatë kanë hapësira për të negociuar dhe një çmim më të mirë por dhe boshllëku që krijohet që është i paevitueshëm, nuk është askush fajtor në këtë mes, procedurat e krijojnë këtë gjë, pra edhe kjo evitohej sepse kishte një kohë të bollshme që negociohej dhe spitalet ato barna të domosdoshme që prokurojnë ti kishin aty.

E them që duhet rimarrë kjo me insistim, aq më tepër që nuk kemi pasur ndonjë problem të madh dhe qeveria mund të bëhet kaq puritane sepse ligjin e prokurimit e ka prekur shumë herë dhe brenda administrimit shtetëror ekzistojnë pa fund kontrata, kontrata shumëvjeçare, kështu që kjo tabu e mosprekjes së ligjit të prokurimit ka rënë dhe ky propozim shumë konkret është aty, mund ta marrin, nëse e sjellin unë personalisht do të ngre duart lart në mënyrë që kjo gjë që është

një sëmundje e përsëritur e 20 apo 25 viteve dhe që është një problem shumë i madh dhe që i vendos edhe administratorët e spitaleve përballë një vështirësie artificiale se nuk janë fajtorë, procedurat dhe ankimmimet kanë rregullat e tyre, por kjo e ka rrugëzgjdhjen dhe nuk kemi pse humbim kohë më shumë.

Së dyti, problemi që ngre profesor Ohri është një problem shumë i vërtetë dhe kardinal, aq më tepër COVID-i nuk është thjesht dhe vetëm COVID si patologji, por mënyra se si e tronditi sistemin mjekësorë bëri që të dalin në dritë dy gjëra të madhe: mjekësia është një e mirë publike, që nuk mbahet dot më me arna, flas në mënyrë të veçantë për shërbimin, sepse edhe COVID-i vetë pati momentin e diferencës shërbimin, se jo gjithmonë shkenca që në gjendje të ofronte gjërat më të sakta që mund të ofronte, sepse u kap e papërgatitur, por shërbimi bënte diferencën. Tani zgjidhja për këtë gjë, është zgjidhje e qartë dhe e thjeshtë, në mënyrë të veçantë një shërbim të kualifikuar, si QSUT-ja, kërkon miratimin e normave të reja të mbulimit me infermierë dhe me mjekë që i takojnë këtij niveli unikal, që QSUT-ja përfaqëson në të tërë republikën. Miratimi i këtyre normave do të kërkoj, çfarë do të kërkoj, shumë thjesht, në rast se janë 1500 infermierë, do të kërkoj të jenë 2100. A ka ndonjë tabu? Nuk ka tabu.

Këtu janë punësuar me mijëra njerëz në pushtetin lokal, nëpër polici e të gjitha. Në qoftë se do të shtoheshin 500 apo 1000 në QSUT, nuk do të ishte asgjë, veçse do të ndodhte që do të viheshin në parametra të një lloji normaliteti (gjithmonë do të jetë e mbingarkuar QSUT-ja, në kuptim të ngarkesës), por do të krijonte një normalitet të pranueshëm dhe do të ishin më të qetë edhe mjekët, edhe infermierët. Pra, është plotësisht e kapërcyeshme, në rast se ka vullnet të mirë.

Miratohet një normë e re, normë e pranueshme. Është e qartë, nuk do të jetë as kjo aktualja, as idealja, por do të jetë një normë realiste, e cila mund të realizohet praktikisht pa asnjë vështirësi dhe efekti financiar nuk është asgjë në raport me çfarë kemi diskutuar në këtu për efektin financiar. Pra, edhe kjo është një çështje e kapërcyeshme.

Një problem tjetër, që ka të bëjë me mbingarkesën e QSUT-së, është se duhet të biem dakord që të gjithë se QSUT-ja nuk mund të bëhet dhe as mund të pretendojë të bëhet si shërbyesi, si spitali i vetëm i Republikës. E tillë, QSUT-ja ka humbur dhe e humbet sfidën, jo QSUT-ja, por kjo vihet në një situatë më anormale që mund të ekzistojë, se nuk e bën dot kurrë, sepse në të kundërt të një qendre terciare detyrohet shumë herë të kthehet në më pak se sa në një qendër sekondare. Dhe kolegët e vuajnë në mënyrë të përditshme. Ka vetëm një shpëtim, një sistem efikas dhe rigoroz referimi, asgjë të veçantë, atë që bën e gjithë bota e qytetëruar. Flas edhe ku standardet

e mjekësisë janë më të lartat, ky vepron me rreptësi. Ne jemi mjekësi e varfër, e nënfinancuar, dhe ky nënfinancim do të na shoqërojë edhe për një kohë të gjatë, sepse lidhet me ekonominë e madhe kombëtare, që nuk është ajo që do të donim, por një vend që vjen nga një diktaturë, sigurisht vuan për një kohë të gjatë... Atëherë, çfarë bën? Disiplina brenda sistemit, racionalizimi i energjive brenda sistemit, e shpëton sistemin, e ruan terciarin që të bëjë ato punë që ka për të bërë, vë sekondarin në punë që as të mos bëhet apatik, as të mos dembeloset, as të humbasë aftësitë dhe, njëkohësisht, qytetarit i vjen gjithmonë më afër, më në ndihmë, më afër banesës së vet.

Asgjë të keqe nuk ka dhe është provuar, pra kemi eksperiencë që e kemi provuar se një sistem referimi, i zbatuar jo thjesht si detyrim administrativ, por si një detyrim mjekësor, sigurisht, heq kushedi sa e sa punë të panevojshme.

Tabuja që qytetari mund të niset kur të dojë nga një pikë, vjen në Tiranë dhe bën çfarë do, nuk ekziston në asnjë vend të botës. Kjo është e mbyllur. Po, shkon ku të dojë, në një spital privat. Është zgjedhje e tij, mund të shkojë ku të dojë.

Brenda shërbimit kombëtar, sipas problemit, sipas gravitetit të problemit që ka, merr ndihmën atje ku e ka dhe përcillet dora-dorës sipas nevojës që ka për një ndihmë më të kualifikuar.

Në rast se nuk kthehet te ky sistem referimi, QSUT-ja do të jetë e paqetë. Patjetër, kjo do të inondohet nga familjarët, se në qoftë se pranon dhe vijnë dyfishi, trefishi i njerëzve (ne një vend mesdhetar jemi, pacienti gjithmonë shoqërohet nga familjarë), por në momentin që ulet kjo ngarkesë, edhe raporti me familjarët ndërtohet në mënyrë më të qetë.

Mënyra rregullimi ka plot, por edhe kohë pas kohe ka pasur mënyra se si të rregullohet, por sa më i qetë të jetë spitali, aq më të qetë janë edhe familjarët dhe besojnë më shumë te një strukturë, e cila funksionon normalisht, por po panë inondim të pavijoneve, inondim të reanimacioneve, inondim të urgjencave, domosdo krijohet një panik, ku krijohet ideja “Nuk po më zënë me dorë” e ku di unë se çfarë. Krijohen njëmijë subjektivizma, të cilat pastaj janë të padisiplinueshme, sepse hyn edhe ana emocionale. Ky është, them, mekanizmi sistematik që e shpëton.

Së katërti, me shumë të drejtë doktorëshë Çeliku ngre çështjen e sigurimeve shëndetësore. Pa diskutim, është çështja thelb e sistemit, i cili sot e kësaj dite është një sistem miks, por një sistem që, siç e dimë, është turbulluar nga idetë e mjekësisë falas, e mjekësisë universale, të cilat jo vetëm nuk u zbatuan, por krijuan edhe hutim, edhe shpërqendrim, edhe heqjen dorë të një strategjie të mirëpërcaktuar që shëndetësia shqiptare mund të bëjë përpara, duke rritur gjithmonë

e më shumë nivelin e sigurimeve shëndetësore dhe duke mos humbur përkrahjen e shtetit. Vetëm kështu do të ketë më shumë para në dispozicion dhe do të qeveriset më mirë, sepse gjithmonë kriza e vazhdueshme e sistemit është nevoja për të pasur kontribute, por edhe bashkëpërgjegjësi të qytetarëve për këtë.

Çfarë do të bënin sigurimet shëndetësore? Asgjë më shumë, asgjë më pak se ajo që bëjnë 90 e ca për qind e Europës.

Sistemi i shëndetësisë universale ka qenë një eksperiment, ku edhe një vend shembullor si Anglia, pas shumë vitesh, pranoi që ishte një sistem i cili duhej ndryshuar. Tani, ne nuk kemi pse ta tronditim edhe më, por t'i kthehemi kësaj gjëje, të shikojmë seriozisht. Po, patjetër, të rriten kontributet nga qytetarët dhe po në këtë mënyrë të rritet edhe niveli i ndihmës që u jepet atyre. Por as këtej, as andej, sistemin e kemi miksi, po njëherazi flasim edhe për një sistem falas dhe universal, kjo krijon hutim të njerëzimit, krijon ndonjëherë edhe pretendime artificiale të kota, e me to përballen mjekët dhe drejtuesit e spitaleve. Përballen në mënyrë të padrejtë, sepse është sistemi që krijon amulli.

Kështu që këtu duhet qartësi, dhe modeli që kemi është shumë i mirë, miksi, ai që është edhe në fuqi praktikisht, pavarësisht fjalëve, se të tjerat janë fjalë. Por ai që është në fuqi, miksi është, i cili ka qenë një konkluzion, ta dinë të gjithë, shumë nga kolegët kanë qenë pjesëmarrës, ka qenë një vendim që kërkohej 10 vjet për t'u marrë dhe që nuk pati fare lidhje me maxhorancat, sepse si një problem që kaloi nga një maxhorancë tek tjetra dhe së bashku me një ekspertizë tejet të kualifikuar ndërkombëtare teknike u arrit në konkluzionin që ky ishte modeli që i shkonte këtij vendi.

Konsekuenca për të qëndruar te ky modeli krijon qetësi edhe për ata që punojnë në sistem, edhe për të gjithë opinionin publik, pra njerëzimit, qytetarët, familjarët e dinë shumë mirë se cili është raporti, se ku e kanë vendin në raport me sistemin.

E fundit, për të mos marrë më kohë, lexova në materialin e Universitetit të Mjekësisë, në goftë se referimi është i saktë, që dy ndërtesa janë ende të dëmtuara dhe të pandrequra. Tani, ju them sinqerisht, në momentin e parë të mos ta dija që e shkruante Ben Gjata, do të thosha që është ndonjë pa eksperiencë që e ka futur kot, se tani flitet për gjithë këtë program të madh rindërtimi dhe të mos ndërtohen ndërtesat e Fakultetit të Mjekësisë, po ne...

Në rast se kjo nuk është një sirenë alarmi, po kalojmë... nuk është problemi vetë Covid-i, ai virusi i famshëm, por Covid-i transformohet në të gjithë këndvështrimin e botës për

shëndetësinë. Panë që kjo e mirë publike duhet parë ndryshe, ideja që flitet për shumë politikë dhe, siç i keni parë programet e qeverisë, në fund fare thuhet me dy fjali: “Shëndetësia, arsimi” dhe kalojnë përtej. Panë që kjo është një e mirë publike që mund ta tronditë botën nga themelet.

Por tani nga kalon? Kalon nga ato rrugë që janë, nga profesionistët, dhe profesionistët nga Universiteti Mjekësor kalojnë. Ku do të mësojnë? Ku do të shërbejnë? Me të drejtë tha profesor Ohri, duhen gjeneratat, por këto duhet të mësojnë përpara që të vijnë të zëvendësojnë.

Tani, të mos jenë godinat e Fakultetit të Mjekësisë, sinqerisht jua them, m’u duk... Por duke e njohur Benin, thashë, e di që është rigoroz në ato që shkruan, se kjo m’u duk e pabesueshme. Sepse ato ambiente, siç e dimë të gjithë, edhe ashtu janë të mangëta dhe do të donin gjerësi më të madhe për të ushtruar pjesën pedagogjike të problemit, se QSUT-ja është goxha e inonduar me shërbime, bën njëmijë punë dhe hapësirat janë. Po në mungesë të këtyre hapësirave, çfarë ndodh? E dinë të gjithë që të motivohet, kualiteti i atyre që formohen bie, mërzhiten pedagogët me të drejtë, mërzhiten edhe studentët me të drejtë. Si mund të pranohet kjo? I thonë gati... Ia dhamë, në nëntor jemi tani, i bie 2 vjet.

Tani, e njëjta histori: godinat e mjekësisë nuk bëhen; Spitali i Kurbinut, që është premtuar të bëhej që në qershorin e vitit që shkoi, nuk u bë. Si ka mundësi të ndodhë kjo gjë, aq më tepër, e thashë edhe një herë, kur të gjithë kanë nevojë dhe në programin e rindërtimit për t’u pajisur sa më parë qytetarët? Pandemia vazhdon.

Në radhë të parë, çdo strukturë shëndetësore, çdo strukturë formuese dhe çdo gjë tjetër, çdo gjë që lidhet me shëndetësinë do të duhej të ishte e para. Tani, kryefjalë e botës është bërë shëndetësia. Këto janë probleme që, për ta mbyllur, kanë mundësi edhe ekonomike, edhe organizative për t’i zgjidhur, por radha e prioriteteve duhet të jetë atje ku është. Besoj që moment më të mirë (sado “më të mirë” është fjalë e papërshtatshme, se është e hidhur, që ka lidhje me pandeminë) se sa tronditja që pandemia solli, nuk ka. Kështu që mendoj se këto katër-pesë momente ne mund t’ia adresojmë qeverisë për t’i parë, sepse nuk kanë të bëjnë me kostot, ato janë shumë të përmbajtshme, dhe nuk ka pse të mos reflektojmë me një shpejtësi shumë të madhe, sepse, e thashë, duam, nuk duam, sot, krahas punës së zakonshme shumë të mbingarkuar që ka, meqë QSUT-ja është çështje e bisedës sot, po bashkëjeton sot edhe me një realitet tjetër shumë të vështirë atipik, siç është Covid-i, që është një anormalitet, në kuptimin normalitet mjekësor se jep vendime mjekësore, por anormalitet, pasi nuk e ka pasur këtë problematikë që kërkon edhe fuqi, edhe energji, edhe para, edhe barna dhe gjithçka. Madje ka edhe tension të madh publik.

Kështu, them se këto katër-pesë momente mund të adresohen, pse jo, të marrin edhe përgjigje të shpejtë. Nuk ka moment më të mirë për ta bërë këtë.

Faleminderit dhe faleminderit të gjithë kolegëve për gjithë çfarë referuan dhe me shumë efektivitet dhe profesionalizëm që e bënë këtë!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, zoti Vasili!

Zonja Spahiu.

*(Prof. Arben Gjata kërkon fjalën pa mikrofon.)*

Po.

**Arben Gjata** – ...problemi i atyre dy godinave, në fakt, është faj i administratës sonë. Ka një vit e gjysmë administrata, i kemi të ndara tani administratorin, rektorin e të tjerë, pra ende nuk janë mbyllur përfundimisht se sa i shkojnë kostot, sepse raporti është: duhen prishur apo duhen mbajtur ato godina, apo duhen rikonstruktuar. Na dilte që kostot e rikonstruktimit janë më të larta se sa ta prishësh dhe ta ndërtosh nga e para. Mirëpo këto të gjitha janë problematika ligjore që njerëzve u ndodhin dhe nuk dinë çfarë të bëjnë. Sepse thotë: “Po e prisha, më vijnë nesër dhe më thonë “si ke prishur një godinë që mund ta mbaje”, po e ndërtove është si puna e atij “i dhe ujë të ftohtë apo ujë të ngrohtë gomarit”. Kjo është historia nganjëherë, por varet edhe nga aftësia që ka pjesa administrative.

Pra, ne jemi në përfundim për ta çuar për aplikim te Ministria e Rindërtimit. Prej 2 vjetësh këto janë të gjitha procedurat brenda universitetit, të cilat janë komplet për shkak të atyre kapaciteteve që ka Universiteti i Mjekësisë nga ana administrative. Është kërkesë jona e vazhdueshme.

Unë e kam thirrur disa herë administratorin përkatës, drejtoritë që kemi ngelur, por është një problem shumë i rëndësishëm faktikisht.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** – Po, Klodi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Petrit Vasili** – Të më falni!

Profesor Gjata e ngriti me të drejtë. Tani, ne asistojmë. Në kuadrin e rindërtimit e kemi parë që shemben pallate të tëra, bëjnë edhe luftë me qytetarët, nuk pyesin fare, i shembin dhe ndërtojnë të tjera. Ndërkohë që godina e Fakultetit të Mjekësisë... Po ju specialistët i keni, merrni

vendimin: ose do ta mbajmë, ose do ta prishim; kaq na kushton po ta rindërtojmë, kaq na e bën nga e reja. Se është provuar që merren vendime.

Në televizion i keni lagje të tëra tani. Nuk mund të rrijë procesi i formimit në mjekësi me vite të tëra, të rrimë si ata dy binjakët: ose do të dalësh ti, ose do të dalë ai dhe mbeten aty. Tani, kjo punë është që merret një vendim dhe shkon përpara. Të rrijë edhe 30 vjet të tjerë? Brezat presin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më falni për ndërprerjen dhe faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Fjalën e kanë zonjat Spahiu dhe Dhori.

**Klodiana Spahiu** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit të gjithë profesorëve dhe profesororeshave që janë këtu sot!

Në respekt të kohës suaj shumë të çmuar, për të mos ju përfshirë në disa debate, që ndoshta as i takojnë punës suaj, unë do të ngre disa probleme, të cilat, në fakt, i kemi të mbartura edhe nga seancat që ne kemi zhvilluar me ju edhe më parë.

Problemi i parë që dua të ngre është ai i zgjidhjes së paketës së aksidenteve vaskulare cerebrale. Profesor Goda e përmendi që është një numër shumë i lartë i infarkteve akute që trajtohen. Aksidentet vaskulare cerebrale kanë një peshë shumë të rëndësishme dhe aktualisht bëhet tromboliza. Ne e kemi diskutuar më parë edhe me drejtuesit e institucioneve, të cilët na kanë thënë që po punohet për një paketë. Nuk e dimë në ç’stad është dhe çfarë po bëhet më tutje.

Problemi i dytë, që ndoshta i takon edhe buxhetit dhe duhet ta ndaj me ju, është ai i protezimit, këtë e kam për doktoreshë Edlirën; problem i ngritur vazhdimisht. E dimë se ekziston një procedurë e caktuar për protezimin. Uroj dhe shpresoj të kemi një reflektim më të shpejtë në lidhje me kërkesat që janë për protezim. Besoj që do të ketë edhe aty një lloj kategorizimi, se, vërtet mund të jetë një listë, por duhet të ketë edhe një listë prioritare për rastet që janë më emergjente.

Bie shumë dakord dhe jam përpjekur, në fakt, por nuk kam gjetur një zgjidhje përfundimtare në lidhje me prokurimin, siç u diskutua. Meqenëse zoti Vasili bëri një propozim konkret, unë jam, por besoj se të gjithë jemi dakord që, nëse ka diçka konkrete, duke e diskutuar edhe me ekspertët e Komisionit të Ekonomisë dhe atij të Ligjeve, ne të procedojmë dhe ta çojmë në parlament nismën tonë për amendimin e ligjit, në mënyrë që të tregohemi jo vetëm



bashkëpunues, por edhe për zgjidhjen e një sërë problemesh që kemi hasur në lidhje me ankesat që bëjnë qytetarët.

Problemi i tretë lidhet, në fakt, me ankesat që vijnë nga të sëmurët kronikë. Dhe meqenëse ne e kemi pasur një dëgjësë me drejtoreshën e Fondit të Kujdesit Shëndetësor dhe sot kemi fatin e madh që ju jeni prezent dhe protokollat bëhen nga ju, pastaj këto protokolle kalojnë në Fond për kostifikim dhe për miratim, do të doja që për rastet e sëmundjeve kronike, prognoza e të cilave nuk është e mirë, pra që dihet se është një prognozë jo e favorshme për pacientët, të kemi mundësi që të mos jenë për përsëritje çdo 3 muaj ose çdo 6 muaj, duke ditur që është edhe situatë e vështirë ajo e Covid-it. Këtë e kam më shumë për fushën e onkologjisë, sepse aty është hasur pak më shpesh në lidhje me ekzaminimet që kërkohen. Vërtet koha e pritjes është ulur shumë, krahasuar me më parë, por do të thosha që nëse ka një mundësi ku ju e shikoni si profesorë, në bazë të protokolleve, që mund të zgjatet pak koha, do t'ju lutesha që këtë ta realizojmë.

Pas jush kemi një seancë, që vërtet është seancë e vështirë, sepse është me grupet e interesit, ku janë pikërisht pacientët që vijnë me ankesat e tyre të paraqitura në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Prandaj do të thosha që është një nga komisionet më të vështira, pa dyshim edhe kërkesa këtu është shumë e lartë, sepse nuk është vetëm buxheti për shëndetësinë, por është edhe për çështjet sociale. Tashmë është shtuar edhe buxheti për rindërtimin.

Kështu që do të kërkoja me shumë dashamirësi që aty ku ekziston mundësia, për shembull, talasemikët në mënyrë të përsëritur e kërkojnë atë medikamentin për dhembjet, nëse është e mundur gjithnjë që të rimburohet, se do të vijnë prapë sot ta kërkojnë.

Është një grup pacientësh që përfundojnë në kolostomë, kjo është për pjesën e kirurgjisë. Duhet të jetë një numër shumë modest rastesh dhe ne nuk e dimë sa është...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Arben Gjata** – Këtë të kolostomisë ne ia kemi propozuar prej disa vjetësh Ministrisë së Shëndetësisë. Është me gjithë mend turp që ata pacientë... Sepse abuzohet edhe me çmimet. Pra, në qoftë se në QSUT mund të shkojë 500 lekë të vjetër një qese kolostomie dhe po të merret, të jetë e rimbursueshme, rrezik me ato çmime do të jetë, ai ta shet 3000 lekë deri në 4000 lekë një qese kolostomie. Një me kolostomi, me kancer të kolonit, i bie që hall më të madh të ketë sasinë e parave që shpenzon. Ajo është domosdoshmëri, ndaj duhet futur në sistemin e rimbursimit.

**Klodiana Spahiu** – Në fakt, Profesor, këto janë kërkesa të përsëritura dhe besoj që kjo e fundit është një shifër modeste, pasi nuk besoj që është një numër aq i lartë dhe kostoja është

shumë e vogël. Shpresoj që ne ta realizojmë, por ndoshta duhet një protokoll ose kërkesë nga Shërbimi në drejtim të Fondit.

Në qoftë se është bërë, atëherë do të insistojmë ne që ta çojmë përpara.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe një gjë të fundit, më falni shumë për kohën, por gjithmonë nisem nga ajo që do të vijë pas seancës me ju, do të vijmë dhe do të na kërkojnë llogari, për pjesën pediatrike. Në qoftë se ne do të mundohemi ta rregullojmë sa më shpejt pjesën e amendimit që kërkon ligji i prokurimeve, do të përpiqemi, por do të na duhet patjetër edhe një konsultë tjetër me ju, në mënyrë që të mos hasim raste shumë të vështira nganjëherë, siç mund të jenë blerje të vogla të drejtpërdrejta, por që zgjidhin probleme madhore.

Nuk kam asnjë replikë me kolegët, vetëm do të doja, nisur edhe nga historia që kemi kaluar me pjesën e tërmetit, e njëjta histori ndodh rëndom edhe me objekte jo vetëm të Universitetit të Mjekësisë, që padyshim duhet të kishin pasur një prioritet në bazë edhe të ankesës që bën universiteti. Por procedura realisht është e vështirë dhe e gjatë, sepse për të marrë një vendim nëse një objekt duhet prishur apo rikonstruktuar është një vendim tepër i vështirë që nuk bëhet me një të rënë të lapsit.

Faleminderit për kohën dhe të gjithë kontributin që keni dhënë!

**Albana Vokshi** – Po, Ilda. Besoj se nuk ka pyetje të tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ta mbarojë edhe Ilda fjalën dhe pastaj do jua kalojë fjalën.

**Ilda Dhori** – Përshëndetje të gjithëve!

Kam një ndërhyrje shumë të vogël.

Dua të falenderoj të gjithë kolegët për prezencën, profesorët e mi, për të cilët gëzoj respekt maksimal, por edhe për punën e tyre dhe gjithë sakrificën e bërë në këta muaj të vështirë të pandemisë. E kam parasysh me çfarë jeni përballur pasi kam shumë pak muaj që jam shkëputur nga profesioni.

Për sa u përket ambienteve, ato janë një problem në QSUT për shkak të mbingarkesës së shërbimeve që merren aty. Në fakt, mungesa e ambienteve privon mjekun në punën e tij dinjitoze dhe nga dinjiteti në punë.

Siç e përmendi edhe Oriola, shpeshherë në këto ambiente ka pasur edhe konflikte fizike, gjë që nuk është aspak normale dhe e hijshme, por jo për faj të mjekëve dhe profesionalizmit të tyre.

Kam një pyetje për profesor Gjatën. Sot Universiteti i Mjekësisë i ka të plotësuar nevojat e tij për kabinete laboratorike? Ju thatë që keni mungesa në mjekë dhe nevojë për të shtuar numrin e studentëve të rinj në mjekësi. Jeni plotësuar? Ka qenë kabineti i histologjisë, i histopatologjisë, i anatomisë, por nuk e di nëse ka pasur avancime që nga koha kur unë e kam lënë. A keni ndonjë projekt për të zgjeruar këto ambiente?

Në kuadër të ambienteve, meqenëse është nëndrejtoresha, profesoreshë Strakosha, keni një spostim të dy reparteve; të reumatologjisë dhe të alergologjisë.

Unë jam reumatologe në Lushnjë dhe disa muaj më parë, gjatë periudhës së covid-it, kam pasur raste realisht të rënda. Ndoshta nuk janë shumë, por kanë qenë pacientë, sidomos lupusi me pancitopeni, që kërkonin një trajtim multidisiplinor dhe ishte patjetër e nevojshme transferimi në QSUT, sepse vetëm aty mund të merrej ky shërbim. Me shumë përpjekje, bashkë me profesor Argjendin, arritëm të gjenim një dhomë në shërbimin e sëmundjeve të brendshme ku është trajtuar rasti. Tani di që kanë kaluar te Spitali Francez. Nuk e di nëse ambientet që kanë janë në përputhje me nevojat që kanë këto shërbime. Duke qenë se janë shërbime terciare, të gjitha rastet e rënda janë të grumbulluara në QSUT.

Alergologjia, gjithashtu, ka raste akute, të cilat...

Nuk e di nëse keni ndonjë plan për t'u shtrirë në ambiente të reja.

Për sa u përket burimeve njerëzore, të gjithë thatë që ka nevoja për infermierë. Në fakt, infermierët janë shumë të nevojshëm, por mendoj që edhe mjekët janë shumë të nevojshëm dhe duhet të rinovohen, siç e tha edhe profesor Ohri.

Ju jeni profesorët tanë dhe ju duhet të piketoni se kush janë specialistët më të mirë që vijnë në ato shërbime. Mendoj që mënyra e selektimit të studentëve realisht më të mirët në rezultate dhe që meritojnë të specializohen në ato fusha është një nga mënyrat më të drejta që është bërë vitet e fundit.

Për sa i përket pjesë së burimeve njerëzore, mendoj që cedon ose ka nevojë që specialistët e ardhshëm, që patjetër do të kalojnë nga dora juaj dhe jeni ju ata që do t'i selektoni, të ripërtërihen, të formohen, të trajnohen apo të mbahen afër jo vetëm në QSUT por fare mirë edhe në spitalet rajonale. Tashmë ne kemi një spital rajonal, që është Spitali Memorial i Fierit, i cili do të vihet

gradualisht në lëvizje, sepse akoma nuk është i plotësuar si spital terciar në të gjitha shërbimet e tij dhe ka nevojë për specialistë, të cilët mund t'i trajtoni ju. Gjithashtu, duhet të hapen kuota të specializuara për këta specialistë të qendrës terciare, që pacienti të shkojë në spitalin terciar të Fierit. Hemodinamika e Fierit është një shembull, pacientët e kanë besimin, shkojnë atje, marrin shërbimin, sepse e dinë që janë vërtetë specialistë të kualifikuar. Pacienti vjen në QSUT sepse mendon se aty niveli i shërbimit, profesionalizmit, është më i lartë se ai që do të marrë në rrethe, përveç pjesës së pajisjeve me aparatura moderne, që fare mirë mund të bëhet edhe në spitalet e reja rajonale. Në rast se arrihet pajisja me burime njerëzore të specializuara të Spitalit Memorial të Fierit, kjo do të sjellë një zbrazje të mirë të QSUT-Së, sepse Jugu ka shumicën e popullsisë që kërkon shërbim shëndetësor në QSUT.

Ju mund ta shikoni këtë gjë dhe mund ta kërkon.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Pyetja e fundit. Pastaj do jua kaloj edhe një herë juve fjalën për përgjigjet dhe do ta mbyllim.

Po, Seladin.

**Seladin Jakupllari** - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar profesorë, mjekë,

Për fat të keq, situata e shërbimit shëndetësor në vendin tonë është e mjerueshme. Unë dal vetë në këtë konkluzion...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është e mjerueshme dhe kërkon...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më falni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Problemi emergjent që ka shërbimi shëndetësor, besoj se edhe ju bini dakord me mua, është hemorragjia e madhe e personelit shëndetësor. Ne duhet të gjejmë mënyrat dhe rrugët si ta ndalojmë këtë hemorragji. Jam plotësisht dakord me profesor Arbenin, rektorin, që një mënyrë është rritja e kuotave për studentët që duan të studiojnë për mjekësi. Por nuk është kjo e vetmja zgjidhje, sepse duhet të dimë që kostoja e formimit të një mjeku është tepër e lartë. Me sa di unë, në vendin tonë është rreth 100 mijë euro. Kjo është një kosto tepër e lartë, ndaj imagjinoni çfarë

humbasim ne. Që të nxjerrësh një mjek ose profesor, si ju profesor të nderuar, nuk është e lehtë, ndaj unë mendoj që mjekësia ka nevojë për reforma të thella.

Sot ne jemi vendi i pare që paguajmë 58% nga xhepi. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është 2,8% e GDP-së. Edhe me këtë jemi të fundit në Ballkan për sa i përket investimit në sektorin e shëndetësisë.

E shikoj emergjente ndërhyrjen, sepse situata e pandemisë nxori në pah shumë të meta që kemi ne si shërbim shëndetësor. Kjo tregohet me numrin e lartë të vdekjeve që kemi, qoftë në popullsi, qoftë edhe në numrin e personelit mjekësor, sepse humbën jetën rreth 50 mjekë të nderuar. Ashtu siç e thatë ju, duhet mbështetje nga buxheti i shtetit, nga disiplinimi i mirë i këtij buxheti, për të arritur qëllimet për të modernizuar shërbimin, sepse shërbimi shëndetësor është prioriteti i të gjitha shërbimeve për një shtet.

Faleminderit të gjithëve për prezencën dhe për punën tuaj të palodhur!

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Profesori e kërkoi fjalën.

**Artan Goda** – Meqenëse jemi në një institucion ku bëhen ligje, me njerëz që bëjnë ligje, dua të parashtoj një ide ngacmuese.

Të gjithë biem dakord që, po të hysh në thellësinë e tyre, gjithsecili prej nesh është i pakënaqur nga buxheti që ka në dispozicion. Kjo nuk është e këtij viti, por në 44 vjet karrierë që unë kam, kam pasur të njëjtat pakënaqësi, sepse sa më shumë buxhet të kesh, aq më shumë shërbime krijon.

Ne të gjithë e dimë, e thanë edhe kolegët, që këto janë buxhetet tona. Ne nuk hyjmë në shtetet e pasura me mundësi të mëdha, megjithatë ne mund të shtojmë aktorët financues në sistem, sepse ne jemi dakord që janë të nevojshme financime më të mëdha në sistemin shëndetësor.

Ne kemi modelin e centralizuar, ku gjithçka vjen nga një burim, që është Ministria e Shëndetësisë ajo që bën gjithçka.

Në fakt, ky nuk është i vetmi model që operon në vende të ndryshme, sepse ka shumë modele. Ka modele komplet të decentralizuara, siç është modeli skandinav, ku Ministria e Shëndetësisë nuk merret fare me buxhetet. Provincat sigurojnë shëndetin e popullatës që kanë marrë në ngarkim të drejtojnë.

Gjithashtu, ka edhe modele mikse. Vendi më i afërt dhe që kemi më shumë kontakt, Italia, është një model miksi, ku provinca ka një rol të caktuar, por edhe shteti ka një caktuar në politika, por edhe në financimet.

Me sa di unë, ne jemi i vetmi model i centralizuar. Mos ka ardhur koha që ne të fusim si aktorë financimi edhe bashkitë, të cilat nuk zgjidhen si ekip drejtues vetëm për lulishte, për ujesjellësit, por për të zgjidhur sa më mirë problemet e popullsisë që ata drejtojnë? Unë besoj që problemi i shëndetit është më i madh se ai i lulishteve rrugicave apo rrugëve.

Bashkitë tona nuk janë të pasura, se të tilla janë mundësitë e financimit të tyre, por duhet filluar t'i fusim edhe ato në lojë. Kjo do të sillte dëshirën e tyre në rritje për të pasur një shëndetësi më të mirë në mënyrë që të zgjidhen përsëri. Nga ana tjetër, kjo do të ndihmonte që të mos ketë mbipopullim në QSUT, siç biem dakord që të gjithë që ndodh, sepse vet drejtuesit e provincave shqiptare do të përpiqeshin të kishin një shëndetësi sa më të mirë për t'iu përgjigjur sa më mirë. Por kjo bëhet me ligj.

Këtë sigurisht nuk do ta marrë komplet bashkia, se nuk shkojmë dot atje, por të ketë një limit. Deri në 10% të buxhetit bashkia e ka të detyrueshme ta çojë në shëndetësi, për të shtuar aparataturat, financimet që ndërhyjnë kudo.

Kjo është një ide ngacmuese që ndoshta ka ardhur koha të diskutohet nga ana ligjore.

**Albana Vokshi** – Po, profesor.

**Mihal Tase** – Unë do të them diçka që na doli të gjithëve nga vëmendja.

Petriti iku, por na kujtoi Covid-in dhe sa u vlerësua roli i mjekut dhe i shëndetësisë.

Më duket se është harruar çështja e covid-it, ndërkohë që tani po vdesin më shumë njerëz sesa vdisnin një vit e gjysmë më përpara, por nuk del njeri të falënderojë doktorët ose infermierët. Kështu që, do të harrohet edhe kjo punë, se kështu ndodh.

Unë jam plotësisht dakord me të gjitha ato që thanë kolegët dhe ju, sepse të gjitha janë të vërteta. Ndoshta na e lejon eksperiencia e gjatë dhe mosha e vjetër t'ju kujtoj që shëndetësia dhe arsimiti nuk duhen parë politikisht. Ato janë probleme të kombit, nuk janë probleme partish dhe do të ishte shumë turp që t'i shikonim ashtu, siç janë parë deri më sot. Betejën politike bëjeni për gjëra të tjera, jo për arsimin dhe shëndetësinë, sepse është vërtet problem i madh.

Mendon pak për rrogat se thamë që mjekët po ikin. Nga një njeri që ka bërë dhjetë vjet universitet dhe që paguhet në moshën 45 vjeç-50 vjeç me një rrogë, e cila nuk i del as për të paguar qiranë e shtëpisë apo kredinë, mos prisni të keni përkushtim, dashuri për njerëzit apo

profesionalizëm dhe të mos ketë edhe mitëmarrje. Mos i prisni këto gjëra, sepse është të luftosh me mullinj të erës kur njeriu nuk ka të hajë. Prandaj, mendoni edhe për këtë gjë, ngrijini rrogat aq sa duhet, sepse prandaj ikin mjekët në Gjermani. Po të filloj të hapet edhe Italia, nuk e di sa ikin në Itali, se më duket se është hapur edhe Italia, pastaj do ta ndieni që po ngelemi pa mjekë

Kështu që, mendojeni këtë problem. Profesionit ynë nuk të bën të pasur, por të paktën mjekët të jetojnë me dinjitet. Unë nuk flas për veten time se unë për 1 vit dal në pension, por flas për brezat e ardhshëm, flas pa interes.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, profesor!

**Arben Gjata** – Meqenëse kishte pyetje, po u përgjigjem pyetjeve.

Faktikisht ne kemi hapur ambiente të tjera për të zëvendësuar mungesat që kemi.

Gjithashtu, kemi një projekt të madh, për të cilin unë ju kërkova mbështetje, i cili parashikon që aty ku është Gjashtëkatëshi sot të ndërtohet një qendër shumë e bukur. Po të kisha një fotografi, do jua kisha treguar. Është bërë projekti. Ajo qendër do të përfshijë kabinete, anatominë, histologjinë, laboratorët, kabinetet e stimulimit klinik, përfshin një bibliotekë të informatizuar e të tjera.

Ky është një projekt shumë i bukur, i cili është çuar për t'u prokuruar me fondet IPA. Ne kerkuam edhe mbështetjen tuaj për këtë. Kështu që, po mundët loboni pranë delegacionit të Bashkimit Europian që këto fonde të aprovohen dhe të fillojë ndërtimi se është gjithçka e përfunduar.

Nëse sigurohet financimi, me rastin e 70-vjetorit të universitetit, që është vitin tjetër, ne hapim themelet dhe të fillojë të ndërtohet kjo godinë, e cila i rrit jashtëzakonisht shumë kapacitetet pritëse të Universitetit të Mjekësisë. Pra, në vend të gjashtëkatëshi të ndërtohet në godinë tjetër.

Për sa i përket largimit të mjekëve, siç e tha Mihali, janë shumë faktorë që ndikojnë. Një ndër faktorët është pikërisht kjo. Por unë besoj se një faktor tjetër shumë i rëndësishëm që nxit mjekët të largohen është mënyra se si reagon politika dhe si ka reaguar media ndaj probleme të shëndetësisë. Në media, *good news, no news*, në politikë nëse themi që mjekësia është e mjerueshme në Shqipëri, u themi mjekëve ikni dhe pacientëve hajdeni të gjithë në QSUT.

Pra, duhet të kemi kujdes në termat që përdorim. Ata mjekë nga cepi i Shqipërisë në cepin tjetër janë kolegët tanë, të cilët janë marrë me të gjitha mundësitë e veta për të ndihmuar pacientët. Natyrisht ka pasur përmirësime. Ashtu siç ka vende që nuk është mirë, ashtu ka vende që është

shumë mirë. Ju siguroj që nëse do të vini një ditë si komision në shërbimin e kirurgjisë ku unë punoj, të jeni të sigurtë që është më mirë sesa në 90% të gjitha shërbimeve kirurgjikale në Europë, qoftë për infrastrukturë, qoftë për pajisje.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Dua të bëj një sqarim. Besoj se e keqkuptuat deklaratën e kolegut, sepse nuk ishte për ju, për ju kemi respektin maksimal, përulemi para të gjithëve ju për gjithçka që keni bërë, por nuk mund të mos pranojmë që ka edhe probleme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk është për ju, për qeverinë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk kam kohë, se janë 200 veta që po presin jashtë.

Të mos hyjmë në deklarata politike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Seladin, të lutem!

Sot nuk jemi për të bërë politikë, por të gjithë bashkë jemi në mbështetjen tuaj dhe prandaj po ju dëgjojmë me shumë kujdes dhe po mbajmë shënim çdo kërkesë që ju keni. Pra, na konsideroni aleatë. Nuk bëjmë politikë me ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Seladin, të lutem, i kemi mbajtur shënim të gjitha kërkesat dhe do t'i parashtrojmë një për një para Komisionit të Ekonomisë.

Doktoreshë Silva dhe doktoreshë Edlira dhe...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të shkurtër, të lutem, sepse kanë që në orën 11:00 që na presin.

**Silvana Bala** – Unë kam tri përgjigje të shkurtra që duhet t'i dini.

Krahas polit të madh të QSUT-së, që normalisht është një spital i madh, s'mund të krahasohen dot të dyja spitalet edhe me punonjësit që kam, se në QSUT janë 3000, ndërsa unë kam 500, por edhe me faktin tjetër të spitalit "Shefqet Ndroqi", që po shkon drejt definicionit të bërjes së një spitali rajonal universitar, pra nuk shkarkon ngarkesën e QSUT-së, për faktin se bëhen koronarografi dhe nuk bëhen pak, por arrijnë deri 6-7 të sëmurë në ditë, priten urgjencat kirurgjikale dhe vetëm dje ka pasur 35 urgjenca kirurgjikale.



I them edhe doktoreshës së re, që në këtë spital ka shërbim reumatologjie, nefrologjie, interni dhe e mos kishit fare pengesë dhe asnjë lloj pengese për ta sjellë atë të sëmurin që të trajtohej te reumatologët tanë. Kemi një reumatolog shumë të mirë, i cili ka mbaruar studimet në Itali, ka qenë një student i shkëlqyer dhe mund ta kishe marrë ndihmën shpejt, mirë të kualifikuar.

Po, profesor, ka qenë i mbyllur prej COVID-it, por mua më duhet të bëj të ditur, se ai është një spital që ka mjekë të të gjitha specialiteteve.

Për sa i përket pjesës “të mjerueshme”. Unë e kuptoj se çfarë thuhet, por unë kam njohur në kohën e COVID-it politikanë, që nuk i kisha njohur në 35 vjet punë. Ata politikane kanë ardhur, janë drejtuar tek unë, Florenci, Albana, tjetri, vëllai i Albanës, motra e Albanës, Arben Kamami, e të tjetër me radhë, që unë nuk i njihja më parë. Kam njohur kaq shumë njerëz në këtë 1 vit e gjysmë dhe kam shpëtuar kaq shumë jetë nga COVID-i, që normalisht është vlerësim i atyre gjeneratave që ka nxjerrë Fakulteti Mjekësisë. Jo të për të thënë se unë jam “Beluli”, se si unë ka me dhjetëra mjekë të tjerë, por po të kishit hyrë në sanatorium dhe të kishit parë se çfarë pune bënin mjekët atje, nuk do të kishin folur kështu këtu. Atje ishte luftë, ishte luftë po them, dhe të thuash “luftë” është pak, sepse kishte nga ata mjekë nuk kanë pirë ujë 24 orë, për të shpëtuar jetët e pacientëve atje.

Dhe për sa u përket vdekjeve, po të bëjmë krahasimin e mortalitetit të spitalit, nga statistika 2-3% ndryshon me statistikat e Europës, mos flas pastaj për reanimacionin dhe për të tjerat. Unë po flas për COVID-in, se e kam prekur dhe e kam ndjekur vetë.

Sa për kolegët që kanë humbur jetën, nuk janë vetëm kolegët shqiptarë, kemi edhe kolegë të tjerë. Edhe për personat që bënë *suicide*, nuk janë vetëm shqiptarët që bënë *suicide* nga COVID-i, se artikujt e fundit nxjerrin *suicide* në përqindje shumë herë më të mëdha edhe nga COVID-i, edhe nga post-COVID-i. Çfarë do të bëjmë? Jemi ulur të diskutojmë për këtë gjë, që ta minimizojmë sa më shumë këtë fenomen, se ndoshta edhe mbyllja që iu bë në spital pacientëve, ku pacienti shkëputej nga familjarët, ishte edhe ajo një gjë e rëndë, por gjithmonë frika të bën që të mbrohesh më shumë sesa të hapesh. Prandaj duhet ta keni parasysh këtë gjë, sepse atyre të sëmurëve nuk u ka munguar as vipapi, as ipapi, as oksigjeni, as antibiotiku, as albumina, as plazma, as gjaku, asgjë. Ka pasur nga ata mjekë që kanë dhënë gjak për të sëmurët, kanë shkruar, mjekë, infermierë, sanitarë jepnin gjak që të shpëtonte i sëmuri.

Në 37 vjet punë, unë nuk kam parë që infermierja 21-vjeçe të fuste duart për të hequr panolinën e pacientit. Dhe jam e sigurt, po ju them se sikur një familjar të kishte qëndruar 24 orë

në shërbim të atij të sëmuri, do të thoshte të nesërmen, nuk e bëj më këtë gjë. Kështu që, është kollaj ta thuash kur je larg, por kur je aty brenda është gjë tjetër pastaj. Fjalët, opinionet, pakënaqësitë apo shtesa të të gjitha këtyre gjërave, nuk janë reale, ashtu siç e kam përjetuar unë në spital apo profesoreshë Najada, që nuk vjen dot këtu sot, që të flasë dy fjalë, se është e zënë.

Kështu që, të dashur kolegë, ju, mjekët, për këtë pjesë duhet të na jeni në mbrojtje, gjërat të tjera, çfarë keni, i dini ju, se unë nuk marr vesh nga këto, se tani kam filluar nga buxheti, prokurimet e të tjera. Për mua është shkollë e re kjo pjesë.

**Albana Vokshi** – Faleminderit, doktoresha!

Jam dakord me ato që thatë. Të paktën për aq kohë sa unë jam dhe do të jem këtu në krye të këtij komision, nuk do të bëjmë politikë me shëndetësinë, ndaj kemi qenë bashkë tek onkologjiku, do të bëjmë bashkë dhe seanca të tjera, për çdo gjë që ka lidhje me ju, si mjekë, si dhe për çdo gjë që ka lidhje me shëndetësinë, politikën do ta bëjmë me të tjerët, me ata që bëjnë politikë.

Florenc, nuk kam kohë, do t'i jap fjalën drejtoreshë Edlirës.

Fjalën e ka drejtoresha.

**Edlira Bode** - Shumë faleminderit, kryetare!

E marr fjalën për herë të dytë, do të mundohem të jem jo vetëm koncize, por edhe e shpejtë në të folur, por nuk mund të rri pa prekur shkurt fare 3 nga çështjet sipas radhës që dolën gjatë kësaj seance, për komunikimin me familjarët, për infrastrukturën për t'iu përgjigjur zonjës Pampuri, dhe për portezat, për t'iu përgjigjur doktoreshë Klodiana Spahiut.

Meqenëse kjo seancë është publike, me jepni të drejtën t'i drejtohem edhe publikut, jo vetëm juve. Komunikimi me familjarët duhet të na bëjë të mendojmë pak, ne si shoqëri, që duhet të ndërrojmë mendësinë. Sistemi shëndetësor ka nevojë të vendosë një komunikim të drejtë, të hapur, të sqartë, por ne kemi detyrimi që të flasim me një familjar të afërt të çdo pacienti, që drejtohet në një institucion shëndetësor. Edhe kartela kur hapet fizikisht, ka një vend të veçantë, ku shënohet emri dhe kontakti i një familjari, jo i disa familjarëve. Dhe ky familjar zgjidhet nga pacienti, nëse ai është i ndërgjegjshëm ose duhet të zgjidhet me marrëveshje midis familjarëve, në rast se pacienti nuk është i ndërgjegjshëm. Më ka ndodhur këto ditë, të komunikoj me disa familjarë për të njëjtin pacient, por pacienti familjarë të gradës së parë mund të ketë një numër të pafundëm, motra vëllezër, prindër, fëmijë, disa nga këta. Duhet shoqëria shqiptare duhet ta ndryshojë paksa këtë mendje, jo të gjithë kanë të drejtë të shkojnë te mjeku apo tek zyra e marrëdhënive me

publikun e institucionit dhe të kërkojnë secili më vete informacion për familjarin që kanë të shtruar. Kjo e bën të pa mundur funksionimin e një institucioni shëndetësor. Ne komunikojmë me një familjar, ata duhet të komunikojnë me njëri- tjetrin.

Për infrastrukturën, zonja Pampuri ka të drejtë që lë për të dëshiruar infrastruktura, sidomos e korpusit qendror të Spitalit të Traumës. Kam gjetur një investim të shkëlqyer të bërë në repartin e kirurgjisë rikonstruktive. Janë ambiente model dhe funksionimi aty është model, sapo ka filluar rikonstruksioni i një godine trekatëshe, ku ishin të vendosur 2 shërbime të terapisë të sëmundjeve të brendshme dhe për momentin, situata në pjesën tjetër të spitalit do të jetë edhe më e vështirë, sepse janë bashkë ngjitur këto dy shërbime. Ne nuk e kemi mundësinë që të zhvendosim plotësisht spitalin dhe ta rikonstruktojmë njëherësh, kështu që me të mbaruar rikonstruksioni i kësaj godine trekatëshe që po ndodh tani, do të kërkoj investime për pjesën tjetër, se është duke u bërë projekti, por nuk e përmenda në kërkesat e mëparshme, sepse do të jetë për një moment të dytë.

Kurse për protezimin, doktoreshë Klodiana, keni shumë të drejtë për renditjen e listës së pritjes. Për shkak të mbështetjes me buxhet në rritje graduale në këto vite, kemi arritur të mbulojmë 100% të urgjencave. Lista e pritjes është ende e gjatë dhe nevojat janë të shumta. Ju keni të drejtë për një mënyrë renditjeje të drejtë. Kam kërkuar nga komisioni mjekësor, që të mos jenë sipas datave të paraqitjes, por të bëhet një vlerësim sipas kritereve, në mënyrë që ta marrë shërbimin i pari ai pacient që e ka rastin më urgjente.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** - Faleminderit!

Po, nëndrejtoresha dhe këtu më duhet ta mbyll.

**Ariana Strakosha** – Shkurtimisht, vetëm një çështje që ka qenë problem, nga tërmeti u dëmtua godina ku ishte akomoduar reumatologjia, nga ana tjetër u bë infektivi COVID, kështu që ne si repart i alegros u detyruam të bënim lëvizje. Pra, u gjendëm përballë dy situatave, që për herë të parë, realisht kushdo do të gjendej në atë situatë. Kemi krijuar shtretër për reumatologjinë dhe alergologjinë të akomoduar te Spitali Francez, optimalisht të nevojshëm për raste e rënda, sepse ju e thatë këtë problematikë, për nga ana tjetër, the edhe që duhet të forcojmë spitalet rajonalë. Pikërisht, ky është problemi, që spitalet rajonalët do të forcohen, duke e mbajtur të sëmurin në rajonal, duke kërkuar asistencë nga mjekët e QSUT-së, qoftë edhe online, sepse për sëmundje si lupusi, për shembull, unë edhe doktoresha tjetër Zheni, e kam shoqe, kolege dhe më kupton, kështu që koepërojmë me të sëmurët.

Prandaj, nuk ka munguar shërbimi ndaj të sëmurëve të reumatologjisë, rastet e rënda janë shtuar aty ku ka qenë organi më i prekur. Unë kam 35 vjet mjekje, por tani jam bërë drejtoreshë dhe gjithmonë kam qenë për fuqizimin e spitaleve rajonalë. Në momentin që mjekët nuk kanë besim te vetja dhe thonë, ta çojmë në Tiranë, se ka më shumë mjekë, aty çëdojnë. Duhet fuqizuar spitalet rajonalët, se të gjithë janë asete, të gjithë janë meqë të përgatitur, prandaj i mëshova edhe telemedicinës, bota sot bën konsulta me telemedicinë.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Do ketë shtretër për alergologjinë.

Më falni, por do të flas shkurt.

**Albana Vokshi** - Jo s'ka gjë, është faji ynë, e kemi planifikuar ne gabim.

**Ariana Strakosha** – Jo, se edhe ne e zgjatëm të gjithë.

**Albana Vokshi** – Jo, duhet t'ju kishim lënë kohë pa limit.

**Ariana Strakosha** - Jo, ne bëmë debate të hapura, të sinqerta.

Për problemin e trombektomisë që ngriti Klodi, po punojmë fuqishëm që të realizohet, pra është hapi i dytë i trombolizës. Të na mirëkuptoni vërtet, se themi “COVID-i”, duket pak kur thuhet kështu, por është vërtet shumë për një institucion shëndetësor, se shumë plane na kanë ngelur në mes të rrugës, prej COVID-it. Kjo është një sfidë për pacientët se e dimë që është një procedurë shumë kosto, duke parë edhe nivelin e njerëzve, se ne kemi kontakt me shtresat më nevojtare të shoqërisë, dhe kur na vjen një grup të sëmurësh me dializë, unë me Zhenin e dimë se çfarë kërkesa kanë dhe përpiqemi t'ua plotësojmë.

Këto kisha për të thënë.

**Albana Vokshi** - Po, zonja Qiriazi.

Pastaj e ka fjalën Florenci.

**Brikena Qiriazi** – Unë jam Brikena Qiriazi, nëndrejtoreshë mjekësore në QSUT.

Shumë shkurt, ne folëm për problemet e përditshme, por të mos harrojmë 4 institucionet këtu të pranishme janë institucione terciare dhe universitare, që nënkuptojnë se pjesë të punës kanë edhe kërkimin shkencor, që nënkupton se duhet të përfshihen fuqishëm në skema internacionale *multi center studies*, që nënkupton jo vetëm thithje fondesh për të mbuluar nevoja buxhetore të momentit, por kryesorja për të rritur nivelin e mjekëve, nivelin profesional të pedagogëve që punojnë, dhe njëkohësisht për të ofruar një shërbim sa më modern ndaj pacientit

dhe sa më profesional. Kjo është shumë e rëndësishme dhe është më mirë të vijmë ata këtu, të punojmë këtu me ne, sesa të shkojmë ne një nga një andej, por sigurisht edhe kjo ka vlerën e vet.

Skema të tilla studimesh dhe projektesh ka shumë, si Raisen 2020 apo Taipa, por ka edhe skema të tjera nëpërmjet të cilave Komiteti European e afron këtë lloj asistence. Problemi është që midis legjislacionit shqiptar dhe mënyrës sesi funksionojnë këto skema ka një mospërputhje nga ana ligjore dhe kjo e bën shumë të vështirë implementimin e këtyre projekteve, si dhe përdorimin e këtyre fondeve deri në qindarkën e fundit që të shkojnë aty duhet. Ky është një problem që ne nuk e zgjidhim dot në pozicionet që kemi. Ka një përpjekje të disa institucioneve në dijeninë time, përfshirë edhe NAST-in, edhe Akademinë e Shkencave, por të lëna në mes të rrugës, kështu që mendoj se duhet një ndërhyrje nga ana juaj si ligjvënës për të sjellë një përputhje të këtyre legjislacioneve, sepse kjo do të thithte më shumë fonde, projekte, pajisje shkencore, apo edhe teknika të reja në Shqipëri.

Më shkurt se kaq nuk bëhet, domethënë.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** - Faleminderit!

Kurdo që ju të jeni gati, ne jemi përsëri të gatshëm për t'u ulur dhe për të shqyrtuar çështje që keni ju dhe të shikojmë se çfarë mund të bëjmë apo edhe sesi mund të ndërhyjmë në legjislacion.

Përpara se t'i jap fjalën Florencit, dua të them se, kur ishim në QSUT, doktoreshë Silvana, doktor Elidoni bëri një kërkesë, ai kishte një projekt të vogël për spitalin tuaj dhe një kërkesë për mbështetje, meqenëse kemi edhe nëndrejtoreshat këtu, të pacientëve në fazën e kimios për paruke apo për nevoja të tjera për pacientët që bëjnë ndërhyrje. Nëse kjo është e mundur të parashikohet, që nëse keni mundësi të na i dërgoni këto ditë, që ta shqyrtojmë po këto ditë. Sepse është vërtet keq të mos u vijmë në ndihmë të sëmurëve me gjëra kaq elementare.

Po, Florenc, fjala është për ju.

**Florenc Spaho** – Në fakt, unë ju kërkoj ndjesë dhe falje për kohën, se e di që koha është e çmuar për të gjithë të ftuarit, për të gjithë pedagogët, për të gjithë mjekët që janë këtu. Sot është dita e çlirimit të Elbasanit, 77 –vjetori dhe si deputet i qytetit isha detyruar të isha atje, por jam i bindur që më kanë zëvendësuar denjësisht kolegët, se i kanë bërë të gjitha pyetjet shteruese.

Ne jemi absolutisht dakord me çdo nismë që kanë të gjithë mjekët. Unë jam i emocionuar tani edhe në momentin që u ula m'u duk vetja sikur isha në auditor, sepse unë jam rritur me shembullin e të gjithë profesorëve dhe mjekëve të nderuar, që janë këtu në sallë. Jam rritur me

emrin e tyre dhe jam krenar që jam një produkt i tyre. Siç e tha edhe doktoreshë Silva, unë përveç se i kam besuar anës akademike të tyre, doktoreshë Silvës i besova edhe jetën time, kam qenë në një moment shumë të keq si pasojë e COVID-it, kështu që të gjitha fjalët e thëna për mjekët dhe për punën e tyre është e merituar.

Patjetër, është një punë e nderuar, sepse të shpëtosh një jetë të bën hero, ta bësh atë përditë të bën mjek apo infermier. Ndër falënderimet që kam ndër mend gjithmonë për pedagogët dhe për elitarët që janë sot ambasadorët e mjekësisë shqiptare, siç jeni ju, sot këtu të gjithë, kam një falënderim super special për ju, që e kam pasur në mendje gjatë gjithë kohës, që në momentin kur kam mbaruar Fakultetin e Mjekësisë, ku kam marrë dijet nga ju, të cilat i kam vënë në zbatim për qytetarët dhe për njerëzit, të cilët janë drejtuar tek unë. “Kush nuk falënderon njeriun, nuk ka falënderuar Zotin”, është një shprehje, kështu që sado që të jenë falënderimet, për ju nuk mjaftojnë.

Për të ardhur konkretisht te një pyetje, e cila është drejtpërdrejt, që do t’ju vijë edhe në ndihmë, të cilën e kam ngritur si shqetësim edhe para dy vjetësh, për pjesën e buxhetit flas, është për profesor Arben Gjatën, por edhe për mjekët profesorët e nderuar: a kemi nevojë, profesor, për më shumë kuota për specializantë për mjekë infeksionistë? Pasi siç e dimë, sot për fatin e madh, ne na ka dashur Zoti shumë, që përballë kësaj pandemie patëm mjekë kaq të nderuar si ju, që e përballuat këtë pandemi. A mundet të krijojmë ne një elitë tjetër? Mos e dhëntë Zoti asnjëherë, të kemi pandemi të tjera, por nuk duhet të jemi gjithmonë të papërgatitur me burime njerëzore. Pra, profesorë të nderuar që ishit në ballë të luftës, në ballë të një pandemie globale, a kemi mundësi ne të përgatisim një elitë të tillë?

Ia kam paraqitur këtë shqetësim dhe ministres së Shëndetësisë dhe asaj të Arsimit për një stimul në këtë fushë, sepse duke qenë se shumë mjekë të rinj shkojnë drejt specializimeve të tjera dhe specializimin e infeksionistit, që është shumë i rëndësishëm nuk e preferojnë të gjithë studentët. A kemi ne mundësi që t’i përgatisim këta mjekë? Do të jetë shumë e vështirë, nëse nuk do të arrijmë të përgatisim një grup elitë, siç jeni ju sot këtu, që u keni dhënë një qetësi dhe një siguri të gjithë qytetarëve që nga momenti i fillimit të pandemisë në 8 mars të vitit 2020, dhe unë isha i bindur që do ta përballoni me sukses, pavarësisht shumë vështirësive që kemi hasur, kemi ndeshur rrugës.

E dyta, për doktoreshë Edën. Doktoreshë Eda, unë e kam ngritur shqetësimin e skoliozave disa herë, a keni ju një program gati për fotometrinë? A kemi ne në Spitalin Ushtarak për momentin një pajisje 3D për të nxjerrë kushtet e personalizuara për fëmijët nga 10-vjeç deri 15- vjeç?

Ju faleminderit të gjithëve!

Ndjesë edhe për kohën!

Në radhë të parë, u kërkoj falje të gjithë profesorëve për minutazhin dhe ndjehem shumë keq që nuk isha që në fillim të mbledhjes!

**Albana Vokshi** – Jo, nuk ka problem, por pjesën e kuotave e trajtuam, kur ti ishe në Elbasan te festa e çlirimit, por e ke të regjistruar dhe të lutem, nëse rri me Edlirën pak...

**Edlira Bode** - Do i kthej përgjigje në një moment të dytë.

**Albana Vokshi** – Jo, tani, nëse doni.

**Edlira Bode** - Nuk e kam këtë informacion, se nuk isha e përgatitur.

**Albana Vokshi** – Në rregull.

Ju falënderoj shumë për të gjithë kohën dhe kontributin!



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.11.2021, ora 13:00

**Drejton mbledhjen:**

**Albana Vokshi – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin "Për buxhetin e vitit 2022".

*(Për çështjet që kanë të bëjnë me shëndetësinë, me çështjet sociale dhe me të rinjtë.)*

#### **Marrin pjesë:**

Albana Vokshi, Klodiana Spahiu, Ilirian Pendavinji, Dasantila Tahiraj, Florenc Spaho, Niko Kuri, Shpresa Marnoj, Mirela Pitushi, Tatjana Piro, Lindita Buxheli, Ilir Metaj, Anila Denaj, Gertjan Deda, Petrit Vasili, Grida Duma, Mesila Doda, Orjola Pampuri, Tritan Shehu, Zheni Gjergji, Ilda Dhori, Seladin Jakupllari.

#### **Të ftuar:**

Ndrek Ismailaj – President i Shoqatës së Para dhe Tetraplegjikëve

Emanuela Zaimi - *Down Syndrome Albania Foundation*

Ermonela Xhafa – Komisionere për Shëndetësinë tek Avokati i Popullit

Vilma Shurdha – Komisionere për Çështjet Sociale tek Avokati i Popullit

Etleva Sheshi – Përfaqësuese e Avokatit të Popullit

Mimoza Morina –Përfaqësuese e Avokatit të Popullit

Bedri Abdulla – Përfaqësues nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë

Lulzim Resuli – President i Shoqatës Kombëtare të Jetimëve të Shqipërisë

Sinan Tafaj – Ekspert i të Drejtave të Njeriut në “Bashkimi i Organizatave Kombëtare Lokale të Aftësisë së Kufizuar”



Ermela Zenelaj – Kryetare Shoqatës për Mbrojtjen e Talasemikëve Shqiptarë  
Ethem Fezollari – kryetar i Shoqatës Antikomuniste e ish-të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë

Eglantina Ajdini – Shoqata Antikomuniste e ish-të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë

Elsa Zhulali – Drejtuese e Fondacionit “*Grow Albania*” *Gluten Albania*

Aferdita Saiti – Përfaqësuese nga Shoqata “Ndihmoni jetën”

Genti Stroni – Përfaqësues nga Qendra për të Drejtat në Punë

Asim Toro – Përfaqësues nga Shoqata e Diabetikëve

Altin Hazizaj – Drejtues i CRCA-së

Mirgjit Vataj – Drejtor i “Alo 116-111” Shqipëri

Samantha Woolfe - Përfaqësuese e INHOPE, Qendrës Europiane për Internet të Sigurt

Ilda Pisha – Përfaqësuese nga Qendra për Arsim Cilësor

Afshan Khan – Zëvendësambasadore e UNICEF-it

Mirela Arqimandriti – Përfaqësuese nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Eglantina Bardhi – Përfaqësuese nga Shoqata “*Together for life*” dhe “*Save the children*”

Denisa Canameti – Përfaqësuese nga Shoqata “*Together for life*” dhe “*Save the children*”

Mariana Bukli – Përfaqësuese për çështjet e shëndetësisë dhe çështjet sociale

Iva Zajmi – Përfaqësuese për çështjet e shëndetësisë dhe çështjet sociale

Alketa Zazo – Përfaqësuese për çështjet e shëndetësisë dhe çështjet sociale

Edina Kozma – Përfaqësuese për çështjet e shëndetësisë dhe çështjet sociale

Enkelejda Kallçiu – Drejtore Kombëtare “*Terre des hommes*” Shqipëri

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë

Saimir Kadiu – Drejtor Buxheti në Ministrinë e Shëndetësisë

Antoneta Njehrrëna – Drejtore Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë

Denada Seferi – Zëvendësministre e Shëndetësisë

Arda Lazareni – Specialiste në Agjencinë e Mbrojtjes së Fëmijëve

Eneida Capo – Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Mbrojtjes Sociale

Brunilda Dervishaj – Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Përfshirjes Sociale

Bilal Kola – Përfaqësues nga Instituti i të Përndjekurve Politikë

Arlinda Topçiu – Përfaqësuese nga Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve

## HAPET MBLEDHJA

**Albana Vokshi** – Fillojmë mbledhjen.

Edhe një herë ju kërkoj shumë ndjesë për pritjen e zgjatur, por kishim drejtuesit e QSUT-së, gjithë shefat e shërbimeve dhe na mori më shumë kohë nga sa e kishim parashikuar.

Jam shumë e kënaqur për këtë dëgjese dhe për interesin që keni pasur për t'i diskutuar me ne çështjet e buxhetit të vitit 2022. Shpresoj shumë që të kemi një diskutim konstruktiv. Ne do të përpiqemi që, të paktën me Komisionin Ekonomisë, të mundohemi të ngremë problematikat që ju keni.

Atëherë pa humbur kohë, ia kaloj fjalën Ndrek Ismailajt, president i Shoqatës së Para dhe Tetraplegjikëve.

**Ndrek Ismailaj** – Faleminderit për ftesën!

Është kënaqësi të jem i pranishëm dhe të shpreh disa shqetësime, duke ju falënderuar që na keni ftuar në këtë takim. Në fakt, ne duhej të ishim ftuar që në momentin kur ministria e kishte marrë këtë iniciativë, sepse nuk është hera e parë që i bëjnë këto veprime, se jemi mësuar tashmë. Ndihem jashtëzakonisht si një qenie jo e dëshiruar për ju, pasi është hera e pestë që vij në këto komisione dhe në përgjithësi asnjëherë kërkesat tona nuk janë marrë parasysh. Pra, e kemi gabim, apo ju nuk doni t'i kuptoni hallet dhe shqetësimet që kemi? Prandaj ndihem gjithnjë i padëshiruar.

**Albana Vokshi** – Më falni, se kemi një problem me mikrofonin tuaj dhe nuk po regjistrohet dhe, meqenëse duam që të jetë publike dhe të dëgjohet ajo çfarë ju thoni...

**Ndrek Ismailaj** – Unë jam munduar që shqetësimet t'i kem sa më të shkurtra dhe sa më të sakta. Shikoj buxhetin, dhe më bën shumë përshtypje që në asnjë vend të buxhetit nuk shikohet se do të ketë rritje të pagesës të aftësisë së kufizuar. Domethënë, historikisht një paratetraplegjik në momentin që bëhet paraplegjik historikisht del në pension të përjetshëm dhe në mënyrë kategorike, në qoftë se i shtohen hallet, vështirësitë, problemet e tij, i thonë: ti je paraplegjik, pensioni është kaq e mirupafshim.

Shqetësimi i dytë, që ka të bëjë shumë me shëndetësinë, është problemi i ndarjes së marrëdhënies mjek familje-infermier. Një paratetraplegjik nuk ka nevojë për mjek familje, aq sa ka nevojë për infermier, pasi gjatë gjithë kohës ka probleme me degupicus. Paratetraplegjik, në rang republike, kemi 6800, me statistikat e ministrisë.

**Albana Vokshi** – Më falni, edhe një sekondë që të vijë dhe përfaqësuesja ministrisë që ta dëgjojë. E kemi zëvendësministren, por kërkon edhe zonja Denada, meqenëse mbulon mirëqenien që ta dëgjojë, meqenëse nuk ju kanë marrë mendimin.

Jemi me vonesë për fajin tonë, jo për tuajin.

**Ndrek Ismailaj** – 20% e këtij grupimi kanë gjithmonë një plagë, që ato nuk mbyllen për 1 javë apo as për 10 ditë, ato duan me muaj të mbyllen, dhe mjeku i familjes, që ju e keni futur atë në ligj, nuk ka çfarë të bëjë. Kur shkojnë te poliklinika, në shumicën e rasteve nuk kanë akses. Ky ofrim në shtëpi nuk bëhet nga infermieri. Nuk e di si do të gjendet zgjidhja e kësaj pune, megjithëse kjo punë po debatohet vit pas viti.

Një tjetër është aksesueshmëria. Në buxhet nuk shikoj asnjë fond që do të hidhet për aksesueshmërinë e poliklinikave ekzistuese. Thuhet që aty do të bëhen poliklinika të reja, të cilat në përgjithësi kanë aksesueshmëri, por nuk kanë aksesueshmëri ato ekzistueset, të vjetrat që janë në katet e dyta dhe të treta nëpër Tiranë dhe jo më në fshatrat e Shqipërisë. Nuk kanë aksesueshmëri ambulancat për një paratetraplegjik. Ju keni menduar se të gjithë personat, që do të sëmuren, do të kenë probleme shëndetësore, do të jenë në këmbë, jo, sepse ka edhe në karrocë, ka edhe tetraplegjikë që nuk lëvizin as duart. Si do të zgjidhet problemi i tyre?

Së fundi, për sa i takon shëndetësisë është shqetësimi i rimbursimit të ilaçeve. Ligji i shtetit shqiptar thotë se rimbursimi i ilaçeve, për pasojë i dëmtimit. Domethënë, unë që kam thyer kolonën, asnjë ilaç nuk më rimbursohet për kolonën, sepse nuk ka ilaç për kolonën. Unë do të kem infeksione të herëpashershme, do të kem sëmundje të tjera dhe, në qoftë se çoj një faturë te farmacia, nuk më rimbursohet asgjë, sepse thotë që nuk është mbuluar nga shpenzimet e tua.

Ndërsa te problemet e mbrojtjes sociale, më vjen keq ta them, por që në momentin kur erdhi ministrja ekzistuese në ministri vitin e parë tha: “Unë do të bëjë një qendër rehabilitimi.” Kaluan dy vjet, nuk e bëri. Vitin e tretë tha: do të bëjë 2, kurse këtë vit e lexova me kujdes, se mendova se do të thoshte 3. I kishte harruar fare. Jemi i vetmi vend në Europë që nuk kemi qendra rehabilitimi. A e kuptoni që vetëm nga qëndrimi në karrocë 8 orë, vjen koha e kalcifikimit të kockave. As nuk ofroni shërbim në banesë, as nuk ofroni në qendra rehabilitimi, as nuk e keni nocionin se çfarë po bëhet me një studim pilot për vlerësimin e aftësisë së kufizuar sipas ICF-së. Po si mund t’i vlerësoni personat me aftësi të kufizuar, sipas ICF-së, kur nuk keni krijuar asnjë standard sipas ICF-së? Në qoftë se Ndreka shkon për t’u vlerësuar, sipas ICF-së, te komisioni, komisioni duhet t’i ketë të gjitha tipet e karrocave që duhen pas ICFsë. Ju nuk keni një karrocë për

ICF-në dhe as për Ndrekën. Në mënyrë kategorike nuk keni një shërbim psiko-social. Këta njerëz kalojnë trauma të herëpashershme. Ju keni një person në familje, një të afërm një javë me grip, ma merr mendja që e gjithë familja është e çorientuar, por ne që jemi të gjithë jetën në atë familje, si do të jetë ajo familje?

Unë mbase bëhem shpeshherë i bezdisshëm, mbase flas edhe pak në gjuhën siç ma ka dhënë nëna, të rëndë, por flas atë që më dhëmb në shpirt. A mund të tolerohet, se kjo është radha e pestë që vij në këtë komision dhe them: o shqiptar, kam 23 vjet në karrocë dhe qeveria shqiptare nuk më jep një karrocë! Si i bëhet? Si ka mundësi që i gjithë ky grup deputetësh një herë në 5 vjet që vijë këtu, nuk ka mundësi që ta zgjidhë këtë ngërç që ka ngelur?! Mos e dëgjoni ministrinë, ju jeni përfaqësues të popullit, jo këta, këta janë rrogëtarët tuaj. E kuptoni që kanë hapur një shpikje allashqiptarçe, kanë hapur një minipunishte për prodhim karrocash. Në shekullin XXI prodhohen karroca prej hekuri, i saldojnë, i sjellin pjesët nga Kina, nga nuk i sjellin, nga fundi i botës dhe na thonë: ik merre karrocën te filan minipunishte. Nuk kanë as standarde, as përmasa sipas personit, as nuk kanë përdorim dhe as gjërat më elementare; as nuk flasin fare për aksesueshmëri në banesë, në qoftë se personi bëhet i tillë. Nuk e di se ku mund të përplasemi më. Më shumë se te ju, unë nuk kam ku të bërtas dhe, në qoftë se nuk më dëgjoni ju, nuk di çfarë të bëj.

Faleminderit!

Inshallah nuk vij vitin tjetër që ta them përsëri këtë fjalë.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Zoti Abdulla, nga shoqata e invalidëve të punës.

**Bedri Abdulla** – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Është bërë e modës tani që ne vetëm vijmë e flasim kot, ashtu siç e tha kolegu im përpara, por nuk e di a ju ka ardhur një material, që e kemi çuar për stafin e komisionit, që të njiheshim pak më parë. Do të flas shkurt. Vetëm kemi kërkuar ato që na janë premtuar. Asnjëherë nuk kërkojmë, sepse tani jemi brumosur mjaft mirë duke parë qoftë tërmetin, qoftë pandeminë. Gjej rastin të them që invalidët e punës u vaksinuan totalisht, 75 mijë veta. Mund të raportoj para jush që në këto momente vetëm, në qoftë se në vitet e tjera kishte mbi 180 që ndërrojnë jetë, sepse kuptohet mosha jonë, ku frytet i morën të shëndoshët dhe ne lamë pjesët e trupit nëpër miniera, sot mosmirënjohja e institucioneve shtetërore është në nivelin maksimal. Shumë kemi bërë Ilafologji, sepse askush nuk na kupton, as ata që janë në detyrë dhe as ju që keni mandatin. Ju duket pak e hidhur, por kam

kënaqësi, se kur i diskutoj të hidhurat në fillim, shikoj, ashtu siç tha zoti Ndreka, se mos dalin të ëmbla në fund, por nuk e besoj.

Së pari, ne kemi kërkuar një shumë me shkresën nr. 21 322 dhe ish-ministrja e Financave, sot deputete, na ka premtuar në projektbuxhetin e vitit 2021 që do të jetë një shumë prej 450 milionësh, 5-mijëlekëshi që na u mohua në vitin 2007.

Shkresën e zonjës Anila Denaj e kam këtu.

Pika 2 është premtimi i Kryeministrit në vitin 2013 për një ndihmë paaftësie, për shtesë në ndihmën e paaftësisë. Këtu kam përfaqësuesit e ish-ministrit së Punës dhe Shërbimeve Sociale që kanë prezentë në sallën tjetër dhe thanë se janë të miratuara. Normalisht asgjë. Habitem, se ju kam thënë një herë dikur, ju jeni të rinj ndoshta, por u kam thënë të tjerëve që mos u besoni, ashtu siç e tha zoti Ndreka, ata administratorët apo punonjësit e administratës, se nuk janë kurrë të sigurtë. Në qoftë se doni të shikoni vlerësimin e punës suaj, në daç qeveria në daç ju, deputetë, hajdeni merruni me ne, sepse ju themi realen. Është e drejta juaj për ta zgjedhur, por nga ana e arsimit jemi më të kompletuar se ata të administratës suaj, nga ana e përvojës kemi më shumë dhe e dimë mjaft mirë legjislacionin ndërkombëtar, por ju bëj me dije që ju respektojmë, se keni një mandat, pra ne përfaqësojmë 75 mijë veta, ju keni një mandat dhe uroj që ta gëzoni, por në shërbim të njerëzve.

Së treti, indeksimi i ndihmës së paaftësisë që bëhet për të gjitha kategoritë e tjera. Dikush nga Ministria e Shëndetësisë na kishte thënë se është për shtesë mbi pensionin. Po ushtarakët nuk e kanë shtesën mbi pensionin? Është indeksuar që në vitin 2008 në vendim nr. 869 dhe nuk është indeksuar më. Pra, është hequr vendimi nr. 204 dhe ka dalë vendimi nr. 869 të vitit 2008. Pra, kjo nuk është indeksuar, ne e kemi gjetur rrugën tjetër, por do t'i kushtojë shtetit shumë. Dikush mund të thotë që unë jam qytetar i Shqipërisë, nuk ia qaj shumë hallin shtetit, por vlerësoj që bëhem man e shkudem vetë jo arrë me dru, siç bëhen shumë të administratës shtetërore.

Së katërti, në projektbuxhetin e Shoqatës së Invalidëve të Punës vitin e kaluar Ministria e Punës në ligjin nr. 7889, neni 18, thotë: “Shteti financon veprimtarinë e shoqatës së invalidëve të punës”. Në këto momente është futur një shoqatë tjetër, a është gjetur ligj apo Maliq (unë e kam shkresën këtu) dhe na kanë diskriminuar. Ju keni të gjithë vëllezër, kur janë ndarë vëllezërit, kanë hyrë në buxhetin e komshiut, apo kanë ndarë buxhetin e tyre aty? Pra, me ligj të mos më flasë njeri, sepse i di mjaft mirë edhe nga përvoja. Këto kisha.

Mund të thoni sa duhen? Po, e kam nxjerrë buxhetin: 450 milionë janë për pikën e parë që është premtuar. Domethënë, për 5-mijëlekëshin e vjetër dhe 500 lekëshin e ri, 900 milionë janë për pikën e dytë që ka premtuar Kryeministri në vitin 2013, për pikën tretë, indeksimi është 62 milionë dhe për ata që ia kanë mohuar Shoqatës së Invalidëve të Punës 220 mijë. Unë i kam kërkuar edhe Komisionit të Ekonomisë, sepse, së pari, këtu ka një mospërfillje dhe një mosmirënjohje. Domethënë, nuk hartohet projektligji pa u marrë mendimi, sepse në ligj, në nenin 18 të tij, thuhet: “Përfaqësuesit e Shoqatës së Invalidëve të Punës marrin pjesë në hartimin, diskutimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore që prekin direkt apo tërthorazi interesat e invalidëve”. Ku janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, apo Ministria e Financës? Çfarë mendimi kanë marrë te ne, apo, pasi i kalon ligji, sepse janë mësuar? Kështu kaluan ligjin e punësimit dhe na u desh të kapnim Kryeministrin të Rogneri dhe t’i thoshim: “Zotëri, çfarë bëhet?”, sepse duhet të raportojë. Për shembull, në qoftë se ju politikanët shkoni e ziheni atje në Parlamentin Europian, unë nuk mund të gënjej më, nuk mund të them pse një koleg i imi në Maqedoni merr 392 euro. Unë kam lënë këmbën në minierën e Valiasit dhe marr 78 mijë lekë. Pse na diskriminoni? A do të shkollohen fëmijët tanë?! Ku janë këta njerëz? Çfarë mendimesh kanë? Ju gënjen administrata. Bëni një rifreskim të administratës, sepse i keni marr me nepotizëm. Edhe një zonjë që kishim në Ministrinë e Shëndetësisë, zonjën Kospiri, edhe atë e hoqët. Jo, vëllezër dhe motra, ndoshta flas i revoltuar, ju kërkoj ndjesë, por janë të sinqerta dhe vijnë direkt nga burimi që është.

Në lidhje, zonja kryetare, me Komisionin e Ekonomisë, që nga viti 2002 ne nuk kemi qenë të përjashtuar nga taksat vendore. Në bazë të ligjit nr. 9632, edhe kur e kanë miratuar në vitin 2018, përjashtuan pensionistët, nesër i mbushet mendja babës tim dhe vjen tek mua. Si ti them unë që nuk përjashtohet invalidi, që ka 78 mijë lekë dhe përjashtohet babi im që, shyqyr Zotit, e ka 200 mijë lekë? Çfarë bën Ministria e Ekonomisë? Në qoftë se themi në nenin 6 (unë kam qenë pjesëtar në hartimin atij ligji, se kishte rregulla të tjera atëherë): “Përjashtohen nga taksat vendore të gjithë subjektet shprehimisht me këtë ligj dhe me ligje të veçanta.”, me ligje të veçanta jemi ne, janë të verbrit dhe paraplegjikët. Si mund t’i vendosësh taksën e banesës? Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 499 për legalizimin qeveria të fal kalin, pushteti vendor kërkon para për samarin dhe thotë se duhet ta paguash taksën e truallit. Çfarë bëhet këtu; ku jemi; çfarë bëjmë? Na dëgjoni vetëm një herë, sepse keni për ta realizuar planin tuaj. Një ditë takova një ish-President në rrugë;

nuk po ia them emrin. I thashë si ka mundësi që ti del pa shoqërues, se kolegët e tu nuk i shikon njeri? E besoni se çfarë përgjigjeje më dha, por ai ishte një.

Ju falënderoj dhe ju kërkoj ndjesë për tonin, por, duke na ikur njëra këmbë, kemi zë shumë!  
Uroj që të mos keni fatin tonë dhe, sa të keni mundësi, të shikoni alternativat tona!

Faleminderit!

Kush ka pyetje, jam gati të përgjigjem.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Përfaqësuesi i Shoqatës së të Verbërve.

Urdhëroni, zoti Smaka.

**Gjergj Smaka** – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar anëtarë të komisionit, faleminderit për ftesën dhe për mundësinë që na jepni për të shprehur shqetësimet, opinionet dhe sugjerimet tona pranë komisionit!

Tashmë prej shumë vjetësh që nga viti 2014 e në vazhdim ka pasur një mungesë të financimit të shërbimeve speciale për qytetarët e verbër nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Rehabilitimit të të Verbërve, e cila është qendra e vetme e ndërtuar me mbështetjen e shtetit apo e bazuar edhe në ligjin nr. 8098 “Për statusin e të verbërve” dhe në VKM-në nr. 277, që është bërë posaçërisht në zbatim të këtij ligji, ku shteti mbështet dhe financon ndërtimin e qendrave rehabilituese për qytetarët e verbër dhe ia lë në administrim Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë. Për 10 vjet kjo është financuar nëpërmjet VKM-së nr. 643/2004 dhe kjo qendër ofronte shërbime për këtë kategori. Më pas kjo VKM nuk u rinovua më dhe këto shërbime automatikisht u ndërprejnë, ngelëm vetëm në disa shërbime modeste që shoqata arrin t’i ofrojë nëpërmjet financave të saj modeste. Gjithashtu, këto shërbime kaluan te bashkitë që, fatkeqësisht, nga viti 2016 e këtej asnjë bashki nuk ka ofruar asnjë lloj shërbimi për qytetarët e verbër në të gjithë Republikën e Shqipërisë, as nuk kanë pasur të parashikuara në projektbuxhetet e tyre shërbime që t’ia ofrojnë kësaj kategorie, duke ditur që kjo kategori ka nevojë për shërbime speciale të veçanta, të cilat kanë kosto të ndryshme, kanë përgatitjen teknike dhe gjërat e tjera që janë specifike, që duan kosto shumë të larta për t’u ofruar nga bashkitë. Ndërkohë, qendra është e ndërtuar, por fatkeqësisht nuk finanohet për ofrimin këtyre e shërbimeve.

Gjithashtu, nga viti 2009 e në vazhdim nuk është bërë asnjë rritje e pagesave për shkak të verbërisë. Ka ndodhur vetëm indeksimi vit pas viti, ku në disa raste ka pasur jo indeksim të plotë ose mospërfshirje në skemën e indeksimit, por rritje të kësaj pagese në asnjë vit nuk ka pasur,

duke bërë të mundur vështirësimin e barrierave që u shkaktohen kësaj kategorie. Sigurisht, do të ishte mirë që të parashikohej një rritje e kësaj pagese për këtë kategori. Gjithashtu, një problem që vazhdon të jetë, i cili nuk është se ka gjetur zgjidhje, është përmendur vit pas viti, u përmend edhe nga zoti Omuri, është pjesa e detyrimeve të prapambetura për shkak të keqlllogaritjes dhe mosmarrjes së tyre në kohë. Pra, bëhet fjalë për periudhën 2005-2010. Është një borxh që shteti shqiptar, qeveria aktuale e ka njohur kur ka ardhur në pushtet për personat me aftësi të kufizuara; erdhi me premtimin që këto pagesa do të jepeshin, por të gjithë janë detyruar të shkojnë në rrugë gjyqësore dhe, fatkeqësisht edhe pse shumë gjyqe janë fituar, përsëri ka pasur probleme, sepse këto vendime gjyqësore nuk zbatohen për shkak të mospërfshirjes së këtyre detyrimeve që dalin nga këto vendime gjyqësore në buxhetin e ministrisë së linjës dhe në buxhetin e bashkive pastaj. Gjithashtu, u përmend pjesa e financimit të shoqatave të zëri 40 i buxhetit, ku është e parashikuar financimi i shoqatave dhe janë përfshirë Shoqatave të Verbërve, Shoqata e Invalidëve të Punës dhe Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve. Vitin aktual pati një zbritje të këtij financimi, duke u përfshirë edhe një shoqatë tjetër, duke marrë nga fondi që këto organizata merrnin, u përpjesëtua sërish dhe na u zbrit ky fond, duke zbritur në 13 milionë e 300 mijë lekë, gjë vazhdon t'i rrisë vështirësitë për ecurinë dhe punën që organizatat tona bëjnë në shërbim të qytetarëve me aftësi të kufizuara, konkretisht në shërbim të qytetarëve të verbër duhet rishikuar dhe duhet parë mirë. Ky financim duhet të vazhdonte të rritej për organizatat tona dhe jo të kishte një regres, por duhet parë mirë pjesa e përzgjedhjes së organizatave, sepse në këtë lloj mënyre krijohet edhe precedenti që shumë organizata të tjera të kërkojnë qoftë shërbime ose jo, janë në interes të qytetarëve me aftësi të kufizuara ose jo të kërkojnë financim nga shteti dhe si pasojë ky fond që ne e marrim, por do të vazhdojë duke u ulur, sepse zëri nuk ka pasur parashikim në rritje të financimit të organizatave për personat me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu ka disa vite, të paktën 2-3 vjet, që qytetarët e verbër nuk janë përfshirë në skemën e një pakete ndihmëse ose shpërblyese që u jepet invalidëve ose pensionistëve që e marrin për festat e fundviti. Është një shumë modeste që këto familje për shumë vjet kanë marrë, por ka disa vite që nuk është parashikuar më dhe urojmë që këto familje të përfshiheshin në këtë skemë për të marrë shpërblim për festat e fundviti.

Faleminderit!

**Albana Vokshi-** Faleminderit!

**Emanuela Zaimi-** Faleminderit!



Mirëdita!

Ne i kemi të përmbledhura të dyja bashkë, edhe çështjen shëndetësore, edhe çështjen sociale.

E nisim te buxheti. Në projektbuxhetin afatmesëm 2022-2024, si dhe në projektbuxhetin e propozuar për vitin 2022 vihet re një reduktim i buxhetit total për objektivin përkujdesje sociale. Kundrejt periudha të mëparshme projektbuxheti i afatmesëm parashikon një reduktim të shpenzimeve për kujdesin social për vitin 2022 krahasuar me buxhetin e vitit 2021, nga 28 miliardë lekë në 25,3 miliardë lekë, pra, me një shkurtim prej 9,6%.

Në projektbuxhetin e vitit 2022, qeveria ka bërë një rishikim në rritje të shpenzimeve në total për Ministrinë e Shëndetësisë, përfshirë edhe shpenzimet për kujdesin social, por pavarësisht kësaj, po të shikoni, buxheti i vitit 2022 në krahasim me 2021 planifikohet përsëri me 4% ulje. Pra, ne shikojmë që jo vetëm që ky grup nuk ka marrë vëmendje dhe nuk përbën asnjë prioritet për qeverinë shqiptare, por duket sikur do të ketë reduktim të mëtejshëm të shërbimeve sociale dhe shëndetësore që ofrohen për personat në nevojë sipas përfitimeve të paraqitura edhe në projektbuxhet.

Nga raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2021, 4 mujori i parë, vëmë re se ka pasur një shkurtim të buxhetit të planifikuar për personat me aftësi të kufizuara për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, prej 6%, përkundrajt rritjes prej 31% të skemës për personat në ndihmë ekonomike. Pyetja që shtrojmë është: për vitin 2022 sa është planifikuar saktësisht buxheti për personat me aftësi të kufizuara, sepse është i bashkuar dhe nuk arrijmë të dallojmë specifikisht për personat me aftësi të kufizuara?

Çfarë masash kontribute konkrete janë përfshirë në planifikim? Nga të dhënat e raportuara në buxhetin e viti 2022, gjejmë buxheti në total për përkujdesin social dhe jo për secilën skemë veçmas. Ky informacion i detajuar do të na ndihmonte të kuptonim më shumë dhe të adresojmë më saktë shqetësimet tona.

Jemi në pandemi dhe familjarët në ndihmë ekonomike u mbështeten me një skemë financiare nga shteti shqiptar dhe ne e konsiderojmë diskriminim që personat me aftësi të kufizuara nuk morëm asnjë paketë financiare. Ne kemi dërguar kërkesë edhe pranë ministrive dhe pranë qeverisë për të marrë në konsideratë që të mund të jepni ndihmë ekonomike, të paktën të merret një vlerë e barasvlershme me atë që është pagesa e aftësisë së kufizuar në muaj. Kemi çuar kërkesë

, por nuk kemi marrë përgjigje, kemi bërë një peticion online dhe do të vazhdojmë ta kanalizojmë, por do të doja që ky komision të merrte parasysh këtë kërkesë.

**Albana Vokshi-** Pas jush kemi përfaqësuesit e ministrisë dhe dua t'ju lutem që të japin një përgjigje për komisionin, në mënyrë që kur ta diskutojmë nën për nën të dimë. Këtë do t'ju përcjellim edhe juve si informacion.

Nëse keni një përgjigje tani për Ermonelën, sesi është buxheti, mund ta jepni.

**Denada Seferi-** Përshëndetje të gjithëve dhe shumë faleminderit!

Buxheti për personat me aftësi të kufizuara sot që flasim , i përcaktuar në projektbuxhet është 16,790 milionë lekë, i cili është i ndarë nga ajo shuma e madhe e programit të mbrojtjes sociale. Besoj se kjo është shuma që përcakton të gjitha pagesat e aftësisë së kufizuar.

**Ermonela Zaimi-** Në Shqipëri jetojnë 70636 persona me aftësi të kufizuara, pa llogaritur edhe 73920 ata që kategorizohen në invalidë pune. Shteti ynë ofron shërbime vetëm për 452 persona në shërbim kujdes social në qendra rezidenciale dhe për 1075 përfitues të qendrave të kujdesit social. Në total, nga 70 000 plus 73000 invalidë pune, vetëm rreth 15027 persona në Republikën e Shqipërisë kanë akses në shërbime. Kjo është shumë alarmante.

Ndërkohë, buxheti dhe shifra që jep Denada, zëvendësministrja, kur zbërthehen janë: 95% pagesë kesh aftësisë..

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, 100% por sa buxhet keni për të ofruar për shërbime?! Domethënë, është një gjë e papërfillshme. Unë këtu po kaloj te propozimi ynë për këtë komision dhe për ju e për të gjithë. unë mendoj që në pamundësinë e shtetit shqiptar për të ngritur shërbime të reja, ku nuk shikojmë asnjë lloj investimi, është koha që të fusim në skemë të rimbursimeve shërbimet. Pra., le t'i ofrojmë ne dhe të tjerë dhe shteti shqiptar të arrijë të rimbursojë të fusë në skemë shërbime jo 100%, por, të paktën, 50%. Cili është problemi që ne kemi që në vitin 2016, që kemi ligjin e shërbimeve sociale?! Ende nuk kemi koston e shërbimeve. Ne nuk e dimë sa na kushtojnë shërbimet. Në treg kemi çmime nga 1000 lekë deri 1500 lekë, pra, 10 mijë apo 15 mijë lekë orë terapeutike, dhe sinqerisht mendoj se ky është një çmim, sepse jemi në një ekonomi shumë informale, ku kostot dhe stafet nuk deklarohen ashtu siç janë. Në organizatën tonë neve nuk na del ky çmim, pavarësisht se edhe ne këtë mbajmë dhe mbulojmë kategoritë e tjera. Pra, të vendosim për çmimin e shërbimeve sipas llojeve të shërbimeve që kemi në ligj. Ne nuk kemi asnjë informacion se çfarë po ndodhë në këtë drejtim. Prandaj, ju lutem të shkojmë në një konsiderim të futjes në një skemë

rimbursimi, siç e kanë shumë vende të tjera të botës, nuk po themi për 10 orë terapi në javë, por, të paktën, 1-2 orë terapi fizike, logopedi, që futen në shërbime shëndetësore, të mund të ishte e parashikuar. Ne do të donim që këtë ta konsideroni.

Në një komunikim të mëhershëm kemi planin e veprimit të personave me aftësi të kufizuara për 5 vjecarin e ardhshëm, duke filluar nga vitet 2021. Ne kemi çuar kërkesë për informacion dhe shpjegime se pse është shkurtuar buxheti për këtë plan veprimi strategjik, krahasuar me planin e mëparshëm, konkretisht: buxheti për kujdesin social është reduktuar me 34%, për kujdes shëndetësor me 52% dhe arsimit me 56%, që ndoshta nuk është pjesë e juaj sot. Ne nuk kemi marrë asnjë lloj përgjigjeje pe kanë ardhur këto reduktime. Ndërkohë dua të theksoj se ky plan veprimi për 5 vjetët e ardhshme, po ta shikoni në realizime, është thjeshtë hajdeni ta provojmë edhe në 5 vjecarin e ardhshëm a do t'i bëjmë dot ato që nuk bëjmë dot në 5-vjecarin e kaluar. Pra, nuk ka objektiva dhe synime të reja që mund të kenë plotësuar të vjetrat.

Pyetja lidhur me buxhetin është: si mund ta vlerësojmë përfshirjen e masave të propozuara në planin e veprimit për personat me aftësi të kufizuara, konkretisht në projektbuxhetet afatmesme dhe për vitin 2022? Si mund t'i lidhim këto dy dokumente që të kuptojmë si janë shifrat me planifikimet?

E thashë edhe një herë që Shqipëria mbulon me shpenzime më pak se 1% të personave me aftësi të kufizuara dhe nuk shikojmë asnjë lloj investimi për ngritjen e shërbimeve. 955 e buxhetit është për pagesat kesh dhe vetëm 5% për shërbime. Propozimin për një pagesë në kuadër të COVID 19 jua bëmë, propozimin për të futur në skemat e rimbursimit shërbimet jua bëmë, por kemi edhe një pyetje. Nga monitorimi i shpenzimeve për 4-mujorin e viti 2021 raportohet që nuk është realizuar asnjë kontroll për analiza e kariotipit për foshnjat suspekt trizomim 21. Para disa vitesh ne kemi arritur këtu një gjë pozitive me ju, si komision, dhe më tej analiza e kariotipit për foshnjat suspekt trizomim 21 duhet të bëhej në shtet dhe ka në buxhet një fond që tashmë rimburohet nga qeveria shqiptare, por duket që nuk është shpenzuar asnjë lekë nga ky fond dhe nuk e dimë se çfarë po ndodh.

Dua të ngre shqetësim se nga një komunikim që kemi me QSUT-në kemi informacion, informacion i muajit korrik, se qendra e diagnostikës molekulare dhe kërkimeve gjenetike në spitalin obstetrik gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" nuk funksionon që prej vitit 2020. Prandaj, ne duam të dimë pse dhe çfarë masash marren dhe sa gjenetistë ka Shqipëria?

Një gjë që kemi kërkuar, e kemi lobuar dhe e kemi pranuar edhe ne, si organizatë, është skema e re e vlerësimit sipas modelit ICF. Ne nuk po marrim vesh se çfarë po ndodh me këtë model vlerësimi. Për të gjithë ju që ndoshta nuk e dinë, uroj ta dini, ishte ideja që të vlerësohemi në këtë mënyrë dhe të orientohe mi drejt shërbimeve. Ne fonacion, ku ne kemi 45 fëmijë, që ndoshta jo të gjithë janë vlerësuar në bazë të kësaj skeme, asnjë nuk ka gjetur shërbim diku tjetër përveç se te ne. Nuk e dimë se çfarë po ndodh dhe si po koordinohet orientimi në shërbime.

Shqetësim tjetër është që kishte një pilotim dhe kurrë nuk doli rezultati i pilotimit, ndërkohë që skema është shtrirë në të gjithë Shqipërinë. A mund ta dimë nëse ju jeni të kënaqur me pilotimin, sepse ne po na rezulton që shumë procedura nuk janë në rregull, shumë mjekë, apo ky komision, nuk është i trajnuar deri në nivelin e duhur, procedura komunikimi sesi duhet bërë, sapo e kam kaluar vetë me fëmijën tim, dhe nuk jam as vetë e qartë, jo më të orientojmë të gjithë komunitetin. Ne kemi bërë një luftë që të komisionohen edhe fëmijë 0-2 vjeç, sepse mbeteshin pa komisionin, pa pagesë të aftësisë së kufizuar dhe as shërbime, formularët shpërndahen si formularë për vlerësimin mbi dy vjeç. Këtu kemi hasur përsëri çështje komunikimi për fëmijët nën dy vjeç me Sindromën Down që janë drejtuar në vendet e gabuara dhe nuk kanë arritur të vlerësohen, sepse u kanë thënë që nuk ju takon të vlerësoheni. Si po e monitorojmë reformën? Si po shkojmë drejt shërbimeve? Ku janë të buxhetuara këto shërbime? Sepse supozohet që këto ishin fëmijë që nuk merrnin shërbime, ose persona më aftësi të kufizuar, jo vetëm fëmijë. Pra, nuk jemi të qartë nëse jemi në rrugën e mbarë për vlerësimin që po funksionon në reforma, i cili ishte e kërkuar dhe e pranuar edhe nga ne. Pra, nga të thënë në të bërit korrekt duhet të jemi në vëzhgim dhe monitorim që të kuptojmë më shumë.

Faleminderit!

**Albana Vokshi-** Faleminderit!

Unë e kam informacionin që na keni dërguar, edhe të detajuar.

Ne kemi një problem. Ne jemi komisioni për Shëndetësinë dhe këtu kemi një mbingarkesë njerëzish dhe jam e sigurt që mund të kemi edhe mbingarkesë COVID-i dhe, nëse jeni dakord, më duhet të vë një minuatzh të caktuar, sepse jemi shumë. Prandaj, më duhet të vë një minutazh jo më shumë se 5 minuta dhe pyetjet që janë bërë deri tani ministria, Denada, nëse keni mundësi, mund të vini këtu dhe t'u jepni përgjigje për pyetjet që u parashtruan deri tani dhe përfaqësuesit e shoqatave, nëse i marrin përgjigjet mund të largohen, në mënyrë që të mos rrinë në këtë ambient,

i cili mund të jetë edhe i kovidizuar. Kështu që ju lutem, zonja zëvendësministre, ne po japim shembullin më të keq si komision...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk kam mbaruar akoma. Po ia kaloj fjalën avokatit, pastaj juve, pastaj te përgjigjet, në mënyrë që ata që kanë marrë përgjigje mund të largohen. Nëse kanë përgjigje për të na kthyer i dëgjojmë, në të kundërt, u kërkojmë zyrtarisht dhe të na i kthejnë shpejt përgjigjet për diskutimin e buxhetit nen për nen.

**Sinan Tafaj-** Shumë faleminderit për mundësinë që më jepni të flas para jush, ndihem i nderuar dhe i kënaqur!

E nderuara zonja kryetare,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Çështjet që do të parashtror sot janë parashtruar, ose të paktën e para çështje ka 7 vjet që e parashtrorjmë në çdo mbledhje të Komisionin të Çështjeve Sociale. Tashmë situata është agravuar dhe kërkon një qëndrim e një zgjidhje. Bëhet fjalë për disa detyrime të prapambetura që shteti shqiptar duhet t'i kishte shlyer vullnetarisht, të paktën deklarimet kështu ka qenë. Tashmë jemi përballë një fakti tjetër, meqenëse shteti nuk i shleu detyrimet vullnetarisht, ata janë fituar në rrugë gjyqësore të disa prej tyre, megjithëse ajo e drejtë u takon mbi 100 mijë personave, janë 3-4 mijë vetë që i kanë fituar këto gjyqe dhe kanë çështje të fituara dhe të pa ekzekutuara që nga viti 2011. Sot kjo shifër është rritur dhe në vitet e fundit vazhdimisht Komisioni i Çështjeve Sociale i ka kërkuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave që të planifikojë fondet për shlyerjen e këtyre detyrimeve. Ku qëndron problemi?! Problemi qëndron se gjykata administrative merr si përgjegjës kryesor së pari atë që ekzekuton pagesat, që janë bashkitë. Në fakt, bashkitë janë formalisht fajtoare, sepse realisht fajtoare është ministria përgjegjëse, pasi këto janë fonde që dalin nga buxheti i shtetit dhe nuk mundet bashkitë të paguajnë ato lloj detyrimesh që janë jashtë mundësive të tyre.

Më sa di unë, Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale për herë të parë sivjet i ka kërkuar Ministrisë së Financave që të planifikojë rreth 200 milionë lekë për të shlyer disa detyrime, por këto nuk janë as gjysma e këtyre detyrimeve. Megjithatë, të paktën, është një hap i mbarë dhe shpresoj që këtë shifër ky komision do ta rrisë, në mënyrë që të mund të fillojmë t'i shlyejmë këto detyrime. Vetëm në qarkun e Dibrës janë rreth 90 milionë lekë që duhen shlyer për shkak të vendimeve gjyqësore. Unë ju lutem juve që të ndërhyni, t'i detyroni këto dy ministri që të merren

vesh me njëra-tjetrën , t'i planifikojmë fondet dhe të mos na shtyni që të shkojmë që këto para t'i kërkojmë edhe ne në Strasburg. Nuk do ta doja kurrë këtë gjë, por shpresoj që të kem mbështetjen dhe dashamirësinë tuaj, pasi ne e dimë që cilido deputet që është këtu është pro nesh dhe s'ka asnjë kundër nesh dhe kërkesave tona.

Çështja e dytë që dua të parashtroj është ajo që u ngrit edhe nga parafolësit, që kemi që nga viti 2009 që pagesat tona janë stopuar për shkak se u ndërpre indeksimi i i pagave minimale dhe u la që të indeksohet vetëm inflacioni. Ju e dini të gjithë se çfarë do të thotë indeksim i inflacionit. Indeksim i inflacionit do të thotë që të ruash atë vlerë që ke, por jo të shtosh.

Çështja e tretë që e kam nisur me shkrim, është çështja e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njerëzve me aftësi të kufizuara, mbrojtja nga cenimi i dinjitetit dhe personalitetit të tyre. Unë ju kam vënë në dispozicion të gjithëve në emailët tuaja raportin e Kombeve të Bashkuara mbi implantimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe, njëkohësisht, shqetësimet që ekzistojnë. Për këtë unë dua t'ju lutem që të mund të na planifikoni një seancë të veçantë për të diskutuar me ju që ne të vijmë të përgatitur në mënyrë koncize, por edhe ju të keni mundësi të na dëgjoni, sepse sot jeni shumë të lodhur dhe nuk dua t'ju ngarkoj.

Së fundi, është çështja e shërbimeve, që e ngriti parafolësja, janë shumë të drejta, por brenda këtij shërbimi janë përjashtuar të verbrit që nga viti 2014. Mos harroni që Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë ka arritur të ngrejë një qendër rehabilitimi me një kapacitet të jashtëzakonshëm. Ka ngritur një qendër më një sipërfaqe 6500 metra katrorë, me dy kat hotel me 120 shtretër, me 23 salla dhe klasa mësimi, me një kapacitet mense, restoranti dhe kuzhine për 200 persona, ku vetëm pajisjet e përfshira, ato specialet, siç janë printera specialë, kompjuterë e të tjera, rreth 2 milionë euro, të gjitha të financuara nga organizatat tona perëndimore të të verbërve dhe Komisioni Europian. Kështu që ka që në vitin 2014 që ky lloj financimi është ndërprerë. Unë dua t'ju lutem ju dhe përfaqësuesve të ministrisë ta marrin në konsideratë, ta rivënë në aktivitet këtë qendër, sepse është vërtet gjynah që një kapacitet kaq i jashtëzakonshëm në këtë mungesë kaq të madhe shërbimesh të shembet, të bjerë brenda apo shoqata t'i ndryshojë drejtimin dhe pastaj të vendosë në dispozicion të bizneseve, duke hequr dorë.

Ju falënderoj sërish që më dëgjuat, por dua t'i përsëris edhe një herë dy kërkesat.

Së pari, mos na detyroni të shkojmë në Strasburg dhe, së dyti, ju lutem, mbajeni në konsideratë kërkesën për t'u mbledhur një herë për të na dëgjuar lidhur me problemet themelore

të lirive dhe të të drejtave të njeriut, sepse vërtet ka shkelje të papranueshme, të pranuar në raportin e Kombeve të Bashkuara.

Ju faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, avokat!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kishit ju dy gjëra, shkurt, për të folur? Pastaj po ia kaloj fjalën zëvendësministres dhe Denadës të japin përgjigje dhe ata që marrin përgjigje, të largohen.

**Ilda Pisha** – Në rregull.

Përshëndetje!

Faleminderit për ftesën!

Do të përmend dy propozime të shkurtra, që vijnë nga prindërit e fëmijëve me aftësi ndryshe.

E para, mundësimi i transportit të veçantë për këta fëmijë, duke u nisur nga nevoja specifike që mund të ketë secili fëmijë.

E dyta, rritja e ndihmës financiare për fëmijët dhe kujdestarët e tyre, meqenëse edhe produktet e konsumit të përditshëm kanë hasur një rritje të lehtë dhe, me sa di unë, shuma e kempeve që mund të marrin fëmijët dhe kujdestarët është po e njëjta.

Mundësimi i shërbimit stomatologjik për fëmijët me aftësi ndryshe, me doktorë dhe stomatologë të specializuar dhe aparatura të veçanta.

Me sa kam informacion, në Shqipëri nuk ka mjek apo dentist të specializuar për fëmijët me aftësi ndryshe, konkretisht të spektrit të autizmit, duke marrë parasysh edhe nevojën që ka secili fëmijë. Është shumë e vështirë të menaxhosh një fëmijë me autizëm, ta marrësh e ta çosh te dentisti.

E treta, por jo më pak e rëndësishme, është trajnimi i mësuesve ndihmës, kualifikimi i tyre dhe jo vetëm i tyre, por edhe mësuesit e përgjithshëm duhet të kenë një trajnim dhe kualifikim që, në momentin kur hasen me një fëmijë autik, të dinë se si të veprojnë dhe ta menaxhojnë situatën.

Këto ishin shkurtimisht.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Super!

Kështu na duhen diskutimet që të jenë direkt në çështje dhe në problematika.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, mund ta merrni fjalën që të mos shpërndahemi.

Atëherë, të lutem, zëvendësministre, përgjigjet me radhë. Besoj se i keni mbajtur shënim përgjigjet për zotën Ismailaj dhe pastaj për Emanuelën e të tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nëse ke ti, ia kalojmë Denadës dhe bëjmë pak qarkullim.

**Mira Rakacolli** – Faleminderit!

Unë po e filloj me përgjigjen për zotën Ndreka. Më vjen shumë mirë që e dëgjoj edhe të ngritur këtu si problem, sepse janë vërtet probleme që deri tani kanë qenë të munguara në shëndetësi, flas për ato të anës shëndetësore, por më vjen edhe mirë që t'ia them edhe drejtpërsëdrejti që ato probleme që ka ngritur nuk kanë rënë në vesh të shurdhër në Ministrinë e Shëndetësisë, sepse jo vetëm nga grupet e interesit, por edhe nga vlerësimi i ekipeve që merren me drejtimet e zhvillimit të shëndetësisë, tashmë po gjenden të reflektuara.

Nevoja e të shërbyerit në shtëpi jo vetëm të atyre qytetarëve që kanë probleme para ose tetraplegjike, po edhe me sëmundje të tjera, siç janë, për shembull, sëmundjet degjenerative dhe që e kanë të vështirë të ofrohen pranë qendrave shëndetësore, janë vlerësuar. Madje, megjithëse ishim në kohë Covid-i, në vitin 2019 kemi bërë strategjinë e re të sistemit shëndetësor parësor, që është aprovuar në qeveri në verën e vitit 2020, pra ne megjithëse punonim për pandeminë, punonim edhe për nevojat në dinamikë dhe në perspektivë të këtyre personave.

Tashmë qendrat shëndetësore nuk do të kenë vetëm formën e qendrave që ofrojnë vetëm shërbim shëndetësor, por do të kthehen në qendra socio-shëndetësore, ku, përveç shërbimit shëndetësor, do të ofrojnë edhe një shërbim social. Tashmë jemi në fazën e fillimit të aplikimit. Dhe ku jemi këtu? Do të vendosen punonjës socialë. Çdo qendër shëndetësore do të ketë punonjës socialë. I kemi thënë në programin e qeverisë, do të jenë 10 qendra të mjekësisë familjare të kompletuara që do të bëhen gjatë mandatit. Përveç punonjësit social do të kemi atë që me të drejtë ngriti zoti Ndreka, infermieren që do të shërbejë në banesë, pra atë që quajmë infermiere të komunitetit. Por kjo nuk mund të jetë një infermiere që ka formimin e zakonshëm infermieristik, ndaj për këtë arsye, për herë të parë, sivjet ka filluar në Fakultetin e Infermierisë masteri për infermierinë e komunitetit. Pra, do të jenë infermiere të trajnuara për ato lloj shërbimesh që kanë nevojë këta njerëz.

Megjithatë, ne nuk do të presim sa të bëhen të gjitha këto gjëra. Kemi filluar një pilotim së bashku me projektin zviceran “Shëndet për të gjithë” në qendrat shëndetësore, si me disa qendra shëndetësore në Fier dhe në Dibër. Për shembull, në qendrën shëndetësore të Patosit ka filluar



mirofrimi i këtij shërbimi dhe ne po e ndjekim në dinamikë për të parë ku janë problemet dhe si mund t'i rikuperojmë më mirë.

Për sa i përket problemit të aksesueshmërisë, natyrisht është një problem shumë i rëndësishëm dhe zoti Ndreka e tha edhe vetë që të gjitha qendrat shëndetësore, pra të treqindta, të cilat janë rehabilituar gjatë këtyre viteve, janë të gjitha me akses për personat me aftësi të kufizuar. Njëkohësisht, po bëhen me akses edhe ato qendra shëndetësore, të cilat nuk janë ende të rehabilituara, por që e kanë në pikat që të quhen të akredituara, sepse të gjitha qendrat shëndetësore po kalojnë në proces akreditimi. Që të marrësh akreditimin, një nga kërkesat është edhe se sa e sigurojnë ato aksesin për këtë lloj kategorie qytetarësh. Pra, është një gjë që ministria e ka pasur në vëmendje.

Problemi tjetër ishte rimbursimi i medikamenteve. Këtu ndoshta kemi një keqkuptim të vogël, sepse, me sa kuptova, zoti Ndreka tha që ne rimburohemi vetëm për ato medikamente që kanë të bëjnë me sëmundjet dhe ngriti me të drejtë problemin që këta të sëmurë vuajnë edhe nga sëmundje të tjera. Por për sëmundjet e tjera ato rimburohen, ashtu siç rimburohen edhe qytetarët e tjerë. Pra, nëse kanë infeksione urinare, për shembull, ose infeksione pulmonare, u rimburohen ato medikamente që u rimburohen të gjithë atyre që vuajnë nga këto edhe pa qenë pacientë me aftësi të kufizuar.

Domethënë, për sa u përket problemeve që mbajta unë shënim, që i ngriti zoti Ndreka, këto kishin të bënin me problemet shëndetësore.

*(Zoti Ismailaj flet pa mikrofon.)*

Keni shumë të drejtë.

**Ndreka Ismailaj** – Gati njëzet vjet kam shkuar në urgjencë. Nuk ka pasur as krevat për mua...

*(Zoti Ismailaj flet pa mikrofon.)*

Të thuash: “Po i bëj, po i bëj, po i bëj”, nuk mund t'i bësh në qoftë se nuk ke buxhet. Ti nuk ke planifikuar asnjë buxhet.

E fundit, sa do të presim që ato të bëhen, të paktën për një qendër rehabilitimi? Sa do të presim për karroca? Janë imediate. Nuk ka nevojë të dalë Ndreka këtu dhe të thotë çdo vit të njëjtat fjalë!

Jam shumë i mirë për të më parë, jam shumë i bukur, ama jam shumë i keq për të bërtitur. Por, të lutem, të paktën-të paktën, atë që e ka, thuaje këtë e ka, ta jap. Këtë nuk e ke...

**Albana Vokshi** – Ja, ta dëgjojmë zëvendësministren.

Ju lutem shkurt, zonja zëvendësministre, vetëm për pyetjet!

**Mira Rakacolli** – Vetëm me një fjali.

Për sa u përket gjërave që unë thashë, ato janë të buxhetuara. Pra, e them me përgjegjësi që janë të buxhetuara të gjitha ato që unë përmenda.

Në lidhje me problemin e Qendrës së Rehabilitimit, është shumë e drejtë. Më në detaje do të flasë zonja Seferi, sepse edhe kjo çështje është e buxhetuar dhe e parashikuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të vazhdoj me pyetjet e të shëndetësisë?

Ndër problemet e tjera që u ngritën në lidhje me shëndetësinë, edhe nga zonja Emanuela, ishte edhe ai i gjenetikës. Në lidhje me gjenetikën, besoj se jeni e informuar që, fatkeqësisht, nuk funksionon Qendra e Maternitetit për shkak të humbjes së jetës së mjekut gjenetist, zotit Grigor, për të cilin kemi pasur të gjithë respekt të jashtëzakonshëm dhe ai ka bërë një punë të lavdërueshme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për sa i përket ofrimit të gjenetikës, ajo ofrohet sot në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, ku është i ngritur si shërbim dhe ku ka mjekë gjenetistë të specializuar, ashtu sikurse ka edhe biologe, të cilat janë me doktoraturë në gjenetikë. Njëra prej tyre, në dijeninë time, është edhe e specializuar për biologjinë molekulare.

Ndonjë gjë tjetër për shëndetësinë deri tani nuk kam mbajtur shënim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** – Kishit diçka tjetër?

**Emanuela Zaimi** – Absolutisht që e di arsyen. Mund të vdesin të gjithë nesër, por duhet të jenë disa të tjerë që duhet t’i zëvendësojnë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë harrova të përmend diçka me shumë rëndësi, meqenëse jemi te shëndetësia. Kemi fituar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rastin e një pacienti, fëmije me sindromën Down, të prekur nga leucemia, i cili nuk ka arritur dot, ndërkohë që ishte i shtruar në spital, të merrte Methotrexate-in 50-miligramësh për flakon. Pra, nuk i është siguruar as në spital, nuk ishte as në medikamentet e rimbursueshme për ta rimbursuar më vonë.

Ka qenë familja dhe fondacioni ynë që kanë arritur të gjejnë një pjesë të shumës gati 4 milionë lekësh të vjetër shpenzime për këtë ilaç. Problemi qëndron te fakti që, me sa duket, bëhet një procedurë prokurimi për këtë ilaç dhe gjithmonë...

**Albana Vokshi** – E trajtuan. Është procedurë shumë e gjatë prokurimi dhe...

**Emanuela Zaimi** – Ne nuk na intereson prokurimi, na intereson të jetë...

**Albana Vokshi** – E di. Ke shumë të drejtë, Emanuelë.

**Emanuela Zaimi** – Dhe nuk është vetëm në rastin tonë, ngrihet si problem edhe nga familjarë të tjerë. Kjo mund të ishte shëndetësore në rastin tuaj.

**Albana Vokshi** – E trajtuan të gjithë shefat e shërbimeve. Kanë bërë një kërkesë në komision që në raste të tilla, që janë emergjente, të kapërcehen disa procedura.

E dimë se viktimat, në fund të fundit, janë fëmijët apo të rriturit, apo pacientët, por nuk e di se sa hapësirë... Ne të gjithë jemi të gatshëm që të ndihmojmë për aq kohë sa do të na... Domethënë, do të mundohemi që ta shtyjmë.

Fjalën e ka zonja Seferi. Ju lutem, shkurt, për pyetjet e...

E kam shumë të limituar, por pa u zgjatur...

**Tatjana Piro** – Rezymenë e tha të plotë, se çfarë dinte të bënte, çfarë ka bërë dhe çfarë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** – Do të përgjigjet.

*(Deputetja Piro flet pa mikrofon.)*

Tana, kishin disa pyetje për ministrinë.

Ju lutem, shumë shkurt, Denada. Na e dërgoni edhe me shkrim që t'ia dërgojmë gjithsecilit.

**Denada Seferi** – Në lidhje me çështjen e Qendrës së Rehabilitimit, po, këto janë të gjitha prioritetet për qendra rehabilitimi. Jemi në procese negociatash për ngritjen e 11 qendrave të rehabilitimit, të cilat do të përfshijnë shumë kategori dhe në të vërtetë me Bashkimin Europian po llobohet fort-fort për t'i ngritur, të cilat do të jenë për çdo kategori të mundshme.

Kështu që ne do të vazhdojmë të jemi në bisedime edhe me zotin Ismailaj dhe të gjithë përfaqësuesit e kategorive, në mënyrë që t'i kemi të përfshira në të gjitha proceset tona për të përmbyllur ngritjen e qendrave të rehabilitimit. Dhe, në fakt, është një nga prioritetet e qeverisë.

**Albana Vokshi** – Denada, një shqetësim, që unë e dëgjova tek të gjithë përfaqësuesit, ishte që nuk marrin përgjigje për kërkesat e tyre.

**Denada Seferi** – Për cilat?

**Albana Vokshi** – Të gjitha. Kërkesat e Ndrekes, kërkesat e invalidëve të punës...

**Denada Seferi** – Kërkesat e zotit Ndreke i nisa me qendrat e rehabilitimit.

**Albana Vokshi** – Flas për ato që jua bëjnë me shkrim, jo këto këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Denada Seferi** – Shkresat zyrtare?

**Albana Vokshi** – Jo, jo, nuk duhet t'ju thërrasim ne këtu që ju të flisni me njëri-tjetrin ndër muaj, ndër vite.

**Denada Seferi** – Unë kam...

**Albana Vokshi** – Pse nuk marrin përgjigje?

**Denada Seferi** – Unë këtë nuk e di dhe nuk mund ta shpreh sot këtu në komision përse nuk marrin përgjigje, por kam përshtypjen që zakonisht përgjigjet merren nga institucionet ku i çojnë. Nëse kanë probleme me çështjet e buxhetimit, shkojnë te Ministria e Financave. Nëse kanë probleme me politikat sociale, ato adresohen te ne. Ndoshta ka një problematikë tjetër, domethënë, që nuk kthehet përgjigje nga Ministria e Financave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Plani i veprimit është lider.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përpiqet të gjejë, domethënë, maksimumin e buxhetimit për sa u përket personave me aftësi të kufizuar në të gjitha çështjet që mbulon plani ndersektorial, në fakt.

Unë kam edhe të dhëna, të cilat mund t'jua dërgoj me shkrim, se sa e përfshin e gjithë pjesa e strategjisë së përfshirjes sociale pjesën e planit kombëtar të veprimit të PAK-ut, i cili është rinovuar me sa di unë kohët e fundit dhe është riparë, madje është edhe në konsultim me publikun me të gjitha shoqatat...

Po, po, ka mbaruar dhe ju keni qenë të gjithë të përfshirë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po pra, por është plani i ri.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Shërbimet psikosociale i përmendi doktoresha. Unë do të vazhdoj me çështjen e Shoqatës së Invalidëve të Punës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kur të arrij? Po i marr me radhë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ato shifrat nuk janë tonat. Nuk janë tabelat tona buxhetore.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk janë të planifikimit. Kështu që ato do t'i shikojmë pak më vonë edhe me Drejtorinë e Buxhetit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Çështja e shumës shtesë prej 500 lekësh, që u është mohuar invalidëve të punës, është një pjesë e cila u përket sigurimeve shoqërore dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Kemi gjithmonë një korespondencë të vazhdueshme, duke thënë që ata do ta marrin këtë pagesë shtesë. Por kaq është tagri i ministrisë sonë.

Është çështje e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila e adreson pikërisht këtë gjë, por të mos harrojmë që kemi pasur dy vjet të vështirë, për të cilat edhe shtesat e buxhetit janë adresuar diku tjetër dhe nuk kanë qenë pjesë e saj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për sa i përket 10-mijëlekëshit shtesë në muaj, kjo është një pjesë e prioritetëve të Ministrisë për të rritur ndihmën, e cila...

Duhet ta shpjegojmë mirë, zoti Abdulla. Është një pagesë e cila jepet në ndihmë të invalidëve të punës. Pra, ata kanë pensionin e invaliditetit dhe kjo është një pjesë e programit të mbrojtjes sociale. Sepse u fol edhe për indeksimin e saj, i cili bëhet nga Sigurimet Shoqërore dhe është pjesë e kësaj skeme. Por njëkohësisht pjesa jonë, që është shtesë e mbrojtjes sociale, është një pjesë e cila nuk indeksohet. Indeksohet pensioni i invaliditetit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sepse ka një parim buxhetor, financiar: i njëjti përfitim merret nga i njëjti buxhet. Pra, indeksimi bëhet për shtesën e invaliditetit në punë. Kjo është pjesa që indeksohet.

Nuk po u futem më çështjeve të tjera, se i mbulon Ministria e Financave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Indeksimi...

**Abdulla Omuri** – Denada, të lutem.

Pikën e indeksimit e keni të indeksuar për të gjitha kategoritë e tjera, për veteranët, ndërsa këtu nuk e keni indeksuar. Ose kaloje buxhetin...

**Denada Seferi** – Ne nuk i kemi veteranët.

**Abdulla Omuri** – Të lutem, të mbaroj unë? Të dëgjova dhe pikë për pikë. Nuk do të flas më.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Çoje buxhetin e ndihmës së paaftësisë, që e merr Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, tek ISSH-ja dhe nuk flasim me ty.

**Denada Seferi** – Jo, nuk e dërgoj tek ISSH-ja.

**Abdulla Omuri** – Sepse te veteranët indeksohet ajo që jep shtesë, ndërsa për invalidët...

**Denada Seferi** – Nuk është pjesë jona.

**Abdulla Omuri** – Jotja është, se e ke indeksuar për të tjerët.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Denada Seferi** – Nuk është pjesa jonë.

Ama, vlen të përmendim që nga ky buxhet janë futur rreth 3000 invalidë të punës, që nuk kanë qenë të përfshirë më parë as nga legjislacioni, as pjesë e pagesave të paaftësisë. Pra, kemi një buxhet të shtuar pikërisht për këtë kategori. Pjesë e tyre janë edhe invalidët e punës.

Për çështjen e shoqatave, ajo adresohet te Ministria e Financave. Nuk vjen te ministria jonë që të kemi regjistrime të reja apo parashikime të reja.

Buxheti ynë parashikon të gjitha pagesat e mbrojtjes sociale.

Këto ishin pak a shumë rreth...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Abdulla Omuri** – Më falni, se ministria juaj më ka kthyer këtë përgjigje për Ministrinë e Financave.

**Denada Seferi** – Po, po, patjetër dhe unë e di që ju keni një korrespondencë dhe është Ministria e Financave, e cila për shoqatat dhe regjistrimin e tyre, vijon me procedurën e saj; është pjesë e buxheteve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Absolutisht, ministria jonë është pro pagesave që u bëhen aktualisht të gjitha shoqatave kombëtare, të cilat marrin të gjithë pjesën e shpenzimeve operative, siç janë Shoqata e Jetimëve të Shqipërisë, Shoqata e Invaliditetit, ajo e para dhe tetraplegjikëve e të tjera. Pra, është pjesë e një buxheti të madh, ku të gjithë kanë aksesin e tyre. Por në qoftë se do të regjistrohen shoqata të tjera, normalisht që kemi një prioritet në buxhet.

Për pjesën tjetër për Shoqatën e të Verbërve, e cila na adresoi disa problematika, po e nis me çështjen e shërbimeve. Qendra, e cila është rehabilituese për personat e verbër, është financiar

nga buxheti i shtetit për 10 vjet, për ngritjen dhe administrimin e këtij shërbimi. Ky ka qenë një shërbim i cili realisht ka funksionuar mirë, është ngritur dhe të gjithë personat e verbër kanë pasur aksesin e tyre dhe për 10 vjet qeveria ka dhënë mbështetjen e saj, pas së cilës pikërisht qendra ka pasur edhe kuotizacione, edhe tarifim të këtyre shërbimeve, për të cilat të gjithë personat e verbër kanë qenë pjesë e ngritjes së këtij shërbimi.

Pra, qëndrueshmëria e tij pas 10 vjetëve ndoshta ishte një pjesë e një qëndrueshmërie jo vetëm e shoqatave, por edhe e një politike të re, e cila mund të jetë pjesë sot që flasim me ngritjen e Fondit Social, po kështu edhe me ngritjen e fondit të posaçëm, siç është edhe ai i ndërmarrjeve sociale.

Pra, sot ka akses dhe mundësi të tjera për të vijuar me këto shërbime, por qendra është ngritur me një vendim të Këshillit të Ministrave, i cili ishte për ngritjen dhe administrimin, dhe e ka mbyllur funksionin e saj.

Absolutisht, pjesë e të gjitha buxhetimeve të tjera për Fondin Social, për shërbimet sociale të cilat mund të aksesohen shumë mirë edhe nëpërmjet bashkive, edhe nëpërmjet qarqeve.

**Albana Vokshi** – Pra, këtë duhet ta bëjnë vetë shoqatat?

**Denada Seferi** – Jo, është një shërbim i ngritur, një shërbim 10 vjet i mbështetur, është një shërbim tashmë...

**Albana Vokshi** – Po tani pas 10 vjetësh çfarë i thoni ju?

**Denada Seferi** – ...i aksesueshëm nga të gjithë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ne themi që kemi një Fond Social, të cilin e kemi të dedikuar për shërbimet sociale. Në momentin kur këto shërbime mund të aksesohen në Fondin Social, ne jemi të hapur të shikojmë gjithçka që adresohet për një politikë më të mirë në favor të personave me aftësi të kufizuara. Dhe, në fakt, këtu nuk u përmend në asnjë moment që ky ligj i shërbimeve shoqërore ka ngritur Fondin Social...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fondi social është 200 milionë lekë, Emanuela, është i përcaktuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** – Një sekondë!

Vetëm një fjali, të lutem.

**Ardian Hysa** – Po, shkurtimisht.

Për sa i përket qendrës, për të cilën ju thatë se është financuar nga shteti për 10 vjet dhe më pas u supozua që këto shërbime të ngriheshin, të vazhdonin të ofroheshin nga shoqatat, faktikisht në VKM nuk është e parashikuar një gjë e tillë. Edhe në shkresat që shoqata ka pasur korrespondencë me ministrinë tuaj, nuk është pretenduar asnjëherë që shoqata të shikojë fondin social ose gjëra të tilla që të ofrojë këto shërbime.

Preteksti i vetëm ka qenë që këto shërbime kanë kaluar te bashkitë, ndërkohë që nuk ka asnjë bashki që të ofrojë shërbime për të verbrit ose të ketë fonde që të mbështesë të verbrit me këto shërbime.

Dihet qoftë nga ministria, qoftë edhe nga shoqata dhe Qendra Kombëtare e Rehabilitimit të të Verbërve që ofrimi i shërbimeve speciale për të verbrit, si në të gjithë botën, duhet të jetë i qendëruar dhe më pas të shpërndahej, sepse kostot janë relativisht shumë të larta që këto të ofrohen nga bashkitë.

**Albana Vokshi** – Dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Denada, kam një pyetje: A është e mundur që qeveria, tani në këtë fazë që është, pas 10 vjetësh, të ndërmjetësojë, të ndërhyjë që Qendra të ketë vijueshmëri? Shoqatat nuk e bëjnë dot, nuk i kanë kapacitetet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Denada Seferi** – Shiko, ne kemi evoluar me politikën, nuk jemi më për t'i dhënë para vetëm një qendre të vetme. Jemi për t'u dhënë shumë qendrave dhe shumë kategorive të personave me aftësi të kufizuar. Për këtë arsye është ngritur Fondi Social. Dhe, absolutisht, të gjithë që kanë ngritur qendra rehabilitimi dhe qendra komunitare janë në bashkëpunim me bashkinë dhe në marrëveshje me ta për të ardhur dhe për të aksesuar Fondin Social.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Absolutisht, është i hapur dhe mund të ketë akses për të gjitha organizatat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk ka lidhje me projektin...

Emanuela, a mund të ta shpjegoj? Fondi social jepet për 3 vjet rresht, ku në vitin e parë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më fal tani! Nëse doni informacion, më dëgjoni, sepse është gjynah që ne të mos aksesojmë atë gjë, të cilën e ngremë si një mekanizëm pagese!



Ideja është se 90% të kërkesës së vlerës financiare e japim direkt në vitin e parë, në vitin e dytë jepet 60% e vlerës totale të projektit, ndërsa në vitin e tretë dhe për të gjitha vitet e tjera pafundësisht, jepet 30% e këtij buxheti. Pra, është një vendim i Këshillit të Ministrave, i cili e përcakton qartë këtë fond social, dhe tregon se nuk do i lërë vetë këta njerëz por i financon 90%, 60% dhe 30% deri në fund, derisa ky shërbim të mos ketë më nevojë për mbështetjen e qeverisë. Ky nuk është *project base*, sepse është një fond social i hapur për pushtetin vendor.

**Albana Vokshi** – Më fal, Denada!

Më duket shumë e çuditshme që shpjegohet fondi social këtu, në një mbledhje komisioni. A komunikoni ju me shoqatat? Pse duhet shpjeguar këtu fondi?

**Denada Seferi** – Zonja Afërdita Seiti ka marrë pjesë te ky fond, kështu që mund të dëshmojë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)*

**Emanuela Zaimi** – Pyetja imë është: me këtë buxhet për vitin 2022, me këtë buxhet deri në vitin 2024, deri në vitin 2030, po deshët, a mund të na thoni sa do të jetë numri i personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri që kanë dhe do të kenë akses në shërbime qoftë nga fondi social, qoftë nga ju, apo edhe nga ne, dhe që siguron një qëndrueshmëri? Janë 70 mijë persona, pa invalidët e punës, dhe vetëm 1527 marrin shërbime. Ku e keni të planifikuar në investime shërbimin? Ju thoni 11 qendra të reja.

Pse mbetemi gjithmonë në dorë të donatorëve? Ju t’i luteni BE-së, edhe ne nga ana tjetër BE-së, por nuk ka asnjëherë një investim serioz dhe bëni parashikim në buxhet me taksat e shqiptarëve.

Kjo është pyetja.

**Denada Seferi** – Sepse projektbuxheti ka disa prioritete. Projektbuxheti vjen pas dy vjetësh. Absolutisht që këto shërbime mund të aksesohen nga të gjithë ata që kanë nevojë. Në fakt, ky buxhet po parashikon një shumë të caktuar, e cila realisht do të shkojë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)*

Nuk mund të jap një numër, se sa kanë nevojë për aftësinë e kufizuar

**Albana Vokshi** - Buxheti bëhet mbi bazën e nevojave.

**Denada Seferi** – Unë mund t’ju jap...

**Albana Vokshi** - Si e ndërton buxhetin ti, nëse nuk e di sesa janë përfitues?

**Denada Seferi** – Po, 164 mijë persona janë pjesë e programit të mbrojtjes sociale dhe këta janë parashikuar në të gjithë buxhetin tonë. Për ata që me të drejtë flet Emanuela, do të jenë persona, që do të kenë nevojë të aksesojnë këto shërbime, dhe këto shërbime janë të ngritura në mënyrë të veçantë për personat me aftësi të kufizuar. Ne e kemi dhënë fondin social gjatë gjithë vitit 2021 dhe këto shërbime janë të aksesueshme nga 3500 persona, të cilët kanë marrë pjesë dhe janë përfitues të fondit të shërbimit social. Pra, është shumë e rëndësishme që ne të kemi një rrugëtim...

**Albana Vokshi** - Po ja ku i kemi të gjithë përfaqësuesit e të gjitha shoqatave, që nuk janë përfituese.

**Denada Seferi** – Jo, janë.

**Albana Vokshi** - Ku qëndron e vërteta? Qëndron e vërteta te përfaqësuesit e shoqatave apo qëndron e vërteta tek ajo që ti lexon në letër? Se nuk ka ndonjë përfaqësues të thotë: “Po, e kam marrë këtë shërbim”.

**Denada Seferi** – Shoqata “Ndihmoni jetën” e ka marrë. Janë sot këtu dhe ndoshta Afërdita vetë, mund të jetë pjesë e këtij diskutimi. Pra, fondi social po funksionon dhe po merr të gjithë rrugën e duhur. A mund ta përmirësojmë? Sigurisht që po. Duhet ta shikojmë së bashku, edhe me të gjitha shoqatat, si ta përmirësojmë këtë gjë, të bëjmë një *join found*, të cilin ne kemi mundësi për ta bërë. Çështja e rehabilitimit, siç thotë Emanuela duhet të ketë qëndrueshmëri, absolutisht që duhet të ketë qëndrueshmëri, por të mos harrojmë, këto nuk janë para donatorësh, janë para për zhvillimin strategjik të vendit tonë, si dhe pjesë e prioriteteve për të ngritur ato shërbime që mungojnë sot. Për këtë arsye, ne kemi negociuar fort, që t’i kemi këto shërbime, që të gjithë personat me aftësi të kufizuar përfshirë edhe fëmijët, të jenë pjesë e tyre.

Më falni, mund t’i kthej përgjigje Emanuelës edhe për një gjë tjetër. Në bazë të çdo gjëje që kemi vlerësuar për vlerësimin bio-psiko-social, kemi futur edhe vlerësimin për fëmijët nga 0-2 vjeç përfshirë edhe formularët e rishikuar dhe kemi rishikuar të gjithë vendimin e Këshillit të Ministrave, sot që flasim.

Zonjat që janë këtu, kur të largohen, mund ta marrin me vete edhe formularin 0-2 vjeç, i cili është pjesë e ndryshimeve të Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për fëmijët. Pra, kjo është një gjë pozitive, se na ka ardhur nga ju si sugjerim dhe me të vërtetë ne i kemi futur pjesë të vlerësimit edhe fëmijët.

**Albana Vokshi** – Emanuela, more përgjigje?

Një pjesë do të t'i dërgojnë edhe me shkrim.

**Orjola Pampuri** – Dua të shtoj diçka. U fol këtu për qendra rehabilitimi që u vijnë në shërbim personave me aftësi të kufizuar, por për sa i përket qendrës së Shoqatës së të Verbërve, të cilën unë e kam vizituar personalisht dhe të them të drejtën ne jemi me fat që kemi një qendër aq të mirë, një qendër që u vjen në ndihmë të gjithë këtyre personave, nuk e di sesi shteti, duke e pasur të gatshme rreth 90% një qendër, lë mangësi vetëm buxhetin? Po për kë punon ky shtet? Mirë e tha Ndreka, thonë do të bëjmë këtë, do të bëjmë këtë, po për çfarë punon ky shtet? Përderisa ofrohet një qendër, një godinë shumë e madhe, që ofron të gjitha shërbimet për këtë kategori dhe për personat me aftësi të kufizuar, një qendër model, unë nuk arrij ta kuptoj dot sesi sot e kësaj dite ajo është lënë në pikë të hallit pa mbështetje. Unë nuk e di, por mendoj se çdo shtet, edhe shteti më pak social në botë, do të bënte një hap, do të thoshte: kemi një qendër të gatshme, ta mbështesim, që t'i vijë në ndihmë kësaj kategorie. Jemi i vetmi shtet që themi: “Të vazhdojnë vetë”. Si të vazhdojnë vetë?! Ata pak kanë vështirësitë e veta dhe pak tani e mbajnë qendrën me thonj, të paktën jepuni një akses, jepuni një mundësi që të ecin përpara.

**Emanuela Zaimi** – Pikërisht, kjo është çështja, shumë mirë që ka një qendër, dhe ju thoni të mbështet ajo qendër, por ne që financojmë ofrojmë shërbime me paratë tona, pse të mos mbështetemi? Ndërkohë që shteti thotë: unë do të bëj 11 qendra të reja. Shumë bukur, jo 11 por 111 duhen ndoshta. Po neve që i kemi, pse na lini të fundosemi?

Domethënë, zgjidhja e qëndrueshmërisë nuk është fondi social, por është propozimi që ju thashë unë, kjo gjë rregullon edhe tregun në një farë mënyre. Nëse ti si shtet i thua prindit: nuk kam mundësi të të jap shërbimin sot, do ta ngre ndoshta mbas 3 vjetësh, por të lutem zgjidh organizatën apo qendrën private, ku t'i do ta marrësh shërbimin, ku kushton 10 ose 15 mijë lekë, se unë do të rimburoj”, këtë gjë e bëjmë, mbasi të kemi bërë edhe kostimin e shërbimit, dhe të kemi rënë dakord, se unë e jap shërbimin me 10 mijë lekë, dikush tjetër në shtëpi me 5 mijë lekë, sepse nuk deklarom asgjëkundi që është duke punuar privatisht, por të jetë vetë prindi që ta zgjedhë cilësinë e shërbimit, se nuk prish punë nëse erdhi te Afërdita apo tek Ema, apo kudo që të shkojë. Kjo rregullon në një farë mënyrë edhe tregun. Nuk është e thënë që të jetë në masën 100%, as në botë nuk është apo nuk jep shteti 10 orë terapi në javë, por nga 1 deri në 2 orë, mendoj se kjo është zgjidhja afatgjatë.

**Afërdita Seiti** - Meqë jemi duke folur për fondin social, dua të them se Fondacioni “Ndihmoni jetën” ka një qendër shumë bashkëkohore, një qendër që ka 10 vjet që është ngritur

dhe funksionon me paratë e prindërve, është në një ndërtesë me 1700 metra ndërtim, në 3000 metra tokë, e ngritur me të gjithë infrastrukturën dhe me një staf shumë të trajnuar, prej më shumë se 20 vjetësh. Vitin e kaluar një pjesë e shërbimit tonë u financua nga fondi social dhe kjo ishte me kërkesën e vazhdueshme që ne si organizatë kemi bërë dhe në bashkëpunim me bashkinë u bë kërkesa, dhe ministria u ndej mirë që për herë të parë një model i tillë po e aplikon.

Unë po e aplikoj, kam rezervat e mia për disa gjëra që kanë dalë dhe dëshiroj ta takoj zonjën Denada, për t'i tejkualuar këto gjëra, që të funksionojë implementimi. Por kam diçka tjetër për të thënë për qendrën. Qendra është 1700 metra dhe nuk po funksionon fare, se ne kemi ngritur dy qendra në Tiranë, një të paguajnë prindërit dhe një të bashkia me fondin social të ministrisë.

Për qendrën që është atje jofunksionale, çfarë do të bëhet me vazhdimin e shërbimeve tona? Emanuela tha 1% të funksionojë, dhe jam shumë dakord, se ka ngritur disa problematika që ekzistojnë, pavarësisht shifrave, të cilat flasin vetë, pro çfarë do të bëhet? Pse qendrat tona të ngritura nga donatorë me miliona euro rrinë atje dhe na thuhet të vazhdojmë vetë? Si mund të vazhdojmë vetë? Me pagesat e prindërve? Jo, zotëri, qendra ime u dëmtua nga tërmeti dhe është DS4, ka mbetur ashtu, se quhemi “biznesi i madh”. Jo, zotëri nuk jemi biznes i madh, kemi status “jofitimprurës” dhe shërbimet janë detyrim i shtetit.

Ministria e Shëndetësisë së bashku me bashkinë, t'i gjejnë këto strategji, se edhe në strategjinë e shërbimeve sociale ishte që do të financohen një herë qendrat ekzistuese. Edhe Denada e di shumë mirë, sepse ka qenë pjesë e strategjisë, sepse shërbimi është më i lirë kur është e gatshme qendra, nuk ngrihet qendër e re, janë para edhe këto. E kanë më mirë të ngrenë një qendër të re me miliona euro, sesa të na financojnë neve.

Edhe për personat që nuk shikojnë e kemi qendrën gati.

Nga ana tjetër ne tatohem si biznes i madh. Në qendrën time, që është DS4, kam dy vjet që paguaj 3 milionë lekë në vit tatim mbi metrat katrore. Është turp që shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuar, të tatohen mbi godinën. E kishim ëndërr një qendër, jam prind vetë, e kisha ëndërr të ishte fëmija im në shërbim, një lloj si gjithë të tjerët, tani duhet të propozet shërbimi, sepse ishte i bukur dhe me standarde të larta! Jo, këto nuk duhet të ndodhin.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëtarë të ministrive,

Duhet të jemi në bashkëpunim me njëri-tjetri dhe ato që themi t'i bëjmë, të mos i lëmë të zgjaten dhe të stërzgjaten dhe ne të flakemi, se kemi edhe emocione se jemi prindër.

Shërbimi që po ngrihet nga fondi social, dua të them atë që tha edhe Denada, është shumë e vërtetë jepet për 3 vjet, sepse unë jam pjesë e këtij shërbimi, por frika ime është si do të vazhdojë ky shërbim. Ky shërbim duhet të jetë i qëndrueshëm, nuk duhet të lihet në dorë të rastësisë, që nëse do bashkia bëhet, se mund të vijë dikush tjetër në bashki. Mua më është dhënë mundësia në Tiranë dhe paguan bashkia, por pas 3 vjetësh mund të më thotë bashkia: ik, ti zonjë, se e marr unë. Është një këndvështrim jo i drejtë për shërbimet që japin organizatat dhe unë dua ta ngre këtë problem, sepse ne jemi si të diskriminuar në këtë punë, quhemi “biznes i madh”, por jemi jofitimprurës apo na thuhet që këto shërbime do t’i marrë shteti. Si do t’i marrë?

Në të gjithë botën shteti financon, sepse nuk mund të monitorojë dot bashkia shërbimin që jep vetë. Më thoni, mund ta monitoroj dot unë shërbimin që jap vetë? Unë them është më i miri. Jo, duhet të shitet shërbimin. Kemi 15 vjet që themi të “shesim shërbimin” dhe sot asnjë s’po e shet shërbimin. Apo na thonë: shikojini këto politika, se pas 3 vjetëve do kalojë te ne kjo gjë. Si do të kalojë? Po unë që e ngrita, si prind? Si do kalojë te ju? Ne jemi agjenci shërbimi, do të kalojë patjetër te ne, do të shesim shërbimin dhe ne do të luftojë pranë jush, pranë ligjvënësve, që këto gjëra të shkojnë sipas ligjit.

Unë dua të flas edhe për shërbimet për personat mbi 21-vjeç, për shërbimet e problemeve të autizmit. Ju lutem, Denada, zëvendësministre, prindërit i mbajnë fëmijët përdore, janë shkatërruar familjet me dy fëmijë me autizëm, mbi 18-vjeç, se kur mbarojnë shkollën nuk kanë ku të shkojnë, nuk ka shërbime edhe qendra. Kam 1700 metra ndërtim atje, me dy atelie, me sera për të punuar edhe me gjithë të tjera, që rri bosh dhe është duke rënë, se po bëhen 10 vjet që është ndërtuar.

Ju lutem, shikojini me përparësi ato që themi së bashku, sepse unë jam një njeri që kam takime, nuk rri, jam anëtare e këshillit ndërministror, e ngre edhe atje zërin, por sërish asgjë nuk bëhet.

**Albana Vokshi** – Afërdita, faleminderit!

**Afërdita Seiti** – Faleminderit juve!

**Albana Vokshi** – Është e qartë që kjo seancë nuk na mjafton, për të trajtuar të gjithë problematiken.

Denada, ju lutem të përgjigjeni, që avokati, Afërdita dhe Ilda të marrin përgjigjet dhe të largohen, se kemi edhe zëvendësambasadoren që do të flasë.

**Denada Seferi** – Për çështjen e fëmijëve me aftësi ndryshe, që kishte të bënte me transportin, me ndihmën financiare, e cila duhet të shtohet për fëmijët me aftësi të kufizuar, që KEMP-et duhet të kenë një skemë të njëjtë, pra, për vlerësimin bio-psioko-social, ne kemi bërë ndarjen e 4 kategorive dhe 4 niveleve, duke përcaktuar edhe nevojën që duhet të kenë për shërbime, për paketa të ndryshme dhe njëkohësisht për të pasur edhe ndihmë të llojeve të ndryshme, se kur kemi kategorizuar nivelet edhe pagesat janë bërë të përshkallëzuar. Gjithsesi, ne mund të mbetemi në kontakt dhe ta vijojmë çështjen sipas kategorive, për të parë me kujdes edhe çështjen e shumës së pagesave të fëmijëve me aftësi të ndryshe, për të përcaktuar tamam nivelin, kujt niveli i përkasin ata.

Në fakt, në legjislacionin tonë kemi të parashikuar indeksimin e pagesave të verbërisë dhe indeksimi i pagesave të verbërisë është bërë çdo vit sipas të gjitha vendimeve të Këshillit të Ministrave, kështu që kjo është pjesë që është indeksuar nga momenti kur kemi pasur vendimin e Këshillit të Ministrave

Për pagesat e prapambetura, është e vërtetë ajo që thotë avokati, se ne kemi pasur disa vendime gjyqësore, që kanë të bëjnë pikërisht me personat e verbër. Janë rreth 11 gjyqe, në mos gaboj, për të cilat vetëm në 10 prej tyre është ngarkuar Ministria e Shëndetësisë për të bërë rimbursimin e këtyre pagesave. Ato janë të përfshira në një fond të veçantë në buxhetin e shtetit dhe në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kështu që, do të vijojnë të paguhen rast pas rasti, sipas vendimeve të gjykatës së formës së prerë.

**Sinan Tafaj** – Kryetare, edhe një herë, dua të më kuptoni.

As Ministria e Shëndetësisë dhe as Ministria e Financave nuk mund të fshihen pas gishtit, pavarësisht se gjykata ka ngarkuar, për shembull, bashkinë e Klosit për të paguar 500 apo 600 milionë lekë të vjetra, kur vetë buxhetin e ka sa gjysma e kësaj shifre, këto janë detyrime që rrjedhin nga buxheti i shtetit. Gjykata e merr në përgjegjësi bashkinë, sepse ajo ka bërë pagesat, por këto pagesa janë të munguara, sepse buxheti i shtetit, pra ministria nuk i ka planifikuar në buxhet siç duhet, madje është kjo ministri përgjegjëse që, në vitet 2005-2010 ka nxjerrë udhëzime të gabuara në kundërshtim me vendimin e qeverisë.

Pra, ministria nuk mund të thotë se unë nuk i paguaj aty ku nuk kam emrin. Jo, këto detyrime rrjedhin nga buxheti i shtetit, rrjedhin nga ligji i buxhetit dhe janë pagesa buxhetore, nuk janë bashkitë ato që paguajnë personat me aftësi të kufizuar. Nëse do ta lemë kështu, do të thotë që ne duhet të shkojmë në Strasburg. Nuk janë bashkitë ato që paguajnë pagesat e aftësisë së

kufizuara, sepse ligji e ka thënë të qartë që këto janë pagesa që rrjedhin nga buxheti i shtetit, nuk kanë ardhur si rezultat i kontratave apo gabimeve të bashkive, por kanë ardhur si rezultat i mosfinancimit nga buxheti i shtetit. Prandaj, ju lutem shumë, të kuptohemi drejt, nuk janë 19 gjyqe, por janë më shumë se 40 gjyqe dhe nuk janë 200 milionë lekë, por janë 400 – 500 milionë. Unë nuk po them që vëri të gjitha për njëherë, por të fillohen të paguhen ato të viteve 2011, 2012, 2015, 2107 deri te viti 2019 apo 2020. Në qoftë se ju nuk do t'i planifikoni këto pagesa, ne do ta çojmë çështjen në Strasburg dhe gjykata e Strasburgut, ju siguroj që jo vetëm do ta paralizojë shtetin shqiptar, por do ta bëjë edhe me turp. Nuk mund të fshiheni pas gishtit, sepse ligji e ka shumë të qartë: këto pagesa financohen nga buxheti i shtetit, pavarësisht se kush i paguan ato. Është njëllor si t'i thuash postierit të sigurimeve shoqërore, paguaje ti pensionin, meqë nuk ta kanë dhënë sigurimet shoqërore.

Pra, nuk mund të ecet me këtë logjikë, është logjike e mbrapshtë, të fshihesh pas gishtit. Nuk kanë përgjegjësi bashkitë, edhe pse formalisht ato thirren në gjyq, sepse nuk kanë realizuar pagesat. Përgjegjësinë e ka buxheti i shtetit, e ka Ministria e Financave, e ka Ministria e Shëndetësisë, e ka qeveria, e ka Kuvendi. Këtë zgjidheni ju.

Ju lutem shumë zgjidheni, por ama këto janë pagesa që dalin nga buxheti i shtetit. Nuk është përgjegjëse bashkia, se nuk ka bërë kontrata me individët.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Kuvendi nuk e ka në dorë këtë.

Ne jemi Kuvendi, ne po ndihmojmë dhe do të vazhdojmë. Por thashë që në këtë seancë nuk i zgjidhim dot të gjitha problemat, do të bëjmë seanca të tjera, kurdo që ju të keni nevojë.

**Sinan Tafaj** – Problemi është që të planifikohet shuma, jo në atë koncept që ka ministria, por në konceptin se çfarë ka vendosur gjykata për këta persona, se është shteti dhe ai përgjigjet për ne dhe konkretisht është qeveria dhe ministria përgjegjëse.

Dhe një fjali të fundit, pavarësisht se unë kam kërkuar edhe një takim të ndryshëm, ju siguroj që politikat e ndjekura, qoftë në ligjin e vitit 2014, qoftë në vitin 2016, për shërbimet, janë politika që duhen korrektuar, sepse kanë sjellë pasoja të rënda, qoftë në mungesë të shërbimeve, qoftë në realizimin e të drejtave themelore të këtyre njerëzve.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Nuk besoj se është te ju problemi, besoj se Ministria e Financave duhet të planifikojë pagesat. Do t'i bëjmë kërkesë si komision, që t'i parashikojnë, avokat.

Faleminderit shumë dhe na falni që ju lamë të prisni deri tani!

Atëherë, nëse më lejoni, ia kaloj fjalën zëvendësambasadores, përfaqësueses së UNICEF-it dhe vijojmë pastaj me dëgjesa,

**Afshan Khan** – Së pari, ju falënderoj shumë që më dhatë mundësinë për të ndjekur këtë takim!

Çështja e fëmijëve dhe e të rinjve është shumë e rëndësishme dhe unë jam e nderuar të flas këtu në emër të tyre. Jeta e fëmijëve dhe të rinjve ka lidhje të drejtpërdrejtë me vendimet që merren në lidhje me buxhetin dhe me realizimin e të drejtave të tyre. Duhet të kemi parasysh faktin që 2 vitet e fundit ishin shumë të vështira dhe kjo u reflektua edhe në zbatimin e angazhimeve që janë marrë, qoftë nga qeveria, qoftë në emër të komitetit ndërkombëtar.

Unë do të flas shumë shkurt dhe do të fokusohem te gjërat e rëndësishme në lidhje me aktorët kryesorë, që merren me zbatimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri, dhe prioritetet e këtij buxheti.

Ndryshimet pozitive, që ne i shikojmë të reflektuara në projektbuxhetin e vitit 2022, në këndvështrimin tonë janë parashikim i rritjes ekonomike dhe përlllogaritja e të ardhurave në buxhetin e vitit 2022 është shumë optimiste.

Gjithashtu, për sa i përket arsimit, shëndetësisë dhe rindërtimit, që janë një prioritet shumë i qartë në buxhetin e vitit 2022, një element i ri që është reflektuar në projektbuxhetin e vitit 2022 është edhe investimi te kapitali i të rinjve dhe zhvillimi i aftësive digjitale të tyre, që është shumë e mirëpritur nga ne dhe madje është shumë e nevojshme.

Rritja e grantit të pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore në dy mandatet e reja është shumë pozitive dhe ka nevojë që të kuptojmë më shumë se si këto buxhete do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar nevojat. Gjithashtu, një pjesë e buxhetit do të shkojë për njësitë e qeverisjes vendore në mënyrë që të menaxhojnë barrën e shtuar të Covid-19.

Rritja për arsimin parauniversitar është një element shumë pozitiv dhe në përputhje me strategjinë e aprovuar të arsimit për pjesën e mbrojtjes sociale, buxheti i përgjithshëm ka rënë. Kjo është në përputhje me rezultatet e reformës për asistencën ekonomike në kesh për shtresat në nevojë.



Një pikë shumë pozitive është që do të ketë një rritje me 10% në sasinë e asistencës ekonomike për familjet e varfra dhe kjo sasi do të dyfishohet për familjet me mbi 3 fëmijë. Gjithashtu, financimi social për shërbimet e kujdesit shëndetësor është i përfshirë në buxhetin e vitin 2022, por shuma për këtë pjesë ka rënë.

Për sa u përket rekomandimeve, ne si UNICEF mbetemi të angazhuar të diskutojmë me sektorin përkatës, me ministritë, me parlamentin, madje javën e ardhshme kemi takim me Grupin e Deputetëve Miqtë e Fëmijëve.

Rekomandimet tona kryesore janë:

rritja në mënyrë progresive e alokimit të buxhetit për mbrojtjen sociale, në mënyrë që të arrihet një prag, i cili është i krahasueshëm me vendet e tjera në rajon. Pra, investimi mesatar për mbrojtjen sociale për rajonin e Europës dhe Azisë Qendrore është rreth 16% e PBB-së; rritja e alokimeve vendore për fondin social për t'u siguruar që shërbimet e kujdesit social financohen plotësisht në nivelin vendor. Buxheti duhet të përdoret për t'i mbështetur njësitë e qeverisjes vendore që të rekrutojnë burime njerëzore të kualifikuara dhe të ngrenë mbrojtjen e fëmijëve dhe strukturat e mirëqenies në përputhje me ligjin "Për shërbimet e kujdesit social"; përcaktimi si prioritet i alokimit të burimeve financiare dhe njerëzore për sektorin shëndetësor me një theks të veçantë te kujdesi i shëndetësisë primare, në mënyrë që të sigurojmë një akses të barabartë për shërbime shëndetësore cilësore për fëmijët, ku përfshihen fëmijët në zonat e largëta dhe fëmijët romë; rritja e alokimit të buxhetit për buxhetin parashkollor.

Një studim i UNICEF-it ka vlerësuar se buxheti parashkollor duhet të rritet me 1% të PBB-së për të përmbushur objektivat e përcaktuara në strategjinë kombëtare parauniversitare, në mënyrë që të ofrojmë një universalizim të shërbimit parashkollor; investimi publik në arsim duhet të arrijë në 5% të PBB-së. Ky target është vendosur në Strategjinë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar. Një studim i UNICEF-it konfirmon se mospërmbushja e këtij objektiivi rezulton me humbje 35 milionë dollarë çdo vit për vendin.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

*(Diskutim në anglisht)*

Ka kërkuar fjalën përfaqësuesi i Shoqatës së ish - të Përndjekurve Politikë, i cili është në pritje që në orën 10:00.

E di që ju keni shumë për të folur, problematikat tuaja janë ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, me të drejtë, por do ta vlerësoja nëse për efekt të kohës do të ishit konciz.

**Etem Fezollari** – Faleminderit, zonja kryetare!

E nderuar zonja Vokshi, kryetare e komisionit,

Të nderuar deputetë dhe pjesëmarrës në këtë eveniment,

Së pari, ju falënderoj për ftesën dhe mundësinë për të marrë pjesë në dëgjesat e këtij komisionit të nderuar për buxhetin e vitit 2022, ku ne si shoqatë duam të shprehim kërkesat tona!

Unë jam Etem Fezollari, kryetar i Shoqatës së ish-të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë. Jam zgjedhur në këtë detyrë më 25 shtator të vitit 2021. Shoqata jonë ka një aktivitet prej 26 vjetësh. Në fillimet e saj kjo shoqatë kishte fonde të mjaftueshme për të ndihmuar të dënuarit e sapodalë nga burgjet e atij sistemi, njëkohësisht edhe për të kërkuar eshtrat e të vrarëve nga diktatura, të cilat janë shpërndarë në të gjithë territorin e Shqipërisë. Me kalimin e viteve ky buxhet erdhi duke u zvogëluar, derisa arriti që të mos përballonim dot as shpenzimet më minimale të aktivitetit të kësaj shoqate.

Kërkesa jonë kryesore është që fondet në drejtim të kësaj shoqate duhet të jenë më optimale, për të përballuar pas 30 vjetëve gjetjen dhe rivarrimin e eshtrave të të vrarëve nga diktatura. Këtu dua të shtoj që në shumë qytete janë zbuluar dhjetëra varre, të cilët janë enigmë. Dimë që janë të vrarë nga diktatura, por nuk dimë kush janë këta persona. Për arsye të mungesës së fondeve ne nuk kemi qenë në gjendje t'i nxjerrim këto eshtra dhe t'i varrosim sipas zakoneve shqiptare, duke bërë një gjë të mirë për familjarët e tyre, të cilët akoma nuk kanë marrë një përgjigje nga shteti shqiptar. Pra, mendoj që kjo është shumë imediate.

Zonja kryetare, kanë kaluar 30 vjet dhe shumica e fëmijëve që kanë lindur para 30 vjetëve janë martuar, edhe me fëmijë komunistësh, qoftë vajza, qoftë djem. Ne i kemi falur dhe i kemi harruar këto probleme armiqësie. Mendoj se e gjithë shtresa jonë është integruar për arsye se fëmijët tanë janë nipër dhe mbesa të komunistëve, por edhe anasjelltas.

Kështu që, lufta që bëhej midis dy shoqërive, asaj të deklasuar dhe asaj komuniste, tani pas 30 vjetëve nuk ka më efekt dhe ka ardhur koha që të japin dorën e pajtimit të gjithë shqiptarët dhe të ecim përpara.

E vetmja mënyrë që kjo të realizohet, minimalisht duhet ta ndjejmë si detyrim, është që për këta njerëz që janë vrarë gjatë diktaturës në mënyrën më makabre, të alokohet nga ana juaj, zonja

kryetare, një fond i veçantë në mënyrë që ne të jemi në gjendje që në mos 100% të paktën 50% të këtyre eshtrave t'i nxjerrim dhe rivarrosim sipas zakoneve tona.

Gjithashtu, kërkojmë respektimin e të gjitha datave historike. Në të gjitha rrethet ka data historike për të vrarët, duke përfshirë edhe një grup deputetësh që janë vrarë, dhe për një pjesë të tyre ne nuk kemi gjetur akoma varret. Këto data janë të shumta dhe të shtrira në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Kërkojmë ngritjen e obeliskëve të të vrarëve nga regjimi komunist, mbulimin e shpenzimeve operative të shoqatës, si e vetmja shoqatë që ekziston me degë të organizuara në të gjithë Shqipërinë, edhe pse një pjesë e këtyre degëve nuk kanë fondet më minimale për të paguar shpenzimet e domosdoshme.

Ne si shoqatë kërkojmë të na planifikohen nëpërmjet institucionit të Ministrisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Institutit të ish-të Përndjekurve Politikë fondet e nevojshme për realizimin e këtyre objektivave dhe misionit për të cilin është krijuar kjo shoqatë.

Faleminderit të gjithëve për bashkëpunimin dhe vëmendjen!

**Albana Vokshi** - Edhe unë ju falenderoj shumë, zoti Fezollari!

Këtu kemi përfaqësuesit e ministrisë, të cilët i kanë mbajtur shënim kërkesat tuaja.

Po ia kaloj fjalën vajzës meqenëse është pak pa qejf dhe pastaj juve.

Ju lutem, prezantohuni.

**Ermela Zenelaj** - Përshëndetje!

Faleminderit për ftesën!

Unë jam Ermela Zenelaj, kryetare e Shoqatës për Mbrojtjen e Talasemikëve Shqiptarë. Kërkesat tona i kemi përmbledhur në 5 pika, ku 3 janë për pjesën e shëndetësisë dhe 2 për pjesën sociale.

Për sa i përket shëndetësisë, kërkojmë rishikimin e medikamenteve të rimbursuara, për arsye se kemi disa lloje medikamentesh të rimbursuara për talaseminë, por shumica prej tyre janë me efekte anësore. Ju lutem, dëshirojmë të kemi medikamente cilësore me standarde europiane të EMA-s, siç trajtohen të sëmurët talasemikë në Gjermani, Greqi, Qipro.

Përveç pjesës së talasemisë janë edhe dreponët, me të cilët jemi në të njëjtin pavijon. Në të gjithë Shqipërinë janë rreth 400 pacientë me drepano, 250 e të cilëve kanë kriza 4-5 herë në vit dhe duhet të shkojnë në urgjencë. Për të lehtësuar krizat e këtyre pacientëve për momentin nuk ka

asnjëlloj medikamenti. Daktoreshat tona dhe pacientët tanë kanë bërë një kërkesë për të rifutur një medikament të ri për uljen e krizave të drepanocitozëve.

**Denisa Malo** – Përshëndetje!

Jam Denisa Malo. Edhe unë jam kryetare e Shoqatës së Talasemikëve.

Për sa u përket medikamenteve, në qarkullim janë shtatë lloje preparatesh. Ne duam t'i reduktojmë këto preparate, sepse shumica nuk përdoren, duke ulur ndjeshëm edhe buxhetin dhe në këtë mënyrë marrim ato medikamente më me pak efekte anësore dhe që neve na bëjnë mirë. Ne i kemi provuar dhe ritestuar që më mirë të marrim pak e saktë. Në këtë mënyrë edhe buxheti ulet ndjeshëm.

Gjithashtu, duam të rifutet një lloj medikamenti që përdoret për drepanocitozët në BE dhe gjithandej është futur, kurse këtu te ne nuk ekziston, për arsye se talasemikët dhe, kryesisht pacientët me drepanocitozë, kanë kriza herë pas here që mund të shkojnë deri në vdekje, prandaj ne duam që këtë medikament ta rifutim për t'ia lehtësuar sado pak dhimbjen e shkaktuar nga këto kriza.

E kemi cilësuar edhe emrin krizaliam dhe mund ta rishohim; e kemi kërkuar edhe vjet.

Duke marrë parasysh pjesën sociale për vlerësimin e KEMP-it, që është vlerësimi biopsiko-social, doja t'ju bëja një pyetje: ku bazoheni që talasemia të futet në kategorinë e lehtë, në kategorinë e parë? Në një diskutim në një shërbim social më thanë që ju mund të punoni. Po, unë mund të punoj, kam punuar në shërbim social, por unë mund të punoj me hemoglobinë 7. Të gjithë ju këtu a mund të punoni me hemoglobinë 7? Unë kam punuar me tensionin 7 me 4 dhe nuk më është dhënë leje për të shkuar në shtëpi (po e marr si shembull). Ndonjëri nga ju, të paktën 8 me 4, a e ka përballuar dot punën (jo punë zyre, por një punë intensive)?! Nuk e përballojmë dot. Të paktën, vlerësimi biopsiko-social nuk mund ta kategorizojë një pacient me talasemi në kategorinë e lehtë, sepse, përveç talasemisë, kanë edhe sëmundje të tjera bashkëshoqëruese.

Minimalja që duhet të marrë një pacient me talasemi nga ky vlerësim është “i moderuar”, nuk po them “i rëndë”, se varet pastaj nga pjesët shoqëruese.

**Albana Vokshi** – Urdhëroni!

**Denisa Malo** – Unë jam me talasemi, kam edhe diabet, kam ostroperozë, jam me tiroide dhe mua nuk më është vlerësuar fare dosja dhe ma konsiderojnë si një diagnozë të lehtë, kur kam edhe sëmundje bashkëshoqëruese.

Unë dua që vlerësimi të jetë sa më i saktë, sepse mua më ndjek një mjeke onkohematologe qysh nga lindja dhe deri sot që jam 34 vjeç dhe nuk mund të shkoj te një mjeke hematologe specialiste, kur nuk e di dhe nuk më ka vizituar ndonjëherë. Si mund të bëhet ky vlerësim nga ajo ose nga një punonjëse sociale që nuk e di vështirësinë time dhe nuk janë marrë për bazë absolutisht asnjë nga sëmundjet shoqëruese. 80% e talasemikëve kanë edhe sëmundje bashkëshoqëruese, janë me hepatit, janë me HIV, janë me ostroperozë dhe kanë shumë problematika. Nuk mund ta quajmë të lehtë.

Unë dua që të rishikohet dhe jo të dalim çdo vit dhe të bëhet ky vlerësim, se talasemia nuk shërohet.

**Albana Vokshi** – Faleminderit, Ermelda dhe Denisa!

Faleminderit që i parashtruat problematikat tuaja!

Unë po bisedoja me doktoreshën që është zëvendësministre. Ju lutem, lini një takim që t'ia shpjegoni më qartë se si qëndron problematika!

Nëse është kështu siç ju po e trajtoni këtu, është e rëndë. Çdo sëmundje duhet trajtuar ashtu siç duhet, por edhe për ilaçin doktoresha do të bëjë një sqarim të shkurtër, pas përfaqësuesit të shoqatës së diabetikëve.

**Asim Toro** – Të nderuar miq,

Të nderuar ligjvënës,

Të nderuar qytetarë të cilët ndani halle pa fund, sikurse ne të sheqerosurit e kësaj bote, Shoqata e Fëmijëve dhe të Rinjve me Diabet punon për realizimin e objektivave të caktuara përmes:

1-Angazhimit për të promovuar dhe për të mbështetur të drejtën legjitime të pranimit, përfshirjes dhe integritit të njerëzve me diabet në shoqërinë shqiptare, duke u bazuar në respektimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut dhe Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, duke informuar dhe duke rritur ndërgjegjësimin e publikut, të institucioneve dhe palëve të tjera të interesuara.

2-Kontributit për fuqizimin e njerëzve që jetojnë me diabet për të bërë një jetë të pavarur dhe promovimin e edukimit me metodat dhe terapitë bashkëkohore të aplikuara në trajtimin e diabetit.

Të gjithë mund të flasin për diabetin, por ndryshe dëgjohet kur e tregon një nënë, një familjar apo një bashkëvuajtës 45- vjeçar me diabet.

Të flasësh për diabetin sikur po bisedon për rrufën, vetëm në Shqipëri ndodh. Diabeti është sëmundja më e ashpër në botë dhe këtë e kupton kur ke në familje dikë me diabet.

Diabeti është një sëmundje dinake. Ajo nuk vjen me dhimbje fizike, por të fton e të josh të hash ato që nuk duhet t'i konsumosh. Diabeti të gërryen çdo sekondë që kalon, për më tepër në Shqipëri përshpejtohet më shumë kjo gangrenë e pashmangshme në jetë. Po, po gangrenë pa pushim në 86400 sekondat e 24- orëshit me diabetin tim. Kështu na gërryen diabeti si ai tik-taku i akrepave të sekondave të një sahati!

#### Bullizëm

Në kopshte e në shkolla, në punë, e në shoqëri, pa harruar që këtu shpesh ndihmojmë për keq edhe vendimet e qeverisë!

#### Kostot

Ekzaminime pa fund dhe vetëm vuajtje mbledhim nga diabeti ynë, duke vuajtur për të ndjekur protokollin e sëmundjes. Aleatët tanë, që mund të na lehtësojnë, shpesh pozicionohen në kundërshtarë duke mos pranuar të informohen për çështjen tonë. Mbarë shoqërinë e shëndoshë ne e duam për "aleat". Çuditërisht kjo pjesë e shëndoshë e shoqërisë na sigmatizon. Fillojmë e ndjemë peshën e vuajtjeve sapo shfaqet diabeti në çdolloj moshe. Mos qoftë e thënë të jetë me diabet një fëmijë kopshti, sepse nuk e pranon edukatorja. As mësuesja e shkollës s'ndihet mirë me një fëmijë me diabet. Përpiqet të mos ketë të tillë në klasë. Apo punëmarrësi që të shkarkon nga puna për të vetmen arsye "krimin e të pasurit diabet". Preferojnë ta lënë larg në vuajtjet e tij këtë "kriminel" bashkë me telashet e tij, sesa ta afrojnë

Me diabetin merret 4 grupime:

- 1- Pacientët
- 2- Ata që na mjekojnë.
- 3- Në 14 nëntor merret edhe qeveria (për kortezi)
- 4- Pjesa e shoqërisë që i dëgjon veresie problemet tona.

Dëshiroj të ngre zërin e arsyes për të thënë gjëra për të katërta grupimet.

1. Grupin e diabetikëve, të shtrëngojnë radhët, të ngremë zërin dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin. Nuk mund t'ju them shumë gjëra, pasi kemi të njëjtin hall dhe ia dimë njëri-tjetrit.
2. Atyre që na mjekojnë, të cilët i ndeshim në dy versione: të parët, bluza të bardha të pastra e të panjolllosura, me përkushtim për të na ndihmuar, edhe pse mundësitë e tyre janë shumë më pak se çdo donin ata të bënin për ne, në raport me pritshmëritë tona. Ata i falënderojmë

përzemërsisht; grupimi i dytë është ai i indiferentëve, për të mos i cilësuar abuzivë, shumë herë ne për ta nuk jemi as pacientë, por thjesht klientë. Jo rrallë kjo kategori i nënshtrohet edhe presionit të qeverisë për ta mos e lëshuar dorën për medikamente cilësore, dhe janë të gatshëm të bëjnë aleancën, të cilën për interesat e tyre të vogla, e bëjnë me pushtetin dhe jo me pacientin. Bashkëfajësi apo mungesë përgjegjësie!?

3. Për shoqërinë në tërësi (jo komunitetin me diabet), dua thjesht t'i shkund dhe t'i zgjoj.

Diabeti nuk zgjedh! Nuk ka preferenca moshe, arsimit, kulture apo të matet me nivel ekonomik.

Na kushtoni pak vëmendje dhe ofroni kontributin tuaj ku, si dhe sa mundeni. Edhe pse sot jeni të shëndoshë, me siguri e keni një mik një shok ose familjar pranë jush dhe ai ka nevojë për zërin tuaj.

4. Politika dhe pushteti që prodhon qeveria

Jeni ju, të cilëve ne të gjithë së bashku ju kemi pranua të vendosni për fatet tona për të hartuar, për të programuar, për të projektuar, për të implementuar ligje dhe vendimet e ndryshme për të na shërbyer e qeverisur ne.

Detyrimisht i kemi sytë te ju dhe presim shumë prej humanizmit tuaj.

Sigurisht, ne nuk presim 14 nëntorin të shfarosin diabetin. Ajo është thjesht një ditë ndërgjegjësimi për popullatën. Afrimi i kësaj dite na shton përgjegjësinë dhe indiciet për t'i shkruar këto rreshta që flasin për vuajtjet tona. Do të preferoja që kjo ditë e ndërgjegjësimi për të sëmurët me diabet, ditë që shumëkush prej jush, pasi vrapon, të vendosë një simbol, rrethin blu, në cep të jakës së kollarisur, për të treguar “solidaritetin” apo për të rendur në ndonjë studio televizive për të treguar humanizmin që ju karakterizon.

Do ju lutesha, pasi do të ishte më me vend që atë ditë atë karrige ta linit bosh dhe në vendin tuaj në atë studio të shihja një bashkëvuajtës që shpohet 4 herë apo më shumë në ditë për të marrë insulinën. Kjo kohë që të tepron ty, o zyrtar, që paguhesh nga taksat tona, të të shërbejë për të evidentuar, për të hartuar, për të programuar kuadër ligjor konkret për ne, të identifikuarit e kësaj dite.

Mjaft më me hipokrizinë e kësaj dhe solidaritetin që ju na kushtoni në çdo 14 nëntor! Merruni me problemet tona 364 ditët e tjera të vitit, pasi hallet tona janë të pafund, janë të përditshme!

A dëshironi përlësisht t'ju sugjeroj se si dhe pse?

Ndihmoni rimbursimin e fishave për pensionistin, që mos ta cenojë atë mesatare prej 15 mijë lekësh pension mujor! Le t'ju teprojë ndonjë lekë për ndonjë ushqim të përditshëm.

Ndihmoni të rinjtë me diabet të mos plaken shpejt dhe të jenë pensionistë të parakohshëm që në moshën 30-40- vjeçare!

Lehtësojini të rejat shtatzëna me diabet, pasi dhimbshëm konstatojmë se shumë çifte nuk i përballojnë dot protokollet e shtatzënisë për të sjellë një foshnje në jetë!

Hiqini barrierat për procedurat e përfitimit të invaliditetit, lejes së qarkullimit (patentës), taksat e drejtpërdrejta apo përfitime të tjera, pasi shpeshherë vlera e letrave që ne bëjmë për të përligjur këto benefite e kalojnë edhe vetë vlerën e këtyre benefiteve. Ja, pra, kaq konkrete janë hallet tona.

Në vijim të takimeve për diskutimet me grupet e interesit të draft-buxhetit për vitin 2022 e në vazhdimësi të Ministrisë së Shëndetësisë, krahas problematikave të ngritura nga parafolësit si probleme për të cilat edhe ne mbetemi në konsideratë, po ju vëmë në dispozicion kërkesat e komunitetit me diabet për listën me rimbursimit për vitin 2021.

Medikamentet sipas rëndësisë:

- Fishat glicemike ose matës i sheqerit në gjak është i nevojshëm për një person që jeton me diabet, sepse, pa kontrolluar vlerën e sheqerit në gjak, pacienti do të ketë një sërë komplikacionesh, të cilat do të kenë një kosto më të lartë për shtetin.

- Duhet të rritet moshë, fasha e rimbursimit, të paktën deri në 35 vjeç, sepse ka të rinj që janë studentë, të papunë dhe nuk mund t'i sigurojnë fishat. Përse duhet të vendosni kufizim të moshës?!

- Aparatet e fishave dhe lancetat duhet t'i sigurojë kompanitë falas dhe, gjithashtu, duhet të jenë të certifikuara.

- Lancetat të garantohen falas për çdo pacient nga 4 copë në ditë.

- Glukagonit ose zjarrfikësi diabetik përdoret në rastet e komës diabetike, por edhe me injeksion për të gjithë të sëmurët me diabet, i cili merret nga hunda pasi e bën efektin më shpejt dhe është më i lehtë në përdorim nga ai që injektohet në muskul.

- Aget e injektimit të insulinës.

Ne kërkojmë age. Fëmijët duan age 4 mm dhe jo age 8 mm. Një të rrituri i duhen age 6-8 mm, në varësi të vendit ku e injekton insulinën dhe në varësi të masës dhjamore që ka. Për shembull, kur e injekton në kofshë, nuk ke nevojë për 8 mm, bëje 6 mm, kur e bën në krahë bëje



4 mm, pasi pacienti ka të drejtë të kërkojë gjatësinë e ages në gjatësinë që i nevojitet. Kjo nuk ndodh.

#### Holterat glicemikë

Në qoftë se do të vendosim holterat glicemikë, fëmijët, studentët ose femrat shtatzëna nuk do të përdorin fishat e matjes së sheqerit në gjak. Këto duhet të rimbursohen, sepse e lehtësojnë shumë jetën me diabet. Me holterin monitoron glicemitë nonstop, 24 orë, dhe kupton se çfarë ka ndodhur gjatë natës kur pacienti ka qenë në gjumë. Holteri ka një kosto më të ulët dhe më të përballueshme në krahasim me fishat. Për pacientin me diabet nuk ka vështirësi në përdorim, asnjë komplikacion. Me holterin mund të bësh 200 matje në 24 orë pa e zgjuar fëmijën.

#### Pompat e insulinës

Me përdorim të pompës së insulinës nuk do të përdor as fisha e matjes së sheqerit në gjak dhe as holteri glicemik. Duhet të rimbursohen dhe duhet të jenë pompa të avancuara. Duhet të rimbursohen pompat e avancuara inteligjente për aq të sëmurë sa do të kenë nevojë për mjekimin me pompë ose për femrat shtatzëna. Në përgjithësi, do të duhen 70 pompa në total për të gjithë Shqipërinë, duke përfshirë femrat shtatzëna dhe individët me probleme të tjera shëndetësore.

Si gjithmonë shoqata ka punuar për t'i bërë me dije strukturat përkatëse në lidhje me arritjet shkencore për diabetin, kostot dhe vështirësitë që kanë personat me diabet dhe specifikat e veçanta të këtij grupimi. Ua sugjerojmë juve për të ndërhyrë me politikat tuaja për të na lehtësuar sado pak jetën me veprimtaritë që kryeni.

Neglizhenca, abuzimi, indiferenca përballë mos ndërhyrjes në vendimet lidhur me grupimin tonë na shtynë në një shteg tjetër, ku fillojmë dhe diskutojmë për gjëra më të tmerrshme. Nga dalja jashtë kontrollit e sëmundjes mandej pacienti nis luftën me komplikacione, të tilla si:

1. Dëmtimi i syve - Retinopati diabetike
2. Dëmtimi i zemrës - Arterie koronare
3. Dëmtimi i trurit - Goditja cerebrale e trurit
4. Dëmtimi i veshkës - Nefropati diabetike
5. Ulçera diabetike
6. Dëmtimi i nervave - Neuropati diabetik

Në kuadrin e përfshirjes së dëmtimit diabetik, shtohen më shumë të verbrit, më shumë të paralizuarit, më shumë të rinj të paafët për punë. Në qoftë se fillojnë këto komplikacione, pacientit

dhe shtetit i shtohet një kosto tjetër e hospitalizimit të pacientit dhe besoj se nuk keni për të dëgjuar ndonjë gjë të zgjuar për herë të parë nga unë “parandalimi sot, ul kostot e shoqërisë për nesër”. Mbetemi në pritje me konsideratën se ju ligjvënës do të arrini të pranoni me zë të lartë se shëndeti i popullatës është prioriteti juaj maksimal.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit shumë, Asim!

Urdhëroni, doktoreshë!

**Mira Rakacolli** – Faleminderit!

Po e filloj me talasemikët në lidhje me rolin e medikamenteve që kërkohen për t’u rimbursuar. Nuk është ministria ajo që vendos se cili medikament do të rimbursohet, por është grupi i nderuar i profesorëve dhe i shefave të shërbimit ose i eminencave të mjekësisë që merren me atë fushë, që bëjnë vlerësimin për medikamentet dhe i rekomandojmë ato.

Ministria bën gjënë tjetër: i analizon vazhdimisht në efikasitetin e këtyre barnave në laboratorët e përcaktuar për këtë punë.

Pra, lloji i medikamenteve që është për t’u rimbursuar vendoset nga një grup specialistësh.

Për sa i përket preparatit të ri për derpanocitozën, për atë që bëjnë kriza, fatkeqësisht krizat e derpanocitozës janë pjesë e sëmundjes. Fatmirësisht, jo të gjithë i përjetojnë këto kriza dhe një pjesë e mirë i rregullon këto kriza me hidroksiurenë ose me preparate të tjera, me oksigjenin dhe me preparate të tjera kundër dhimbjes që janë të efektshme në Shqipëri.

Për sa i përket preparatit që ju thoni, është një preparat që ka dalë tani dha shumë mirë që jeni avangardë, sepse ne gjithmonë edhe së bashku kemi shkuar përpara në këto lloj terapish, është një preparat i ri që vetëm në vitin 2019 ka dalë si preparat dhe është aprovuar. Nuk është rimbursuar në një pjesë të mirë të vendeve, por, pa dyshim, nëse shërbimet do ta fusin nëpër protokolle, nëse shërbimet e pediatriisë ose të hematologjisë që merren me këtë punë do ta kërkojnë dhe do ta rimbursojnë, patjetër që do të vlerësohet ashtu siç janë vlerësuar të gjitha medikamentet e tjera.

Zonja kryetare, vetëm me një fjali do ta shpjegoj se nuk merret në bazë të diagnozës vështirësia, por në bazë të komplikacionit që të jep ajo diagnozë. Do t’jua sqaroj mirë se si është problemi.

Për sa i përket problemit që ngriti zoti Asim në lidhje me diabetikët, theksoj se diabeti është një sëmundje që gjithmonë është pasur në vëmendjen e të gjitha sistemeve shëndetësore të botës për shkak të të gjithë atyre problemeve që Asimi rreshtoi shumë bukur. Është një barrë për shoqërinë

në të gjitha aspektet, në anën mjekësore në radhë të parë, në anën sociale dhe natyrshëm edhe në anën ekonomike.

Vazhdimisht ka qenë në vëmendje të shëndetësisë përkujdesja për diabetin, gjë që është e provuar.

Dje ishte edhe Fondi këtu në dëgjese dhe u pa që diabeti zinte vendin e dytë në listën e rimbursimit, në sasinë e parave të rimbursimit, pas sëmundjeve kardiovaskulare për shkak të problemeve që ai paraqet.

Edhe sivjet, megjithëse ishim në një vit pandemie, përsëri në listën e rimbursimit u fut një medikament, insulina aspart e një forme të re, që megjithëse ishte njësoj efikase si insulina aspart, por ishte shumë më e kollajshme për t'u bërë dhe nuk kishte nevojë të kishte atë diferencën që duhet në lidhje me ushqimin, por që mund të bëhej menjëherë, pikërisht për t'u dhënë mundësi që të menaxhohej më mirë, u fut përsëri në listën e rimbursimit.

Në lidhje me rimbursimin e fishave, ka qenë insistimi i shoqatës suaj që e kërkuat fillimisht deri në 18 vjeç, u bë. E kemi shtyrë deri në 24 vjeç dhe po shikohen edhe mënyrat e tjera se si mund të rimbursohen.

Asimi e mbylli shumë bukur kur tha se duhet të mendojmë sot për t'i evituar shoqërisë të gjithë atë barra nesër që lidhet me sëmundjet sterovaskulare dhe të gjitha të tjerat që i rreshtoi si një mjek shumë i mirë të gjitha komplikacionet që vijnë nga diabeti dhe pikërisht kësaj i shërben edhe kontrolli mjekësor bazë, sepse vetëm nga kontrolli mjekësor bazë janë zbuluar 15% prediabetikë dhe 9% diabetikë që nuk e dinin se vuanin nga kjo sëmundje.

Në kontrollin mjekësor bazë u fut edhe azotemia, edhe klatinemia për të kapur pikërisht tek ato pacientë kur dëmtimet janë minimale, që ato nuk i vendosin vetë.

Pra, diabeti si një nga sëmundjet jo të transmetueshme është një nga sëmundjet që ka një vëmendje, për të cilën vazhdimisht është punuar. A mund të bëhet më shumë? Patjetër që mund të bëhet më shumë dhe ne do të vazhdojmë të bëjmë më shumë duke qenë afër këtij komiteti dhe vazhdimisht duke qenë edhe në lidhje, siç kemi vazhduar të jemi, me grupet e interesit që kanë të bëjnë me këtë problem.

**Albana Vokshi**– Faleminderit!

Urdhëroni, doktor Seladin!

**Seladin Jakupllari** – Më tepër është pyetje për zëvendësministren. Në kontrollin bazë kam mendimin që të futet hemoglobina e glukozuar, sepse ajo është një indeks shumë i rëndësishëm

që zbulon diabetin latent, po kështu ndjek ecurinë e të sëmurit diabetik. Për mendimin tim, hemoglobina e glukozuar, nëse e keni të rimbursuar aq më mirë, është shumë pozitive.

**Asim Toro** – Më fal, nuk dua ta quaj ndërhyrje, por hemoglobina e glukozuar ka filluar të jetë e rimbursuar, pavarësisht punës së mjekëve të familjeve që janë kthyer në sekretarë të pacientëve, nuk janë të informuar të gjithë. E keqja është që diabeti në shifrat apo në listat e rimbursimeve zë vendin e dytë në Shqipëri. Dua t’ju bëj me dije se të gjitha këto halle, probleme, pra cili është diabeti, dihen në të gjithë botën, se edhe ju e keni në familje apo në shoqëri.

Dua të theksoj se bashkëpunimi me persona të drejtpërdrejtë, siç quhemi ne, pacientë për diabetin është në nivel shumë të ulët. Ju lutem, rritini këto nivele bashkëpunimi me ne që i kemi në kurriz këto çështje të ndryshme, që kjo punë edhe për ju të jetë më me benefite, më e lehtë, por edhe ne t’i kemi problemet më të rralla. Kështu që të vijmë të flasim për medikamentet apo për shifrat, kur as unë vetë që jam përdorues i tyre nuk di e nuk dua t’i mësoj, sepse nuk më takon. Por këto ecejaket dhe letrat që më kushtojnë kohë dhe ekonomi, ku unë për të arritur një përfitim nuk e kam larguar diabetin as një sekondë në 31 vjetët e mi. Prandaj t’i lëmë teorinë dhe të jemi më konkretë në bashkëpunimin dhe në punët tona.

Ju uroj gjithë të mirat!

**Mira Rakacolli** – Më duket se nuk folëm për teori, por folëm për shumë gjëra praktike që janë bërë.

**Elsa Zhulali** – Jam në cilësinë e drejtueses së Fondacionit “Glow Albania”, e cila ushtron veprimtarinë e saj në disa fusha: në edukim, teknologji informacioni, shëndetësi dhe siguri ushqimore.

Në fillim erdha komplet me një strukturë tjetër për atë se çfarë do të thosha, por duke ju dëgjuar të gjithë, më bëri pak përshtypje se njerëzit që kanë sëmundje të ndryshme etiketohen, për shembull diabetikë, talasemikë kjo është shumë e gabuar. Këtu duhet të jetë vendi, ku nuk duhet të emërohen në këtë mënyrë. Njerëzit nuk janë sëmundja që kanë, por duhet të quhen njerëz me diabet, pacientë me diabet, me talasemi, sepse është si të thuash për një njeri që ka kancer, kancerogjen.

**Albana Vokshi** – E tërheq, ishte për shpejtësi.

Elsa, të lutem, a mund të futemi në brendësi?

E tërheq nëse nuk janë ndjerë mirë.

**Elsa Zhulali** – Në rregull!

Atëherë, kam ardhur këtë për të parashtruar shqetësimet dhe propozimet për vëmendjen që i është treguar sëmundjes së celiakisë, e cila është një sëmundje shumë serioze autoimmune, është e vetmja sëmundje e cila trajtohet përmes dietës pa gluten.

Çfarë është gluteni? Është një proteinë që ndodhet në disa drithëra: në grurë, elb, thekër dhe tërshërë. Të gjithë njerëzit, që janë të prekur nga kjo sëmundje, kanë këtë intolerancë, e kanë të pamundur ta tolerojnë këtë proteinë që është e kudondodhur. Jemi shumë krenarë që përgjatë veprimtarisë sonë, që fillimisht nisi një faqe në *Facebook*, pastaj në *Instagram* dhe më vonë mori formën e një portali, kemi korrur shumë suksese, ndër të cilat është rritja e ndërgjegjësimit se çfarë është gluteni, rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë ushqimore, sepse dieta pa gluten është i vetmi trajtim për të prekurit nga kjo sëmundje. Dieta pa gluten është shumë e kushtueshme, kap vlerën e 15 mijë lekëve të rinj në muaj. Dieta pa gluten në Shqipëri është gati e pamundur, sepse mungon informacioni nga shumë pikëpamje, po e marr nga siguria ushqimore, sepse na prek të gjithëve jo vetëm ata që janë të prekur nga kjo sëmundje. Një aparat që e kemi siguruar, i cili ka marrë çmimin e novacionit nga "*Forbes*" që tregtohet në Amerikë dhe në Kanada (nuk kam interes për ta reklamuar) mezi e kam siguruar, kemi testuar produkte që janë të etiketuara pa gluten nga kompani shqiptare dhe me këtë aparat janë testuar me gluten.

E kuptoni se çfarë i bën gluteni një personi? Po marr një rast personal, fëmija im që është i prekur nga kjo sëmundje prej 6 vjetësh, një fëmijë 10-vjeçar shumë energjik, fatmirësisht shumë optimist, shumë i gëzuar, vjet fitues i disa çmimeve në të gjitha kategoritë e sporteve në shkollë, por në rastet kur ndodh aksidentalisht që ai të kontaminohet me gluten, kthehet në një tjetër fëmijë edhe unë vetë e kam të vështirë ta njoh se çfarë i ndodh, është një helm. Simptomat variojnë, mund të kesh dhimbje koke, këputje, pra është një çmontim, të bëhet mendja e mjegullt, anemi, njihen 300 simptoma. Njerëzit mund të kenë një të njërën prej tyre, disa prej tyre ose mund të jenë asimptomatikë.

Çfarë kemi vërejtur përgjatë ushtrimit të veprimtarisë? Këtu mungon një protokoll i mirëpërcaktuar për diagnostikimin e kësaj sëmundjeje, i cili të jetë i bazuar sipas udhëzimeve më të reja që janë aprovuar nga Shoqata Europiane për Hepatologjinë, Ushqimin e Gastroenterologji. Ky është propozimi ynë i parë.

Propozimi i dytë, para 3 vjetësh ka qenë pjesë e skemës së rimbursimeve, ofrohej KEMP-i. Prej disa vjetësh nuk ofrohet më. Bota jashtë nuk e ofron më në formën e KEMP-it, Shqipëria dhe Kosova janë të vetmet vende në rajon që nuk e përfitojnë këtë gjë.

Si e ofrojnë? Përmes një recete që përmban emrin e personit, kodin dhe shumë e disponueshme dhe të shkojë të marrë, të blejë në supermarket produktet pa gluten.

Dy propozimet tona kryesore janë mirëpërcaktimi i një protokolli fiks nga spitalet shtetërore dhe të bëhet pjesë e skemës së rimbursimeve. Se si kjo ndodh në vendet zhvilluara, e kemi këtu bashkëlidhur, e kemi përkthyer në shqip dhe në anglisht sesi janë udhëzimet e përcaktuara nga Shoqata Pediatrike, jua kemi dërguar.

Edhe një herë dua të vë theksin për çështjen e sigurisë ushqimore, jemi shumë krenarë për vendosjen e një marrëdhënie përmes dialogut që kemi me kompanitë prodhuese shqiptare. Çfarë kemi kuptuar? Po marr një rast, kemi parë që produkti ka rezultuar pa gluten, kemi shkuar dhe e kemi parë që ka kompani, të cilat i prodhojnë dhe i etiketojnë produktet pa asnjë lloj kriteri. Kjo është vrastare, jo vetëm për njerëzit që janë të prekur nga kjo sëmundje, por edhe për të gjithë, edhe unë që nuk e kam këtë problem. Shkruaje ti, sepse mendojnë se është tangërllek, sepse mendojnë se përbën një vlerë të shtuar, ndërkohë që helmatisin njerëzit. Nuk pyet më as se je kryeministër, ministër, çfarëdo.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Tani që po e diskutonim edhe me doktoreshat, është e rëndësishme të fillojë të bëhet protokolli dhe pastaj të kalohet te rimbursimi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Mira Rakacolli** – Faleminderit!

Gjithçka bëhet në bazë të protokolleve. Do të bëjmë një sensibilizim të Shoqatës së Pediatrisë, sepse janë shoqatat ato që do të bëjnë sensibilizim, e cila të krijojë protokollin, pastaj duke e vlerësuar protokollin, do të shikojmë, duke qenë vazhdimisht në lidhje me shoqatën tuaj dhe me shoqatat që i kanë, se si mund të ndihmohet sa më tepër.

**Ermonela Xhafaj** – Jam komisionere e Avokatit të Popullit që mbuloj mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës.

**Albana Vokshi** – E di që keni pritur shumë, por duhet ta limitojmë në 5 minuta diskutimin.

**Ermonela Xhafaj** – Do të përpiqem, sepse shqetësimi që do të ngremë sot, është për atë që pjesë që nuk kanë mundësi të paraqiten këtu në këtë komision, ka të bëjë me persona që kanë probleme të shëndetit mendor, sidomos ata që janë me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe për personat e burgosur, ata nuk kanë mundësi të vijnë në komisione.

I dëgjova me respekt të madh përfaqësuesit e të gjitha kategorive, por po ngre një shqetësim shumë të rëndësishëm. Avokati i Popullit është mekanizmi i vetëm që merret me respektimin e të drejtave të njeriut. Nëpërmjet të gjitha inspektimeve tona, qëllimin kryesor e kemi për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, si dhe për respektimin e të drejtave të njeriut. E kemi shqyrtuar me vëmendje të veçantë të gjithë projektbuxhetin e vitit 202. Nuk shohim asgjëkund të përmendet spitali *Forensic*, që është një problem shumë i madh. Është një problematikë e ngritur prej shumë vitesh, jo vetëm nga Avokati i Popullit, por është ngritur edhe nga institucionet e tjera ndërkombëtare, duke përfshirë Komitetin Kombëtar të Parandalimit të Torturës, i cili është në Këshillin e Europës, si dhe nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Mos harroni se në fillim të këtij viti çështja “Strazimiri” e dënoi shtetin shqiptar me 15 mijë euro, në total 17 mijë euro për moskrijimin e kushteve që të vuajnë këta njerëz dënimet e tyre të dhëna nga gjykatat me institucione shumë të specializuara për këtë fushë. E kemi ngritur për disatën herë, unë jam vetë pjesëtare e Komitetit Kombëtar për Shëndetin Mendor dhe kjo është një tematikë e përsëritur. Deri sot që flasim nuk është bërë asgjë.

Dua ta përshëndes vendimin e ministrit të Drejtësisë, i cili para disa ditësh premtoi se brenda nëntorit do të mbyllet burgu i tmerrshëm i Zaharisë. Ne shkojmë dhe bëjmë inspektime gati 2 herë në vit në këtë lloj burgu, por ne nuk gjejmë asnjë përmirësim nga të gjitha angazhimet që merr shteti shqiptar si Ministria e Drejtësisë, ashtu edhe Ministria e Shëndetësisë, nuk kemi parë asnjë ndryshim.

E përshëndes vendimin e ministrit të Drejtësisë, i cili ka vendosur të mbyllet burgu i Zaharisë dhe ata 329 persona të kalojnë në IEVP-në e Shën Kollit. Është një vendim, i cili është i mirë, por është i pamjaftueshëm. E kam këtu buxhetin, i kam shënuar me të gjitha ngjyrat e mundshme dhe nuk shikoj asgjëkund që të ketë një përcaktim nga Ministria e Shëndetësisë as për vitin 2022, as për vitin 2023, as për vitin 2024 për këtë kategori. Ministria e Drejtësisë i mori, i futi brenda në IEVP-në në Shën Koll, i ka përshtatur ato mjediset, çfarë do të bëjë Ministria e Shëndetësisë? Nuk ka Kosova ligjin “Për shëndetin mendor, ne e kemi, Kosova ka një spital *Forensic* shumë të mirë, ne nuk e kemi.

Një problematikë tjetër, e cila na sjell shumë ankesa për këtë kategori vulnerabël problemet e shëndetit brenda në IEVP. Nuk ka mjekë, sot që flasim kemi mungesë 33 persona nga 24 IEVP. Këta mjekë, që pretendojnë ose më saktë ofrohen për kohë të pjesshme pranë këtyre institucioneve, qëndrojnë një farë kohe dhe ikin. Pse? Sepse paga është shumë e vogël. Shikoj se Ministria e

Shëndetësisë nuk ka bërë asnjë përcaktim për punësimet e këtyre mjekëve, nuk ka specializime, e mira do të ishte që këta persona, këta mjekë, të afrohen sa më afër sistemit të burgjeve. Ka qenë më parë sistemi i gradave, nuk bëhet asgjë në këtë drejtim. Ka vetëm një përcaktim për spitalin psikiatrik të Elbasanit. Për të disatën herë është bërë projekti ekziston, është alokuar fondi, është hequr fondi, i është dhënë dikujt tjetër. Jam dakord të bëhet spitali i pediatriisë, jam dakord për të gjitha spitalet e mundshme, por kjo kategori shumë vulnerabël nuk ka. Është përcaktuar vetëm për spitalin psikiatrik të Elbasanit dhe për asnjë nga spitalet e tjera, as për Tiranën, as për Vlorën, as Shkodrën, ku situata është e tmerrshme. Nëse Ministria e Shëndetësisë do të donte një mendje nga Avokati i Popullit, atëherë ky i fundit do t'i thotë: e gjithë ajo ndërtesa, që ka qenë dikur spitali psikiatrik që sot është bosh, mund ta rikonstruktohet dhe aty mund t'i çoni njerëzit të qëndrojnë në kushte shumë të mira.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kjo ndërtesë është në Shkodër.

Një gjë tjetër ka të bëjë me problematikën e ushqimeve.

Zonja kryetare, më vonuat, sepse unë do të shkoja në Peqin, ku është duke u bërë një grevë për problemin e ushqimit. Asgjëkund nuk është e përcaktuar problematika e ushqimit. Ka që në vitin 2006, është një urdhër i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Drejtësisë për kaloritë dhe përcaktimet e tjera. Ka ndryshuar shporta, kanë ndryshuar të gjitha që nga viti 2006 deri sot nuk u gjet një mënyrë që të ulen këto dy ministri dhe të diskutojnë për këtë gjë. Ministri i Drejtësisë tha me të drejtë: nëse më vjen një ankesë për punën e ushqimit, atëherë drejtori i IEVP-së do të pushohet. Sot IEVP-ja është në grevë urie në Peqin.

Dua të sjell në vëmendjen e të gjithëve se do të jetë në të mirë të të gjithë aktorëve që ata prindër ose familjarë, të cilët shkojnë një herë në javë me tasa, tenxhere, mos u pafshin më njerëzit në atë gjendje. Larmishmëria e ushqimit, e gjithë gramatura të jetë në nivelet të cilat mund ta "kënaqin" atë lloj kategorie. Ata janë në fund të ditës persona që kanë të drejta dhe detyrime; përveçse të drejtën për të dalë nga ai lloj ambienti, janë persona njëlloj si ne të tjerët.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Të falënderoj shumë!

Të kërkoj shumë ndjesë që të vonuam, por e keni dëgjuar vetë se kemi pasur dëgjesa, duhej ta kishim planifikuar ndryshe, është gabimi ynë. Pjesën sociale, ne vendosëm me Avokaten ta



bëjmë javën që vjen, meqenëse donte të ishte vetë personalisht. Janë disa shoqata të tjera që kanë kërkuar dëgjësë, prandaj do të bëjmë një shtesë javën që vjen.

Besoj se na i keni dërguar me shkrim.

**Mira Rakacolli** – Problemet që u ngritën janë të ndjeshme, por nuk është e vërtetë që nuk jemi marrë me to.

Për pjesën e parë të parashikimit të spitalit *Forensic* është e vërtetë se nuk është në buxhetin e vitit 2022, por është te PBA-ja, për faktin se janë parë mundësitë, është vlerësuar dhe ajo që sugjeruat ju, problemi i spitalit psikiatrik të Shkodrës. Është një institucion, siç e përmendët ju që ka koston, ashtu siç duhet, për të gjithë parametrat kërkon një vlerësim shumë të mirë, sepse nuk është thjesht një ndërtesë ndryshe, por do të ketë një qasje krejt ndryshe të shërbimeve që do t'u ofrohen këtyre njerëzve.

Nuk është thjesht ndërtimi i një ndërtese, por edhe një qasje në mënyrën se si do të ofrohet shërbimi. Prej më se një vit është ngritur një grup pune ndërmjet dy ministrive dhe ajo që thatë për ministrin e Drejtësisë, konkluzionet që ka nxjerrë ky grup pune ka ardhur si rezultat pas një bisede ndërmjet dy ministrave, të Shëndetësisë dhe Drejtësisë, për të parë të dyja bashkë se si duhet ta çojnë atje ku duhet këtë punë.

Në lidhje me spitalin e Shkodrës nuk është parë i përshtatshëm nga grupet që merren me këtë gjë, sepse është një spital brenda territorit të spitalit të qytetit dhe nuk është i përshtatshëm...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Unë ju dëgjova.

Kjo është se çfarë është thënë nga ekspertë të kësaj fushe, sepse duhet të ketë rrethim të jashtëm me njerëz me uniformë. Nuk është parë e përshtatshme. Ne flasim gjithmonë me specialistët për këtë punë. Po shikojmë mundësi se si bëhet. Është aplikuar në projektet IPA, e kemi në PBA.

Për sa i përket të ofrimit të kujdesit mjekësor në institucione, nuk është Ministria e Shëndetësisë përgjegjëse për këtë kuadër, por është ajo e Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë i ka në strukturë, i merr në punë dhe për sa u përket specializimeve ka kuota të veçanta. Universiteti i Mjekësisë, Ministria e Shëndetësisë ka kuotat e veta, Ministria e Drejtësisë ka kuotat e veta. I përzgjedh vet, askush nuk mund të konkurrojë për një specialitet në Universitetin e Mjekësisë, po nuk pati një letër mbështetëse nga Ministria e Drejtësisë për t'u futur atje. Po kështu, Ministria e Mbrojtjes dhe ajo e Brendshme.

Problemi që ngrini me të drejtë i mungesës së kuadrove, nuk është pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë, por është e Ministrisë së Drejtësisë. Universiteti i Mjekësisë është ai që përgatit kuadrot, por ka autonomi universitare.

**Albana Vokshi** – Dakord, do ta kemi javën që vjen Avokaten e Popullit.

Denis, ju lutem shkurt, anëtarët e opozitës në kanë kërkuar një dëgjese me vete në lidhje me raportet e fundit që ju keni publikuar, referuar buxhetit, për ta vazhduar më gjatë seancën tjetër.

**Denisa Canameti** – Shumë faleminderit, zonja kryetare!

E para, dëgjova se është diskutuar në nivel drejtuesish problematika e mungesë së medikamenteve për fëmijët me sëmundjet e rënda, është një problematikë që zgjat më shumë sesa një vit, edhe sipas diskutimeve, komunikimeve shkresore që kemi pasur me drejtuesit, është problem procedurash. Unë dua të evidentoj dhe të doja ta kërkoja me shumë forcë nëse është problem buxheti, është momenti për ta riparë dhe për të vënë buxhetin e mjaftueshëm në dispozicion, sepse fëmijët me kancer më shumë se një vit e gjysmë po vuajnë mungesën e medikamenteve, gjë që është shumë e dhimbshme dhe e patolerueshme.

Pavarësisht se është në nivel drejtuesish, ata drejtues nuk po arrijnë ta zgjidhin. Nëse është problem buxheti, të shihet kjo gjë.

Së dyti, kemi insistuar prej vitesh për implantin koklear. Duam t’ju përsërisim, është një procedurë, e cila ka vazhduar të vihet në funksion. Ajo çfarë ne duam të dimë është për t’u garantuar që të ketë vazhdimësi, duam të dimë sesa është numri i implanteve kokleare që është parashikuar të bëhen çdo ditë dhe sa është fondi i parashikuar për financimin e paketës së implantit koklear? Sepse nuk e pashë, edhe në diskutimin që bëri ministrja nuk e përmendi.

Një tjetër gjë është financimi i fertilizimit *in vitro*. Biem dakord që infertiliteti është një sëmundje, është një problematikë, është shumë e rëndësishme, është shumë e përhapur. Sot në Shqipëri flasim për rënie të lindjeve, për rritje të infertilitetit, por shteti shqiptar nuk ka asnjë incentivë mbështetëse për këtë kategori. Bëhet fjalë për një paketë që i kushton të paktën 5 mijë euro një çifti, sigurisht nëse ky çift do të ketë fatin e mirë të qëllojë me të parën, sepse ndodh që ata duhet ta përsërisin 1-2 apo 3 herë. Edhe Kosova e ka. Ne nuk jemi në kushte më të vështira sesa Kosova, pavarësisht se kemi buxhet të kufizuar. E kuptoj që COVID-i i kanalizoi prioritetet në gjëra të tjera, por mendoj se e kemi hapësirën, sepse infrastruktura është e ngritur. Te materniteti “Koço Glozheni” prej vitit 2013 dhe jo me fondet e qeverisë shqiptare, por me fondet e vendet e Bashkimit Europian. Stafin e kemi të përgatitur dhe unë nuk e kuptoj se ku qëndron problematika

për ta vënë në funksion këtë si shërbim. Pjesët e kolostomës. Më vjen keq që nuk u përmend. Është përmendur nga zonja Klodiana Spahiu. Në lidhje me këtë bëjmë shumë lutje nga shoqëria civile, që tashmë të rimburohen, sepse të paktën kemi raste që na vijnë në organizatë, dhe janë shumica gra. Ky është problemi më i madh për to.

Duam të dimë se ku jemi me realizimin e transplantit të palcës së kuqe, në QSUT. Është shumë e trishtë që çdo ditë në rrjetet sociale shohim njerëz që kërkojnë ndihmë nga qytetarët për të dërguar të sëmurë jashtë, kryesisht në Turqi, për të bërë një transplant të palcës së kuqe. Është premtuar nga ministrja si investim, që në vitin 2019.

Tjetër, është investimi i *pet scanner*-it. Edhe për këtë shqiptarët marrin rrugët dhe shkojnë në Turqi. Pra, ne kemi një shëndetësi, për të cilën më vjen keq të them se nuk është moderne, kemi një shëndetësi bazike. Kur flasim për shërbime të specializuara, fatkeqësisht qytetarët shqiptarë nuk i marrin.

Shumë falemnderit!

**Albana Vokshi** – Falemnderit, Denisa!

Falemnderit që fole në mënyrë të përmbledhur.

**Mira Rakacoli** – Falemnderit, Denisa!

Nuk do të thosha se kemi shëndetësi bazike, sepse jemi mjaft mirë si shëndetësi. Në shëndetësi nuk mund të shohësh vetëm atë çfarë mund të arrihet, por edhe se sa vetë mund ta arrijnë atë që është arritur.

Më vjen mirë që të gjitha këto gjëra, të cilat i quani të rëndësishme për ecurinë e shëndetësisë shqiptare, tashmë janë të realizuara. Folët për problemin e implantit koklear. Rreth pesëmbëdhjetë fëmijë sapo e kanë mbaruar me sukses implantin koklear. Tani është planifikuar grupi i dytë, me të cilët do të fillojë implanti koklear. Padyshim që ka një buxhet për të gjithë ata që do të kenë nevojë, në bazë të protokolleve që u bën shërbimi i otojaterve.

Problemi i dëgjimit të fëmijët, sepse nëse flasim për shëndetësinë në përgjithësi nuk është implanti koklear, pra problemi i dëgjimit të fëmijët është shumë i rëndësishëm, ndaj prej disa vitesh ka filluar problemi i depistimit të dëgjimit të shumica e të porsalindurve. Në buxhetin për të cilin jemi mbledhur sot, është edhe programi për të vlerësuar shikimin. Pra, bëhet për herë të parë dhe është një gjë e re, ndërkohë që dëgjimi po bëhet sot në Tiranë dhe në shtatë nga spitalet rajonale më të mëdha të vendit.

Pra, është një problem i buxhetuar dhe i parë me vëmendje.

Në lidhje me fertilitetin *in vitro*, po ka filluar puna për fertilitetin *in vitro* dhe jemi duke vlerësuar paketën, për të parë mundësinë se si të rimburohet, sepse edhe për mungesë të burimeve njerëzore në maternitete, nuk ka qenë e mundur të realizohej atëherë, ashtu siç ka qenë premtuar. Kjo edhe për arsye të tjera, të cilat nuk kanë qenë të lidhura me mungesë vëmendje karshi këtij problemi tejet të rëndësishëm, sepse siç dihet, kjo lidhet edhe me lindshmërinë, lidhet edhe me shtimin e popullsisë. Pra, për shërbimin shëndetësor lindshmëria është një nga treguesit, ndaj e kemi në vëmendje dhe e kemi të bërë.

Padyshim që edhe transplantit i palcës së kuqe, fatkeqësisht është një shërbim i munguar në Shqipëri, por siç e ka premtuar ministrja në 2019-ën, menjëherë sapo të fillojë spitali i sëmundjeve të brendshme, është përcaktuar me të gjitha detajet se si do të funksionojë. Ju keni qenë gjithmonë afër këtij problemi dhe me siguri i dini edhe teknikalitetet, e dini se duhen kushte shumë të veçanta sterile për ata që duhet të bëjnë këtë procedurë, pasi dihet se duhet t'u zerohen leukocitet, ndaj janë të predispozuar për të marrë infeksione. E kemi studiuar në detaje atë projekt, duke edhe që ajrimi të jetë i veçantë për ato dhoma ku do të bëhen, ajrimi të mos përzihet me sistemin kryesor të ajrimit të spitalit.

Burimet financiare janë krejtësisht të përcaktuara, janë të gjetura edhe medikamentet që duhen bërë, edhe aparaturat që duhen për këtë qëllim. Kështu, me të mbaruar infrastruktura sterile, do të kemi mundësi... Na dhemb të gjithëve, që fëmijët të vuajnë për diçka që mund të bëhet. Është një premtim i mbajtur nga ministrja, premtim i bërë në 2019-ën.

Është e vërtetë edhe ajo që thatë, në lidhje me problemin e *pet scanner*-it. *Pet scanner*-in e kemi të përfshirë në projekt, e jo vetëm *pet scanner*-in si aparat, por edhe bashkë me ciklotronin, për të mbyllur kësaj ciklin e diagnostikimit të kancerit në vend. Të mos harrojmë se sa shumë gjëra janë bërë në lidhje me këtë, kur flasim për një shëndetësi bazike, sepse unë si profesioniste nuk do ta quaja shëndetësi bazike një shëndetësi, e cila ofron akseleratorë, një shëndetësi e cila ofron metodat më të mira diagnostike edhe te sëmundja e kancerit, përveç problemit të *pet scanner*it, që mund të bëhet diagnoza edhe mënyra të tjera. Nuk do ta quaja shëndetësi bazike, duke pasur parasysh nivelin e ndërhyrjeve që bëhen si dhe për gjithë nivelin e shërbimeve, që ajo ofron. Aq më tepër, kur të gjitha këto gjëra, që ju përmendët, që natyrisht janë shumë të rëndësishme dhe tregojnë për cilësi shëndetësie, janë të vëna në vijë dhe të parashikuara brenda vitit 2022.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Denisa, i more përgjigjet? Dakord!

Po ia kaloj fjalën Shoqatës Kombëtare të Jetimëve.

Lulzim Resuli, presidenti i shoqatës.

**Lulzim Resuli** – Më lejoni t’ju përshëndes e t’ju falënderoj për zemërsisht!

Unë jam Lulzim Resuli. Jam presidenti i Shoqatës Kombëtare të Jetimëve të Shqipërisë.

Shoqata ka tridhjetë vjet që operon me grupin vulnerabël, pra fëmijët në mungesë të kujdesit prindëror. Problematika që duam të ngremë, paçka se është e disata herë që vij dhe është e njëjta çështje e mbetur ngërç, që lidhet me 8153-shin, që është ligji “Për statusin e jetimit”, i cili ende nuk është ndryshuar, gjë të cilën e kemi kërkuar në mënyrë të vazhdueshme, sepse ajo do të jetë pika e nisjes për një ndryshim të jetës së jetimëve dhe integritet të tyre në shoqëri.

Gjithsesi, sot do t’ju përcjellim disa nga problematikat tona kryesore për sa i përket buxhetit të 2022-shit. Në radhë të parë duhet thënë se ndër vite, që nga 2007-a, buxheti që i është akorduar OJF-ve, organizatave jofitimprurëse ka pësuar një rënie prej 25 %, veçanërisht vitin e kaluar, kur është shtuar edhe një shoqatë tjetër në këtë pjesë, gjë e cila ka bërë që fondi të arrijë në limitin e tij prej 10 mijë eurosh, shumë kjo që nuk përmbush dot as qeranë dhe pagesën e personit që duhet të jetë i deklaruar në tatime. Ky është fondi më i ulët i mundshëm, i marrë që nga viti 2007.

Kësisoj, ne kemi një propozim konkret, me anë të të cilit dëshirojmë t’ju kërkojmë, që këtë vit të planifikohet një shtesë fondi nga 8 milionë lekë të reja në tërësinë për gjashtë shoqatat, të kalojë me plus katër milionë lekë dhe totali të shkojë në 12 milionë lekë. E përpjesëtuar për gjashtë shoqatat e akredituara nga parlamenti shqiptar, të bëhet e mundur që secila shoqatë të marrë së paku 2 milionë lekë. Kjo do të jetë deridiku e mjaftueshme, pasi në tërësinë e përgjithshme, ne kemi thënë se ajo çka mund të na i përmbush nevojat është shuma 3 milionë e 200 mijë lekë. Së dyti, është një problem madhor, i cili ka vazhduar të mbetet, që është strehimi i jetimëve.

Fillimisht, do të dëshiroja që të keni një vëmendje dhe një qasje, për shkak se këtë problematikë e kemi ngritur edhe vitin e kaluar. Ka një godinë të përfunduar, të restauruar, të bërë gati në Shkodër, ku duhet të strehohen jetimet e mbetur jashtë me vite të tëra, për tridhjetë vjet, por ende nuk është marrë asnjë masë për ta vënë atë godinë në eficientë e në përdorim të jetimëve.

Pra, jetimet mbeten ende jashtë, mbeten të pastrehuar, ndërkohë që godina ekziston. Ka një ngërç midis ministrisë dhe bashkisë së Shkodrës, ndaj ne dëshirojmë që instrumentet të vihen menjëherë në punë dhe t’i japim një zgjidhje. U bë i katërti vit që kjo godinë është e gatshme, por është i katërti vit që jetimet mbeten jashtë.

Rikthehemi në kryeqytet. Duke u akumuluar në këta tridhjetë vjet, jetimët me status, të dalë nga befotrofët, shtëpitë e fëmijëve, ata mbeten të pastrehë. Njëkohësisht, më së fundi, janë larguar edhe ata jetimë që kanë mbetur në konviktet shtetërore. U bë një marrëveshje, sepse dalja e tyre nga këto strehimore u bë e dhunshme, pra një marrëveshje, me anë të së cilës bashkia akordoi një bonus qeraje, të cilit i mbaroi afati. Mbaroi afati trevjeçar dhe tani jetimët mbetën në rrugë. Këtë problem e kemi ngritur dhe vazhdojmë ta ngremë me të mëdha.

Nëse nuk do të bëjmë një bllok për fëmijët jetimë, të cilët nuk mund t'i quaj më fëmijë jetimë, sepse janë pesëdhjetë e dy vjeç. Ç'do të bëjmë me jetimët, që dalin tani rishtas e që nuk kanë mundur të birësohen. Është një kontingjent tjetër jetimesh të cilët, pasi të dalin nga shtëpitë e fëmijëve, nuk kanë asnjë perspektivë.

Ju lutem, të mos hapim më kot shtëpi fëmijësh, por t'u japim një mbështetje më të madhe në arsimin profesional, gjë që do të bënte të mundur, që nesër këta fëmijë të jenë të integruar në shoqëri, të kenë një zanat dhe të kenë mundësi ta ndërtojnë vetë jetën dhe të ardhmen e tyre.

Së treti, një problematikë tjetër, që është hasur vitet e fundit, por që po shndërrohet në një modë të jashtëzakonshme: pasi ndërron jetë bashkëshorti në një familje, ka nëna të veja, në veçanti të reja të veja, të cilat duan të shohin jetën e tyre. Atëherë, çfarë bëjnë? Nuk braktisin fëmijët e tyre, por i adoptojnë te gjyshërit e tyre. Mirëpo, mbështetjen financiare, e cila akordohet nga shteti, po e merr kjo nënë, e cila tashmë po shikon jetën e saj dhe po i lë fëmijët pa bukë.

Ne jemi shprehur se me rregullimin e 8153-shit, që është "Statusi i jetimit", mund të futen në kornizën e duhur ligjore edhe pjesa e kujdestarisë. Sepse sot, një nënë e papërgjegjshme nuk tregon përkujdesje për fëmijën e saj, por ama merr benefitet financiare, duke ia lënë barrë gjyshit e gjyshes, që të përkujdesen për nipërit e mbesat. Padyshim, harmonia familjare që ne kemi e bën të mundur që t'i mbajnë, por ama rimbursimi financiar nuk kalon në xhepat e tyre, nuk kalon si ndihmë për përkujdesjen që ata tregojnë ndaj fëmijëve.

Prandaj, ne duam që kjo çështje të shihet me kujdes nga shërbimet sociale në të gjitha bashkitë dhe të mos tuten para asnjë problemi që mund të hasin nga ata persona të papërgjegjshëm, sepse ky është një problem që po zgjerohet shumë në të gjithë vendin.

Së fundmi, ju lutem që të shikohen me përparësi punësimi, integrimi i nënave apo të ketë lehtësime sa i përket trajtimit të tyre në skemat e ndihmës ekonomike. Kjo për shkak se duhet ta kuptojmë që një nënë e re, një grua e re, një zonjë e re, së cilës i ka rënë një hall kaq i madh, siç është humbja e shtyllës së shtëpisë, dhe me barrën e përkujdesjes që i bie, për t'u bërë kryefamiljare

e për të rritur fëmijët e saj, nuk është as e denjë e as e mundshme të dalë e të punojë në tokë bujqësore, duke pasur edhe konflikt me vjehrrin, vjehrrën, kunatin e të tjerë me radhë, dhe vetëm me letra e posedojnë, se nuk mund të futen në skemat e ndihmës ekonomike.

Ju falënderoj shumë dhe shpresoj që këto pika të merren me seriozitet, pasi me të vërtetë ky grup vulnerabël ka një problematikë të jashtëzakonshme. Unë rendita vetëm disa pika, por ka shumë të tjera më pas.

Ju falemnderit shumë!

**Albana Vokshi** – Falemnderit shumë, Lulzim!

Ke ndonjë gjë për të shtuar, Indrit?

Jo. Denada, a mund të akomodojmë? Çfarë mund të bëjmë ne? Çfarë mund të bëni ju?

**Denada Seferi** – Në fakt, çështja e rimbursimit për shoqatën, e cila në fakt është diçka emergjente për Lulzim, me të cilin kam folur edhe më pas, është pjesë e Ministrisë së Financave. Ne mund ta riadresojmë te Ministria e Financave...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, po, se mbase është pjesë suporti.

Ndërkohë, sa i përket strehimit të jetimëve në Shkodër, ne do të ndërmjetësojmë me aq sa të mundemi në lidhje me atë godinë, sepse nuk e dimë se përse bashkia Shkodër nuk ua jep jetimëve dhe nuk i strehon ata, duke qenë se godina është e rindërtuar, e rregulluar dhe ka gjithçka brenda.

Çështja e punësimit të nënave kryefamiljare është pjesë e rritjes së buxhetit të ndihmës ekonomike, dhe gratë familjare do të marrin dyfishin e pagesës. Sidomos nënat me tre, katër, pesë a më shumë fëmijë do të jenë pjesë e dyfishimit të masës së pagesës, sipas strukturës së familjes.

Njëkohësisht, ajo që është e rëndësishme, në fakt, është edhe pjesa e kujdestarisë së përkohshme. Ndoshta do të duhet të bashkëpunohet më shumë me bashkitë, sepse sot të gjitha bashkitë e kanë mundësinë e dhënies së kujdestarisë së përkohshme edhe me vendim gjykate, kur fëmijët kanë probleme dhe largohen nga nëna, për të kaluar tek të afërmit apo te gjyshërit, ku kujdestaria e përkohshme është me pagesë. Buxheti i shtetit e ka të parashikuar, që të paguhet për çdo fëmijë që kalon në kujdestari të përkohshme, qoftë fëmijë-jetim apo fëmijë me aftësi të kufizuar.

Sigurisht, gjithmonë alternativat për jetimët janë që të mos qëndrojnë nëpër institucione, por të dalin jashtë tyre dhe të kenë mundësinë të riintegrohen sa më shpejt që të jetë e mundur në

një shërbim alternativ, kujdestari të përkohshme, ose mbi të gjitha nëpërmjet birësimit, në rastet kur familja mirëpret një fëmijë.

Kjo është shumë e rëndësishme ta kuptojmë të gjithë. Gjithsesi, këto janë politika që janë parashikuar në buxhetet aktuale, sidomos sa i takon kujdestarisë së përkohshme.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, Denada!

Vetëm na thuaj kur të dërgoni atë shkresën, që edhe ne si komision...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po. Po. Na thoni, nëse keni nevojë për ndihmë.

I fundit, por jo për nga rëndësia, Altin! Të falënderoj shumë, që prite kaq gjatë.

**Altin Hazizaj** – Në fakt, unë nuk kam ndonjë gjë për çështjet shëndetësore, sepse më shumë e kam në lidhje me çështjet sociale. Si e the? Ëmbëlsira për në fund, por e vetmja gjë që nuk do të bëj, është t'ju ëmbëlsoj. Ky është problemi. Përndryshe do t'ju kisha sjellë ca çokollata. Në fakt, unë dua të shpreh disa shqetësime, që mendoj se kanë vlerë për komisionin.

Pa diskutim faleminderit që na keni ftuar në këtë dialog!

Gjëja që kuptova, dhe ky është shansi i atij që është i fundit, është se sa pak dialog ka midis qeverisë dhe institucioneve kur vjen puna për buxhetin. Një pjesë e gjetjeve që ne kemi për buxhetin, janë gjetje të momentit të fundit, ndërkohë që në fakt, ligjërisht duhej që qysh në prill të këtij viti të kishte ardhur një kopje e projektbuxhetit ose të paktën të ishim njoftuar për sa u përket atyre që quhen “tavane buxhetore”, të cilat i cakton Ministria e Financave. Në shtator duhej të ishim të gjithë të informuar nga ministrinë përkatëse, jo vetëm nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për sa i përket planifikimit buxhetor, dhe do të duhej që brenda tetorit të gjithë të kishim dhënë opinione, para se të vinim këtu e të bëjmë atë që fatkeqësisht, kjo edhe për ne edhe për ju, është shfaqja e radhës.

Domethënë, mundësia që ju, jo ne, të ndikoni në buxhet në këtë moment është aq e vogël, për të mos thënë inekzistente. E vetmja gjë e mirë e gjithë kësaj seance, është se të gjithë zbrazim barkun nga problemet, na duket sikur sot, të paktën, shkojmë të qetë në shtëpi, duke thënë: “i ndamë problemet që kishim”, por ndërkohë, mungesa e dialogut na sjell në faktin që ne nuk kemi mundësi të gjejmë zgjidhje për këto probleme, e pastaj çdo vit dëgjojmë të njëjtin dialog, ose monolog fare.



Të them të drejtën, unë u preka shumë nga zotëria i parë që foli, i cili ishte me karrocë. Domethënë, të kesh pesë vjet që bën të njëjtin dialog dhe të mos gësh zgjidhje për problemin, kësaj i thonë se ka diçka që nuk shkon, gjë që nuk ka të bëjë thjesht me ministrinë, sepse në fund të ditës të gjithë ne jemi profesionistë. Unë e kuptoj edhe presionin e ministrisë. Unë them se është e nevojshme të kemi një dialog me Ministrinë e Financave. Në qoftë se ka një ministri që vërtet nuk dëgjon, është ajo ministri.

Çdo ministrie i vjen ajo që konsiderohet tavan, dhe çfarëdo lloj lufte që të bësh, atë tavan është e vështirë ta ndryshosh. Po nuk ndryshoi ai tavan, me dëshirën që të zgjidhen këto probleme, ne do të vazhdojmë të gjejmë zgjidhje anësore, duke u ankuar nëpër komisione.

Së dyti, nuk ishte qëllimi i sotëm, por meqenëse dje na është përmendur emri në këtë komision, më erdhi shumë keq, dhe kjo është një ftesë e hapur për të gjithë deputetët. E para, shoqëria civile në Shqipëri, dhe s'flas vetëm për organizatën që unë përfaqësoj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po. Ajo që dua të them është kjo: shoqëria civile në Shqipëri, pavarësisht të gjitha paragjykimëve që mund të kemi, kryen një mision të jashtëzakonshëm. Në fund të ditës, secili nga ne, mirë apo keq, sjell shqetësimet e qytetarëve, dhe tekefundit ne jemi zëri i atyre qytetarëve. Edhe një i vetëm mund të jetë, edhe njëqind mijë mund të jenë, nuk ka rëndësi, dhe të kesh paragjykim të painformuara, se po të jesh i informuar është tjetër gjë, për sa u përket organizatave të shoqërisë civile, unë them se është shumë e gabuar. Pse? Mesazhi që ne japim në këtë komision ka ndodhur dje. Është si të jemi në një shtet jo demokratik. Në një shtet demokratik nuk qëllon, që të atakohet me emër e mbiemër një organizatë joqeveritare. E para, ne sapo fillojmë 25-vjetorin tonë, dhe e dyta nuk na ka qëlluar ndonjëherë në jetën tonë, që të na akuzojë ndokush për asgjë. Kur them akuzoj, unë kam në mendje fëmijët, kam në mendje të rinjtë, që të dalë një person dhe të thotë: nuk na keni dhënë shërbimin që na keni premtuar, s'na i keni mbrojtur një ditë të vetme të drejtat e fëmijëve.

Në këtë aspekt, unë e gjeta shumë fyes qëndrimin e zotërisë, i cili në fakt nuk ndodhet sot këtu, por nga ana tjetër është ftesë e hapur për çdo deputet. Është e drejta juaj të akuzoni kë të doni...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jo, unë s'ia përmenda emrin. Nëse e vure re, unë s'përmenda emër. Si avokat, jam shumë i kujdesshëm në lidhje me atë që them.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jam shumë dakord!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** – E ka dëgjuar Altini, e ka dëgjuar. Të lutem, vazhdojmë.

**Altin Hazizaj** – Ne ia kemi kaluar avokatëve të zyrës dhe minimalisht u kemi kërkuar që zotërinë ta ndjek për shpifje në gjykatë. Për sa kohë jam avokat, njeri i ligjit, unë nuk mund të pranoj shkelje të ligjit nga njerëzit e ligjit. Sepse ju i bëni ligjet, nuk i bëj unë.

E dyta, mua më vjen shumë keq që po në rastin konkret, është përmendur “Alo 116111”-a. Në fakt, ministria duhet të kishte dalë e para për ta përgënjeshtuar, por ç’rëndësi ka. Për sa i përket “Alo 116111”-ës, ai është shërbim kombëtar 24/7 për fëmijët, dhe e them me zemër: shyqyr që e kemi, se ka qenë një luftë e jashtëzakonshme që të mund ta kishim, dhe të dëgjojmë tani deputetë që vënë në pikëpyetje shërbimin e telefonisë falas për fëmijët, kur shteti shqiptar nuk paguan për telefoninë, paguan për një pjesë të rrogave të stafit, gjë për të cilën sigurisht që jemi mirënjohës. Por zotëria sërish nuk ishte i informuar dhe nuk e dinte se që nga 2015-a, “Alo 116111”-a është organizatë më vete, menaxhohet me ndihmën e shtetit, e para njëherë, shërbimi është që nga 2008-a, 2009-a, por po them se nga 2015-a nuk është më as pjesë e organizatës sonë, pavarësisht se ishim krijuar, gjë për të cilën jemi shumë të lumtur.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është e patolerueshme ajo që ka ndodhur dje! Komisioni...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Komisioni duhej të mbante qëndrim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ne e kemi materialin filmik.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** – Të lutem!

**Altin Hazizaj** – E mbylla.

**Albana Vokshi** – A ke diçka tjetër, sepse e kemi diskutuar bashkë. Një nga çështjet më të rëndësishme të ditëve të fundit, është sensibilizimi në lidhje me dhunën ndaj fëmijëve. Meqenëse kemi komunikuar bashkë, sensibilizimin e kemi parashtruar edhe në seancë plenare. Javën që vjen do të flas edhe me zonjën Spahiu, që të fillojmë procedurat në mbledhjen e Nënkomisionit për Çështjet e Fëmijëve dhe të të Drejtave të Grave, gjithashtu do të krijohet edhe aleanca për

mbrojtjen e fëmijëve. Jemi të hapur për çdo sugjerim që ju, si shoqatë, që keni kaq vite që merreni me këtë çështje, se çfarë mund të bëjmë qoftë në legjislacion, apo për ringritjen e sistemit të referimit të mbrojtjes së dhunës ndaj grave dhe fëmijëve.

**Altin Hazizaj** – Të falënderoj!

Shqetësimi i ynë i parë lidhet me pikën nr. 1. Ne kemi pasur një diskutim formal dhe joformal me ministrinë, e thashë, jemi midis profesionistëve, dhe pritshmëria jonë nga ministria këtë vit ishte që vitin e ardhshëm do të kishim dy programe kombëtare. Programi i parë është ai kundër dhunës në familje. Realiteti po na tregon që, jo se nuk e kemi njohur, por fëmijët kanë filluar të denoncojnë, jo vetëm dhunën seksuale, që pa diskutim na shokon të gjithëve, por dhuna është shtruar këmbëkryq si në shkollë, si në familje, edhe shoqëri. Në qoftë se nuk do të kemi një program kombëtar, trajtimi i dhunës do të vazhdojë të mbetet në dorë të joprofesionistëve, se ka plot profesionistë të mirë, por do të mbetet i çorganizuar në fakt edhe për mënyrën se si vetë ligji e ka parashikuar ofrimin e shërbimit. Ofrimi i shërbimit, me të drejtë, nuk ofrohet nga ministria, se nuk është detyrë direkte e saj, por, nga ana tjetër, duke mos pasur detyrë funksionale ofrimin e shërbimeve dhe financimin nga bashkitë, shpesh shërbime të tilla të specializuara mbeten pa financim ose nuk ekzistojnë.

Po marr një ndër rastet më delikate të dhunës seksuale ndaj fëmijëve. Shumica e fëmijëve që përballen me dhunën seksuale nuk duan të jetojnë në qytetin ku ndodh dhe kjo është e drejtë. Ajo që dua të them është se një viktimë e dhunës seksuale, një fëmijë adoleshent përballat me faktin që nuk mundet më të jetojë realitetin në zonën ku ka ndodhur për arsye që nuk do të doja t'i shpjegoja këtu, sepse jetojmë në këtë qytet apo shtet dhe i dimë arsye.

Ajo që ndodh, në fakt, në qoftë se është, nëse nuk ndërhyjmë ne, si organizata të shoqërisë civile, të gjithë këta fëmijë nuk marrin asnjë lloj shërbimi 72 orësh. Falënderoj ministrinë për këtë, që merret në qendrën LILIUM, që është qendër emergjencash! Sot nuk ka asnjë bashki, që të ofrojë shërbime për fëmijët qoftë të dhunuar fizikisht, siç ishte rasti, apo të dhunuar seksualisht, siç kanë qenë disa raste të fundit.

Kështu që, dhe kjo është ftesë për ministrinë, gjithashtu edhe për ju deputetë, kemi nevojë të krijojmë një program të mbështetjes. Rastet që raportohen nuk janë më shumë se 100-150 raste në vit. Ne si zyrë jemi duke bërë edhe një kostim se sa do të kushtonte një adoleshent për të marrë shërbime të plota. Mendoj që, në qoftë se ne kemi edhe këtë kostim që mund ta ndajmë shumë shpejt me ministrinë, buxheti i vitit të ardhshëm të ketë një zë vetëm për viktimat e dhunës

seksuale, qofshin gra, fëmijë, djem apo burra, se, sigurisht, dhuna seksuale nuk ka të bëjë me seksin apo gjininë e personit.

E dyta, kam qenë këtu disa herë, ne vazhdojmë të flasim për çështjen e varfërisë së fëmijëve. Ju i dini vet statistikat. COVID-i e ka bërë situatën e varfërisë së fëmijëve edhe më ekstreme. Banka Botërore e ka thënë, INSTAT-i e ka thënë edhe më qartë dhe, nga ana tjetër, nuk ka një program të vetëm të qeverisë shqiptare që të adresojë çështjet e varfërisë së fëmijëve.

Pyetja është shumë e thjeshtë: si dhe çfarë hanë këta fëmijë sot në këto momente që po flasim? Unë nuk jam i aftë të jap përgjigje. Kjo është një ftesë për ministrinë, për qeverinë, por edhe për ju si deputetë, që kudo po të shkoni në zonat tuaja, jam i sigurt që do të gjeni 20-30% të fëmijëve të pangrënë, dhe kjo për mua është e pafalshme. Ejani t'i gjejnë një zgjidhje kësaj çështjeje! A mund të bëhet me bursa për fëmijët, a mund të bëhet nëpërmjet ndihmës ekonomike, qoftë edhe minimale? Varfëria për fëmijët nuk është vetëm fenomen shqiptar, edhe në Britani rezultonte që 34% e fëmijëve ishin të varfër por jo atë varfëri që kanë fëmijët tanë, aty është varfëri relative. Ejani të krijojmë një paketë qoftë edhe me biznesin në komunitetet ku jetojmë, t'u gjejnë një zgjidhje të gjitha këtyre familjeve, që nuk është nevoja detyrimisht t'i marrin kesh këto ndihma, edhe ekonomia mund të ndihmohet nëse u themi të shkojnë në supermarketet e licencuara siç e ka Amerika, mjafton të kesh një tolonë e të shkosh të marrësh ushqimet bazë falas, të cilat garantojnë ushqimet të paktën.

Kështu që, në këtë aspekt ne do t'ju rekomandonim një program të eliminimit të varfërisë së fëmijëve, e cila është thelbësore dhe shumë e dukshme.

Në qoftë se bëhet fjalë për shifra, fatkeqësisht, janë shumë të frikshme, vetëm po të llogarisim ndihmën ekonomike sa përfitojnë sot, janë të paktën 150 mijë fëmijë që përfitojnë ndihmën ekonomike. Sikur vetëm atyre t'u rritet ndihma ekonomike, të cilën e dimë që është maksimumi, por nuk arrin deri në 80 mijë lekë, sikur t'ju japim diçka më tepër, mendoj se do të kemi dhënë një ndihmë të jashtëzakonshme për eliminimin e varfërisë të fëmijët.

Një çështje që nuk shtrohet dhe nuk e kam kuptuar, në fakt, as me organizatat e të rinjve, është çështja e varfërisë së të rinjve dhe shërbimeve për ta, që është pothuaj inekzistente.

Unë kam një pyetje për të dyja ministrinë. Përgëzoj faktin që është krijuar edhe Ministria për Fëmijët dhe Rininë, pavarësisht se do të shohim se cilat janë diferencat midis mirëqenies, shëndetësisë e të tjera, çështja e varfërisë së të rinjve nuk është në buxhet të veçantë por është ende në zërat e Ministrisë së Arsimit, gjë që edhe kjo më bën përshtypje. Shërbimet për të rinjtë janë

inekzistente. Ju që ktheheni në zonat tuaja një herë në dy javë a nuk di se si e keni, a nuk ju bën përshtypje, se mua më bë shumë? A mund të bëjmë më shumë për ta? Po e ngre si një thirrje më tepër, që mendoj se është shumë e rëndësishme.

E fundit, ne kemi një problem shumë të madh sa i përket çështjes së buxhetit të shëndetësisë vetëm për fëmijët, këtu po hyj pak te shëndetësia, por ma ka lënë zyra porosi, që nuk dihet sa është. Unë vazhdoj të pyes, por asnjëherë nuk e kam kuptuar, se më thonë në fakt, që vetëm fëmijët deri në 1 vjeç përfitojnë ilaçe falas, gjë që në fakt më duket jo vetëm absurde, por edhe e patolerueshme, që fëmijët të mos mbështeten me ilaçe falas, të paktën deri në moshën 5-6 vjeç, që duhet të ishte ajo mosha kur fëmija e ka kaluar atë që quhet rreziku i vdekjes. Në qoftë se do të ishte e mundur të ndërtonim edhe këtu një program të mbështetjes shëndetësore të fëmijëve, jo vetëm vaksinimi, që është baza, por, përtej kësaj, të jetë marrja e ilaçeve falas për të gjithë fëmijët pa përjashtim, s'ka rëndësi sa i varfër apo i pasur është. Në qoftë se ne do të duam të kemi një të ardhme të sigurt, ky është investimi më minimal që mund të bëjmë.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** - Faleminderit, Altin!

Denada, besoj i ke mbajtur shënim çështjet sipas radhës.

**Denada Seferi** – Altin, shumë faleminderit!

Është e vërtetë që jemi mes profesionistëve dhe diskutojmë për programe të ndryshme. Është shumë e rëndësishme, në fakt, që dialogu mes qeverisë dhe shoqatave të vija ashtu siç kemi bërë. Normalisht kemi qenë të gjithë në kontakt me njëri-tjetrin për të kërkuar sa më shumë që është e mundur nga çdo buxhet që planifikohet dhe gjithmonë jemi munduar që të marrim të gjitha prioritetet e prioriteteve. Kështu që edhe në këtë buxhet janë futur prioritetet, siç janë edhe fëmijët e skemës së ndihmës ekonomike. Po e filloj nga fundi. Pse? Sepse në këtë projekt-buxhet mbulojmë të gjithë pjesën e fëmijëve që janë pjesë e familjeve në nevojë dhe për 68 mijë familje ne do të japim 10% më shumë se sa pagesa aktuale. Pagesa aktuale është sipas strukturës së familjes, ku edhe fëmijët kanë rritjen e tyre. Kjo është për të gjithë skemën.

Ndërkohë, që do të dyfishohet pagesa për të gjitha familjet që kanë më shumë fëmijë mbi 3, dhe do të trefishohet pagesa për të gjitha kategoritë e fëmijëve jetim, të cilët janë nën 18 vjeç, viktimat e dhunës dhe viktimat e trafikimit. Pra, është një projekt-buxhet, i cili adreson atë që thua edhe ti, varfërinë edhe të fëmijëve, se aty ku kemi familje me më shumë fëmijë, aty ndoshta edhe problematikat janë më të mëdha, mirërritja, mirëushqyerja që janë pjesë e ekonomisë së familjes.

Kështu që është një gjë, e cila është adresuar mirë dhe drejtë në këtë projektligj dhe parashikon të gjithë pjesën buxhetore.

Ajo që më vjen keq, por që duhet ta prekim është pikërisht pjesa e fondit social, mbështetja e shërbimeve, e cila bëhet edhe për organizatën që ofron shërbimin e “Alo, 116/111”, që në fakt aksesohet nga të gjithë fëmijët që kanë nevojë apo kanë problematika të ndryshme, ngrenë telefonin dhe gjejnë aty shërbimin psiko-social. Ky është një nga shërbimet psiko-sociale për të cilat vet kjo ofron. Unë kam përshtypjen se duhet të jetë një keqkuptim mënyra se si është adresuar kjo problematikë dhe, por të gjithë jemi të bindur se ky është një shërbim, i cili ofrohet dhe mbështetet nga ministria dhe bashkia, me sa di unë, por fondi social e jep në mënyrë të drejtpërdrejtë mbështetjen për punonjësit që janë te linja 116/111, që nuk duhet ta harrojmë.

Në lidhje me programin kombëtar kundër dhunës së fëmijëve, në fakt është një fushatë ndërgjegjësimi, që duhet ta bëjmë të gjithë duke filluar nga familjet tona por duke filluar edhe nga pjesa e shtetit, apo organizatat këtu jemi të gjithë së bashku dhe ofrojmë fushatën më të mirë sensibilizuese kundër dhunës ndaj fëmijëve. Me sa di unë në programet tona ne kemi dy qendra që do të ngrihen një në Veri dhe një në Jug, për fëmijët viktime seksuale të dhunës në familje dhe janë dy të tilla që do të ngrihen ( nuk po i them emrat e bashkive, sepse pastaj do të jemi përsëri në kontakt në mënyrë që të adresohen të gjitha problematikat e tyre). Qendra LILIUM funksionon sot por është një qendër emergjence, ndërkohë që këto dy qendrat e tjera do të jenë rehabilituese dhe kjo është një gjë për t'u përshëndetur, ku fëmijët do të gjejnë mundësinë që edhe të kenë strehim, edhe mundësinë e trajtimit me shërbimin psiko-social.

Programi i eliminimit të varfërisë së fëmijëve adresohet nga ministria jonë te çështjet e buxhetit, skema e ndihmës ekonomike, por kjo nuk do të thotë se prek të gjithë sektorët e tjerë, sepse prek sektorin e punësimit për prindin dhe sektorin e fuqizimit të familjes. Programet tona janë maksimalisht të adresuara për fëmijët si te programet aktuale të mbrojtjes sociale, po kështu edhe të fëmijëve, të cilët kanë kopshte dhe çerdhe falas, kanë librat falas dhe këta janë të gjithë fëmijë të familjeve në skemën ekonomike, pagesën dhe kompensimin e energjisë elektrike. Pra, janë disa përfitime të bëra së bashku që i japin një mundësi më shumë familjes për të adresuar edhe çështjet e varfërisë. Në fakt është shumë e rëndësishme që çdo herë që kemi në diskutim projekt-buxhetin, ta rrisim akoma më shumë, por këtë herë kemi bërë maksimumin duke shënjestruar pikërisht familjet me fëmijët brenda tyre.

Të rinjtë janë gjithashtu një pjesë e kategorive vulnerabël, që nuk kanë një të ardhme, kur nuk kanë mundësi për të aksesuar shërbimet. Ne, me politikat e mbrojtjes sociale, kemi adresuar çështjen e të rinjve në një nga qendrat tona në Shkodër ku është rritur moshë e fëmijëve, të cilët nuk dalin nga institucioni as 14, as 16 vjeç, por dalin në moshën 18 vjeç. Të paktën do të kenë një mundësi më shumë që të përfitojnë nga arsimi profesional apo nga shkolla dhe të jenë pak më të fuqizuar.

Në fakt, këtu kemi pasur edhe ndihmën e të gjitha organizatave të shoqërisë civile, të cilat i mbështesin duke u gjetur edhe strehimin social, edhe mundësinë e punësimit, por duke i adresuar edhe te strukturat tona shtetërore, të cilët ndihmojnë dhe u japim ndihmë prioritare të gjithë të rinjve tanë jetim. Sigurisht, integrimi është pjesa kryesore që të kenë një qëndrueshmëri sa i përket edhe strehimit, edhe banesave sociale, por njëkohësisht edhe bashkitë apo pushteti vendor duhet të mbështesë realisht dhe të parashikojnë në planet e tyre sociale, buxhete të veçanta për të rinjtë. Faleminderit!

**Albana Vokshi** - Kemi edhe përfaqësuesin e Ministrisë së Rinisë. Keni diçka për të shtuar? Nuk ka.

**Sajmir Kadiu** – Më është bërë disa herë pyetja: sa lekë harxhojmë ne për fëmijët? Sa është buxheti për fëmijët në Shqipëri? Unë do të jap një përgjigje filozofike, se aritmetike është shumë e vështirë, duhet bërë ekstrapolim i disa sektorëve për të thënë që kaq harxhojmë për fëmijët. Pse themi ekstrapolim? Është një buxhet multisektorial, ku përfshihen: shëndetësia, arsimi, deri te rendi, kultura patjetër dhe pastaj kemi edhe dy anë, anën publike të fondeve që parashikohen në buxhetin e shtetit, por ama, edhe shpenzimet private që bëjnë familjet për fëmijët e tyre. Si mund të bëjmë një kalkulim? Kemi dy nocione në shëndetësi dhe në arsim sa u përket llogaritjeve kombëtare. Në shëndetësi kalkulimi është i tillë që *out of pocket* është që ta vëmë nga xhepi, dhe fondi që jep qeveria. Po kështu ndodh edhe me arsimin. Janë shifra jo të vogla dhe në qoftë se ministria e re do të ketë iniciativë, ne mund të kontribuojmë secili sektor se sa harxhohet për fëmijët. Në shëndetësi harxhojmë gati 5 milionë dollarë në vit vetëm për vaksinimin; janë 52 mijë fëmijë që përfitojnë. Duke futur tani edhe fëmijët nën moshën 15 vjeç kjo do të jetë shifër në rritje.

Kemi edhe fëmijët e maternitetit që janë pjesë e programit spitalor, sepse nuk kemi programe të veçanta buxhetore për fëmijët që të themi kaq është programi buxhetor për fëmijët, sepse fëmijët i kemi edhe te shëndeti publik, i kemi edhe te shërbimi spitalor dhe kujdesi social. Për shembull, e tha edhe Denada, 10% është rritur ndihma ekonomike, ku brenda janë edhe fëmijët,

është dyfishuar për familjet që kanë mbi tre fëmijë, pra e mira është që ne të kemi një shifër, sepse po të krijojmë një shifër pastaj kemi ku të bëjmë, por më tepër ka karakter multisektorial edhe asnjëherë nuk do të ketë një përgjigje të saktë. Në qoftë se më pyet sa kemi harxhuar për shëndetësinë, sot, 10 vjet apo 30 vjet më parë unë ta jap përgjigjen brenda sekondit.

Me literaturë ndërkombëtare fëmijët zero deri 1 vjeç dhe mosha e tretë shpenzojnë pesëfishin e të gjitha grupeve të tjera të popullatës dhe këtu mund të bëhet një ekstrapolim për të parë sa harxhojmë. Ideja që zero deri në 1 vjeç janë falas dhe më pas jo, këto janë probleme që duhen riparë edhe në këndvështrimin e taveve. Për shembull, u ngrit problemi i medikamenteve, ne kemi një *turn over* vjetor në Shqipëri 220 milionë euro ku gjysma rimburore dhe gjysma tjetër është *out of pocket*. Tendencia ka qenë lidhur me buxhetin. Unë mbaj mend që nga viti 1992 deri më sot ne kemi pasur një trend pozitiv për buxhetin, kjo nuk do të thotë se kanë qenë buxhete fantastike, por ka një trend pozitiv. Duke rritur buxhetin do të ulim këtë pjesën e *out of pocket* që kemi dhe me strategjinë që kemi, duke pasur parasysh që edhe ekonomia nuk do të jetë gjithmonë nën krizën e pandemisë, synojmë që deri në vitin 2025 të jemi 70 me 30 të jemi në vitin 2025 ku do të shfaqen përqindjet me fondet publike dhe 80% me *out of pocket*. Është shumë e vështirë. E dëgjova edhe këtu, e kam dëgjuar edhe herë të tjera që bëjmë krahasime me botën. Kjo është shumë gjë e mirë, sepse kur krahasohesh me botën do të thotë se është arritur diçka, por do edhe një lloj saktësie sa i përket faktit se kush jemi ne, çfarë problemesh kemi, sepse bëhet edhe në rajon kjo gjë, por në rajon është edhe Kroacia apo Sllovenia që krahasohen me vendet e tjera, ndërkohë që ne nuk mund të bëjmë çdo gjë. Por unë gjithmonë e them që sa më shumë kërkesa ka, aq më mirë është për ne.

**Albana Vokshi** – Faleminderit, Sajmir!

**Denada Seferi** – Do të doja të *update*-oj vetëm Atinin, në fakt, që nuk ka më tavan ndihma ekonomike dhe nuk është më 80 mijë, por është hequr dhe shkon përtej sipas strukturës së familjes në mbi 100 mijë.

**Albana Vokshi** - Faleminderit, shumë!

Altin, i more përgjigjet?

**Altin Hazizaj** - Do të doja më tepër të bëja një koment. Ne jemi midis profesionistëve këtu dhe është edhe çështje respekti i secilit, por tendencia e ministrisë duhet të jetë e kënaqshme me aq sa merr, me përjashtim të zotërisë që kam në krahë. Tendencia është të kërkosh më shumë dhe lufta e shoqërisë civile nuk është fonde që t'i marrim në shtëpi, por janë fonde për qytetarët shqiptarë.



Sa i përket çështjes së dhunës seksuale duke pasur parasysh që ne kemi edhe qendrën e parë kombëtare që është ndërtuar, do të thosha se për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna seksuale nuk zgjidhet dot kjo çështje me një ose dy qendra.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë po them të kesh program kombëtar, do të thotë që paracakton disa standarde, cakton disa zona që janë të nxehta dhe pastaj sigurisht mbështetja shkon aty ku duhet.

E dyta, dhe në fakt e lidh pak me atë që tha Ema më parë, ne kemi nevojë të ndërrojmë mendësinë sa u përket financimit të shërbimeve. Ndoshta kjo mund të jetë edhe një zgjidhje për ju. Kudo që nuk ka shërbime ministria mund t'i blejë ato, apo bashkia në varësi, por të paktën duke bërë kostimin e tyre, duke licencuar në mënyrën më të mirë të mundshme shërbimet që edhe janë cilësore, se edhe kjo ka rëndësi, mendoj se duke ngarkuar këtë te skema ose e ndërhyrjes sociale ose te skema e shëndetësisë, që u ndje pak si modeli amerikan dhe britanik, me thënë të drejtën, ne mund t'i gjejmë një zgjidhje farë mirë të shërbimeve sociale në Shqipëri.

Fakti që ministria është bashkë me një buxhet, nuk besoj se ka pengesa të paktën ligjore për ta gjetur këtë si zgjidhje.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** - Faleminderit, shumë!

Atëherë, besoj jeni të gjithë dakord që ta mbyllin dëgjuesën e seancës maratonë. Kjo na jep kohë pak më të lirë për t'u marrë me degët apo njësitë tona nesër dhe javën që vjen.

Faleminderit të gjithëve!

## **MBYLLET MBLEDHJA**